

NË KËTË NUMËR LEXONI



4 Veriu i Kosovës oazë e kontra...



6 Intervistë me Valdete Idrizin



14 Rruga e shqiptarëve...



20 Fotoreportazh nga punanë TMK



23 Zhveshja e femrave, modë apo...

Lajme	2
Milazim Krasniqi: Zgjedhjet serbe rrezikojnë pavarësinë e Kosovës.....	3
Florije Ademi: Veriu i Kosovës oazë e kontrabandistëve.....	4-5
Intervistë me fituesen e çmimit "Gra të guximshme", Valdete Idrizin.....	6-8
Avni Avdiu: Pika-pika u bëmë pus	9-10
Naile Demiri: Çka pas pavarësisë?	10
Gëzim Qerimi: Zgjedhjet studentore në UP.....	11
Fitim Veliu: Njohja e kulturës së shkollës.....	12
Sead Ujkani: Ekonomia globale në krizë!	13
Besim R. Cengu: Rruga Durrës-Kukës-Prishtinë – rruga e shqiptarëve	14-16
Demir Reshiti: Vazhdon njohja.....	17-19
Osman D. Gashi: Fotoreportazhi.....	20-21
Emine A. Vezaj: Feja dhe kohezioni shoqëror ..	22-23
Arber Zeke: Zhveshja e femrave, modë apo imoralitet.....	23
Muhamed Jusufi – Kajolli: Viti i ngritjes	24-25
Debat i hapur	26-27
Sabile Keçmezi – Basha: Gratë në Parlamentin shqiptar gjatë historisë	28
Naim Sadiku: Kur shpresa për të ardhmen, shuan dhembjen e së kaluarës!.....	29
Flamur Maloku: Fryma e lirisë jetësore	30-31
Poezi	32
Marius Chelaru: Vetëm vdekja është e bardhë. 33-34	
Muhamed Çitaku: Shenjat intertekstuale.....	34-35
Berat Dakaj: Muri.....	36
Mevludë Zejnullahu: Digjemi nga dëshira për njëritjetrin.....	36
Mirsad Kuteli: Truri si burim i pashterur	37
Artan Bejta & Iliriana Alloqi: Tuberkulozi i mushkërive (TBC)	38-39
Fjalëkryqi	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 17
19 prill 2008
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloqu@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redaksisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Vatikan

30 mars 2008



Islami kalon katolicizmin

Islami ia ka kaluar katolicizmit duke marrë parasysh numrin e besimtarëve. Muslimanët përbëjnë 19.2 % të popullsisë së botës, kurse katolikët renditen të dytët me 17.4 %.

Të dhënat janë bërë të ditura nga Selia e Shenjtë në Vatikan, e cila ka publikuar librin e statistikave për vitin 2008.

Të njëjtat burime kanë thënë se gjithë të krishterët, përfshi ortodoksët, protestantët dhe anglikanët, përfaqësojnë 33 % të popullsisë së globit.

Hagë

3 prill 2008

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj shpallet i pafajshëm

Gjykata Penale Ndërkombëtare e Hagës, në seancën përmbyllëse, ka shpallur të pafajshëm ish-kryeministrin e Kosovës dhe ish-komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Zonën Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj.

Gjykata ka shpallur të pafajshëm edhe Idriz Balajn për akuzat e ngritura nga Prokuroria e kësaj gjykate. Ndërsa Lahi Brahimaj është dënuar me gjashtë vjet heqje lirie, nën akuzën për trajtim mizor dhe torturë.

Procesi gjyqësor kundër ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, Idriz Balaj e Lahi Brahimaj, ka filluar më 5 mars të vitit 2007 dhe ka përfunduar më 23 janar të këtij viti. Prokuroria ka ftuar më se 75 dëshmitarë, shumica prej të cilëve inspektorë e bashkëpunëtorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP), kurse ekipi i mbrojtjes së Haradinajt, Balajt dhe Brahimajt nuk e ka parë të arsyeshme të ftojë asnjë dëshmitar, duke konsideruar se Prokuroria nuk ka arritur të argumentojë aktakuzën.



Bukuresht

3 prill 2008



Shqipëria dhe Kroacia morën ftesën për anëtarësim në NATO

Shqipëria dhe Kroacia morën zyrtarisht ftesën për anëtarësim në NATO. Në një konferencë shtypi pas një mbledhje të gjatë me krerët e vendeve pjesëmarrëse në samitin e Bukureshtit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Scheffer ka konfirmuar ftesën zyrtare të bërë Shqipërisë dhe Kroacisë. "Shqipëria dhe Kroacia marrin ftesën për t'u anëtarësuar në NATO. Ju uroj mirëseardhje në familjen e madhe euro-atlantike", ka deklaruar Scheffer.

Ndërkaq Maqedonia nuk e ka marrë ftesën, për shkak të vetos greke lidhur me mosmarrëveshjet për emrin. "Kemi rënë dakord që ftesa për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë do të jepet menjëherë sapo të arrihet një zgjidhje e pranueshme lidhur me emrin", ka thënë kreu i NATO-s.

Prishtinë

9 prill 2008

Kuvendi ka miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Kuvendi i Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme dhe solemne, në të cilën kanë marrë pjesë 107 deputetë nga 120 sa janë gjithsej, me aklamacion ka miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës si aktin më të lartë juridik të vendit, e cila e përcakton Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Kushtetuta e Kosovës përbëhet nga 40 kapituj dhe 160 nene, dhe si e tillë e përcakton Kosovën si Republikë parlamentare, duke avancuar rolin e presidentit të Kosovës, i cili do të jetë edhe komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës, që pritet të themelohet brenda këtij viti pas transformimit të TMK-së.

Kosova me kushtetutë përcaktohet si shtet i qytetarëve të saj, ku gjuhë zyrtare është gjuha shqipe dhe gjuha serbe, kurse gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal.

Projekt Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e miratuar më parë nga Komisioni Kushtetues, e ka certifikuar përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (ICR), Piter Fejt.

Kushtetuta hyn në fuqi më 15 qershor të këtij viti, pas përfundimit të fazës tranzitore.



Zgjedhjet serbe rrezikojnë pavarësinë e Kosovës



Milazim KRASNIQI

Pavarësia e Kosovës e shpallur më 17 shkurt të këtij viti, do të vihet në sprovë dhe rrezik serioz më 11 maj të po këtij viti, ditën kur janë caktuar të mbahen zgjedhjet parlamentare dhe lokale të Serbisë edhe në Kosovë. Mbatja e zgjedhjeve serbe në Kosovë ka për qëllim kompromentimin e pavarësisë së shpallur dhe krijimin e gjendjes faktike të ndarjes së saj, si njëri nga opsionet rezervë të Beogradit. Nëse nga këto votime zgjidhen drejtuesit e pushteteve komunale në komunat e Kosovës dhe nëse zgjidhen edhe deputetë në parlamentin serb, atëherë nuk ka asnjë shans për integrimin e komunitetit serb në shtetin e ri të Kosovës. Ndërsa, ndarja e Kosovës mund të hapë opsionin e vetëm që mbetet për pjesën tjetër, bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. E kjo sërish do të thoshte zhdukje e pavarësisë së Kosovës.

Kompromentimi që vjen nga zgjedhjet serbe ka të bëjë edhe me tërë komunitetin ndërkombëtar, përkatësisht me shtetet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Nëse një shtet është i pavarur dhe sovran, nuk ka mundësi që në territorin e tij të mbahen zgjedhje të një shteti tjetër, pa aranzhmane marrëveshesh reciproke ndërmjet atyre dy shteteve, sikundër është fjala për rastin e Finlandës e të Suedisë. Minimumi në këtë rast është që ato shtete ta kenë njohur ekzistimin e njëra-tjetres dhe të mos kenë pretendime territoriale. Në të kundërtën, një sjellje e tillë paraqet agresion juridik të njërit shtet ndaj tjetrit. Për këtë arsye, shembulli që ka sjellë komisioneri për zgjerim i Bashkimit Evropian, Oli Ren, për zgjedhjet ndërmjet Finlandës e Suedisë, është mashtrim për opinionin politik e publik të Kosovës, sepse një

krahxim ndërmjet Finlandës e Suedisë me Serbinë e me Kosovën nuk është i logjikshëm. Finlanda e Suedia nuk kanë konteste ndërmjet tyre, ndërsa Serbia e konsideron Kosovën territor të vetin dhe ajo është e gatshme ta riokupojë atë në rastin e parë që do t'i jepej. Në këtë kontekst, më duket e habitshme se si drejtuesit e institucioneve të Kosovës, me gjithë ata këshilltarë e ekspertë që majmen me paratë e buxhetit të varfër të këtij vendi, nuk arrijnë t'ua sqarojnë diplomatëve si Oli Reni, së paku dallimin faktik ndërmjet Finlandës e Suedisë në njërën anë dhe Serbisë e Kosovës në anën tjetër. Arsyetimi i zgjedhjeve serbe në Kosovë, me gjoja parimin e dyshetësisë, sikundër përpiqet të arsyetojë kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu, është krejt i pasaktë, sepse Serbia nuk e njeh fare shtetësinë e Kosovës. Përkundrazi, Serbia i mban zgjedhjet në Kosovë mbi parimin e njëshetësisë, pra duke e trajtuar Kosovën si pjesë të vetën.

Zgjedhjet serbe në truallin e Kosovës mund të sjellin ashpërsim të raporteve ndërmjet shqiptarëve e serbëve edhe në brendi të territorit të Kosovës, ku përzierja etnike është më e madhe. Nëse do të ketë të zgjedhur për pushtetin lokal në të ashtuquajturat “komuna serbe”, Graçanicë, Shtëpçicë e ndonjë tjetër, thjesht nuk do të mund të qeveriset as në komunat shqiptare, e as në ato serbe. Ndërsa, në atë rast, për forcat radikale të të dyja anëve, do të krijohet ambient i përshtatshëm.

Ministri serb i punëve të jashtme, Vuk Jeremiq, në një intervistë në gazetën Danas këtë fundjavë ka deklaruar se angazhimi parësor i qeverisë serbe tash është bashkëpunimi me OKB-në e me UNMIK-un, për të penguar “transferimin e kompetencave” të autoritetet e Kosovës, gjë që e ka paralajmëruar si mundësi edhe sekretari i OKB- së, Ban Ki Mun, gjatë vizitës së tij në Moskë. Ministri i jashtëm slloven, Dimitri Rupel, pas takimit të kësaj fundjave me sekretarin Ban Ki Mun, ka deklaruar se OKB-ja duhet të mbetet me një rol

të rëndësishëm në Kosovë dhe në këtë aspekt ka thënë edhe se Muni ka disa “ide të reja”. Se cilat janë ato ide të reja, tash për tash, nuk po bëhet e ditur. Por, nëse nuk barten kompetencat nga UNMIK-u te institucionet e Kosovës më së voni deri në qershor dhe, në anën tjetër, krijohen institucionet paralele serbe, atëherë çfarë mbetet nga pavarësia e Kosovës?

Kjo gjë bëhet edhe më shqetësuese kur dihet se “ndarjen funksionale” të cilën e kërkon ministri serb, Sllobodan Samarxhiqi, në të vërtetë UNMIK-u e ka lejuar gjatë këtyre nëntë vjetëve të administrimit mbi Kosovën. Tash në fund të mandatit të UNMIK-ut, ka rrezik që burokratët e UNMIK-u të galluqizohen edhe më shumë. (Njëra nga mundësitë është që të mbushin trasta të reja me para edhe nga qeveria e Serbisë.)

Në komunikimin e UNMIK-ut me qeverinë serbe për zgjedhjet, “po diskutohet” për zgjedhjet lokale, ndërsa ato parlamentare tashmë janë lejuar. Kjo është një politikë zhvlerësimi ndaj pavarësisë së Kosovës, sepse zgjedhjet politike janë shumë më të ndjeshme se sa ato lokale. Por, kjo politikë e UNMIK-ut dhe e Bashkimit Evropian është dyfytërshe edhe ndaj të ashtuquajturave “forca propeëndimore” në Serbi, të udhëhequra nga presidenti Boris Tadiq, meqë dihet saktë se votat e serbëve të Kosovës janë të konvertuara për radikalët e Nikoliqit dhe për nacionalistët e Koshtunicës. Pra, me lejimin e këtyre votimeve në Kosovë, atyre u sigurohen disa karrixe në parlamentin serb, që mund të jenë përcaktuese të fitores së forcave nacional-fashiste në Serbi.

Është e mundshme që dikush në komunitetin ndërkombëtar dhe veçmas në OKB e dëshiron këtë gjë, sepse fitorja e nacional-fashizmit në Serbi, do ta rikthente krizën dhe rrezikun e luftës së armatosur. E kjo do të siguronte prezencën afatgjatë të UNMIK-ut dhe të levave të tij të kriminalizuara në Kosovë. ■

Mosfunksionimi i doganave në veri ka dëmtuar në masë të madhe buxhetin e Kosovës

Veriu i Kosovës oazë e kontrabandistëve

Burimet jozyrtare brenda policisë, njoftojnë se në shumicën e rasteve mallrat hynë në Kosovë me kamionë, duke shfrytëzuar rrugët malore dhe më pas ndalen në Leposaviq, ku malli shpërndahet në disa vetura, të cilat nuk kontrollohen fare nga doganierët, kështu që pa ndonjë problem ato kryejnë “misionin” e tyre duke iu shmangur tatimeve doganore dhe çështjeve të tjera procedurale.



Florije ADEMI

Djegia e dy pikave doganore në veriun e Kosovës, konkretisht në Leposaviq dhe Zubin Potok, nga ana e serbëve, të cilat tashmë nuk menaxhohen nga Shërbimi Doganor i Kosovës, përveçse ka dëmtuar në masë të madhe buxhetin e Kosovës, ka krijuar edhe kushte shumë të përshtatshme për shtimin e kontrabandës. Zyrtarë të Shërbimit Policor të Kosovës, pohojnë ekzistimin e kësaj dukurie që është në rritje, ndërkohë që sipas tyre efikasiteti i zbulimit të rasteve është në shkallë më të ulët. “Nuk mund të mohojmë se nuk ekziston kontrabanda në veri dhe duke marrë për bazë faktet që kanë ndodhur në dy pikat doganore në këtë pjesë të Kosovës, pa dyshim se janë krijuar vështirësi në përpjekjet e zbulimit të kontrabandës dhe në të njëjtën kohë ky

aktivitet ilegal është shtuar”, thotë zëdhënësi i Shërbimit Policor të Kosovës, për rajonin e Mitrovicës, Besim Hoti. Sipas tij, në tremujorin e parë të këtij viti janë regjistruar tre raste të kontrabandës, një në Zubin Potok, tjetri në Zhazhë të Zveqanit, dhe një rast në Suhodoll të Mitrovicës. Në lidhje me këto raste, policia ka arrestuar gjashtë persona, pesë serbë dhe një shqiptar, të cilët pas qëndrimit 24 orë në stacionin policor janë liruar me urdhër të prokurorit publik. Në dy nga këto raste janë kontrabanduar derivate me kamionë me targa KS, ku me dokumentacion pronarët e tyre janë shqiptarë, kurse ngasësit e tyre serbë. Ndërkaq, rasti i Sudodollit ka të bëjë me kontrabandimin e 332 palë xhinsave me vlerë prej 3 mijë eurove, të cilat kanë hyrë në Kosovë pa iu nënshtruar doganimit. Katër nga 6 kontrabandistët (tre serbë dhe një shqiptarë), janë arrestuar në fshatin Zupç të Zubin Potokut, në fillim të këtij muaji, pasi që janë zënë duke kontrabanduar 6 tonë karburante. Arrestimin e ka bërë të mundshëm prezenca e ushtarëve të KFOR-it, pasi

kontrabandistët kishin ikur një herë dhe pas disa minutave kishin tentuar që të merrnin me dhunë automjetet nga pika e kontrollit policor.

Zyrtarët e policisë kanë thënë se dy automjete transportuese me targa “KS” të cilat po transportonin derivate që besohet të ishin të kontrabanduara, janë ndaluar në një pikë kontrolli të policisë në fshatin Zupç të Zubin Potokut.

“Automjetet që po qarkullonin nga drejtimi Zubin Potok-Mitrovicë, ishin ndaluar nga policia, ndërsa njësitë mobile të doganave janë ftuar të paraqiten në vend të ngjarjes. Pak çaste pasi automjetet janë ndaluar, ngasësit e automjeteve kanë ikur nga vendi i ndalimit duke braktisur automjetet”, ka pohuar zëdhënësi rajonal i SHPK-së, Besim Hoti, duke shtuar se kontrabandistët janë kthyer pas disa minutave për të marrë automjetet nga pika e kontrollit policor. “Dhjetë minuta më vonë, në vend të ngjarjes janë paraqitur disa persona të cilët kanë tentuar që të nxjerrin me dhunë automjetet nga pika e kontrollit policor. Një pjesëtar i policisë së UNMIK-ut, ka shkrepur një plumb paralajmërues në ajër nga arma e tij zyrtare me qëllim të ndalimit të personave të dyshuar, të cilët në atë moment tregoheshin të dhunshëm”, ka pohuar zëdhënësi Hoti.

Policët kanë marrë mbështetje nga ushtarët e KFOR-it, të cilët edhe kanë arritur t’i arrestojnë kontrabandistët.

Po ashtu automjetet e ndaluara të cilat po transportonin rreth 6 tonë derivate të kontrabanduara janë sekuestruar dhe u janë dorëzuar autoriteteve doganore për procedurë të mëtejme.

Vetëm gjatë muajit mars janë kontrabanduar rreth 1000 tonelata naftë

Burime jozyrtare pohojnë se përmes një firme të Zubin Potokut bëhet kontrabanda i karburanteve nga Serbia për në Kosovë dhe se kjo sasi që është konfiskuar në fillim të këtij muaji paraqet



Besim Hoti, zëdhënës i SHPK-së për rajonin e Mitrovicës

një sasi të vogël që hyn në vazhdimësi. Po ashtu mësohet se vetëm gjatë muajit mars rreth 1000 tonelata naftë ka hyrë përmes këtij kanali kontrabandues. Ndonëse, doganierët nuk janë në vendin e tyre, dhe se veturat e këtij shërbimi zakonisht shihen në fshatin Koshtovë të Mitrovicës (rruga që shpie për në Zubin Potok), dhe në dalje të Mitrovicës, gjegjësisht në rrugën që shpie për në Zveçan, kontrabandistët e kanë shumë të lehtë të depërtojnë brenda në Kosovë. Burime jozyrtare brenda policisë, njoftojnë se në shumicën e rasteve mallrat hynë në Kosovë me kamion, duke shfrytëzuar rrugët malore dhe më pas ndalen në Leposaviq, ku malli shpërndahet në disa vetura, të cilat nuk kontrollohen fare nga doganierët që zakonisht qëndrojnë në pikat e cekura më lart, kështu që pa ndonjë problem ato kryejnë "misionin" e tyre duke iu shmangur taktiveve doganore dhe çështjeve të tjera procedurale.

Edhe organizata të ndryshme kanë vënë alarmin se në pjesën veriore të Kosovës, po zhvillohen në masë të madhe aktivitete joligjore. Zyrtarë të Aleancës Kosovare të Biznesit, gjatë prezantimit të një hulumtimi

mujor që ka bërë kjo organizatë, kanë thënë se vërehet se vetëm gjatë kësaj periudhe, 30 për qind e mallit nga Serbia ka hyrë në mënyrë ilegale në Kosovë.

Në të njëjtën periudhë, më 2007, në krahasim më 2008, nga Serbia ka hyrë mall mbi 9 për qind më shumë. Por, kjo kur përpjesëtohet me ekonominë informale, del mbi 30 për qind për muajt që po flasim, kanë thënë zyrtarë të kësaj aleance.

Kontrabandistët kanë dëmtuar buxhetin e Kosovës për 40 milionë euro

Në pjesën veriore të Kosovës, dukuria e kontrabandës së mallit ka qenë edhe më herët në nivel të lartë, ndërkaq pas djegies së pikave kufitare, kjo dukuri është shpeshuar edhe më shumë. Edhe zyrtarë ndërkombëtare në Kosovë kanë deklaruar se mosfunksionimi efektiv i Shërbimit Doganor të Kosovës, në atë pjesë të Kosovës, ka rezultuar me shtimin e kontrabandës së mallit. Në këto pika nga trazirat e shkurtit të këtij viti janë vendosur pjesëtarët e KFOR-it, mirëpo zyrtarë të lartë ndërkombëtarë dhe vendorë thonë se së shpejti doganierët do të rivendosen në vendet e tyre. "Doganat së shpejti do të kthehen në vendet e tyre, në Zubin Potok dhe Leposaviq, aty ku kanë qenë" ka deklaruar përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së,

për Kosovë, Joackim Ruecker. Po ashtu edhe kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, që është mbajtur më 10 prill në Mitrovicë, fillimin e punës së pikave doganore e ka cilësuar si një objektivë që duhet realizuar. Duke potencuar rëndësinë e rifillimit të punës së shërbimit doganor, ai ka premtuar se nuk do lejohet krijimi i oazës së kontrabandës në këtë zonë, pasi vetëm vitin që shkoi kjo gjendje i ka kushtuar vendit me humbjen e 40 milionë eurove. Ai ka thënë se së bashku me presidentin Fatmir Sejdiu, kanë mbajtur një takim me përfaqësuesin evropian Feit dhe kryediministratorin Ruecker, prej të cilëve kanë marrë premtime se kjo gjendje nuk do të lejohet dhe se së shpejti atje do të rikthehet rendi, ligji dhe funksionimi normal i institucioneve. Ndërkaq, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, ka theksuar se që nga 19 shkurti, mosfunksionimi i doganës i ka shkakuar dëme të konsiderueshme buxhetit të Kosovës, dhe se është duke u punuar së bashku me doganën dhe shtyllën e IV të UNMIK-ut, në mënyrë që vakumi fiskal të jetë sa më i shkurtër.

Muajt e fundit dëmi konsiderohet të jetë 1,6 milion euro. "Jemi duke punuar për rikthimin e pikave doganore në veri, por në qoftë se kjo nuk arrihet për një kohë të shkurtër, atëherë kemi rënë dakord për mbylljen e këtyre dy pikave, në mënyrë që mos të ketë vakum të buxhetit", ka theksuar ministri Shala. Sidoqoftë, kontrabanda e mallrave nga Serbia dhe Mali i Zi me destinim në Kosovë po vazhdon. ■



Në shumicën e rasteve mallrat hynë në Kosovë me kamion, duke shfrytëzuar rrugët malore dhe më pas ndalen në Leposaviq, ku malli shpërndahet në disa vetura...

Intervistë ekskluzive me zonjushën Valdete Idrizi, fituese e çmimit Ndërkombëtar 'Gra të Guximshme'.

Çmimin ia dedikoj Kosovës së pavarur

- Presidenti Bush më tha: Faleminderit që po punon për shtetin e Kosovës;
- Në Kosovë, ka shumë femra shqiptare që kanë bërë e bëjnë edhe më shumë sesa unë dhe që e meritojnë këtë çmim;
- Jam përcaktuar të punoj për paqen, sepse nuk dua që të kemi një regjim siç ka qenë përpara.

Intervistoi: Demir Reshiti

Në një ceremoni të zhvilluar në mjediset e Departamentit të Shtetit, Sekretarja amerikane e Shtetit Condolezza Rice ka ndarë Çmimin Ndërkombëtar për 'Gra të Guximshme'. Ky çmim prestigjioz ndahet çdo vit në të njëjtën ditë, dhe ka një përzgjedhje selektive e cila bëhet nga ambasadat amerikane anekënd botës. Me Çmimin Ndërkombëtar për 'Gra të Guximshme', këtë vit u nderuan Valdete Idrizi (Kosovë), Suraya Pakzad (Afganistan), Virisila Buadromo (Fixhi), Dr. Eaman Al-Gobory (Irak), Nibal Thawabteh (Palestinë), Dr. Begum Jan (Pakistan), Cynthia Bendlin (Paraguaj) dhe Farhiyo Farah Ibrahim (Somalia).

Mitrovicasja Valdete Idrizi, është e vetmja femër nga Evropa që e fitoi këtë çmim të madh. Me zonjushën Valdete Idrizi, e cila është njëra nga lideret e organizatës joqeveritare "Community Building Mitrovica - CBM", zhvilluam një intervistë ekskluzive për lexuesit e revistës Paqja.

PAQJA: Kush ju njoftoi se jeni njëra nga kandidatet për këtë çmim dhe a keni pritur që të zgjidheni femra më e guximshme?!

Idrizi: Më ka njoftuar Zyra amerikane në Prishtinë. Isha në Paliq të Vojvodinës ku jam në përfundim e sipër të studimeve master për menaxhimin e konflikteve, kur më telefonuan dhe më thanë se duhet të flasim urgjent me ty. Më shpjeguan rreth këtij çmimi që e ndan sekretarja amerikane e shtetit për çdo vit, dhe më thanë se duam të të nominojmë ty si përfaqësuese të Kosovës. Unë sigurisht se pranova, dhe

Valdete Idrizi është lindur më 1973 në Mitrovicë. Ka mbaruar Fakultetin e Gjeologjisë në Universitetin e Prishtinës në Mitrovicë. Aktualisht është studente e "Studimeve të aplikuara mbi transformimin e konflikteve", një kurs studimor master dyvjeçar, të cilin po e implementon Nansen Dialogue Network bashkë me organizatën "Përgjigjja ndaj konfliktit" nga Birmingham-i dhe Universiteti i Novi Sadit.



Përveç shkollimit të saj, ajo gjithashtu ka qenë e angazhuar me aktivitete të ndryshme rinore, si në teatër, grupe kulturore studentore dhe lëvizjen paqësore të studentëve.

Në prill të vitit 1999, Valdetja dhe familja e saj janë dëbuar nga shtëpia e tyre në veri dhe që nga ajo kohë asaj nuk i është lejuar të kthehet atje, pa marrë parasysh përpjekjet dhe dëshirën e saj për t'u kthyer. Ajo jeton me qira në një banesë në pjesën jugore të Mitrovicës.

Që nga fillimi i vitit 2001, Valdetja e ka udhëhequr OJQ-në multietnike të quajtur "Community Building Mitrovica - CBM", një organizatë që ka fituar respektin dhe besueshmërinë e komuniteteve në Mitrovicë.

iu falënderova shumë për besimin që kanë pasur jo vetëm për mua si Valdete, por si një femër shqiptare e Kosovës. Kur u ktheva në Kosovë, më ftuan në takim në zyrën amerikane dhe më befasuan me informacionet që kishin arritur t'i mësonin për aktivitetin tim dhe të organizatës që unë drejtoj. Pas disa ditësh ata erdhën në zyrën time në Mitrovicë, ku morën edhe mendimin e kolegëve të mi të organizatës se a kanë vepruar drejt që më kanë dominuar për këtë çmim.

Presidenti Bush më tha: Faleminderit që po punon për shtetin e Kosovës

PAQJA: Çfarë përshtypje keni nga takimi me presidentin amerikan dhe sekretaren e shtetit?

Idrizi: Njerëzit e mëdhenj janë gjith-

monë modest. Mund të them se kam përjetuar vërtet një emocion të veçantë, sepse secilës prej nesh që kishim fituar atë çmim, sekretarja Rice, me një përkushtim të madh, na i dinte emrat të gjitha fitueseve dhe na falënderonte për punën që bëjmë. Nuk ishte vetëm një falënderim formal e i shkurtër, por një falënderim i gjatë dhe nga zemra. Mua mu drejtua: Faleminderit që punon për shtetin e Kosovës, gjë që unë e përjetova me një emocion të veçantë. Prej të gjitha atyre fitueseve, unë isha në pozicion më të mirë sepse gjithmonë mua më uronin dy herë, një herë për çmimin dhe një herë për shtetin. Të njëjtën gjë bëri edhe presidenti Bush, të cilit kur i erdhi radha të më takonte mua, ma shtrëngoi dorën dhe më tha: Ty duhet të të uroj dy herë, fillimisht për shtetin i cili vetëm tri javë

është i vjetër, apo?! Në atë moment unë ju drejtova me një falënderim duke i thënë se ju keni bërë shumë për pavarësimin e shtetit të Kosovës.

Edhe zonja e parë na ka pritur shumë mirë. Është interesant të theksoj se brenda Shtëpisë së Bardhë organizohet për çdo vit me rastin e ditës ndërkombëtare të gruas një pritje për gratë më të suksesshme amerikane dhe kësaj radhe ishim edhe ne mysafire speciale në këtë pritje. Edhe me këtë rast presidenti Bush na prezantoi të gjithave. Për mua tha: Kjo është Valdete Idrizi nga shteti më i ri në botë - Kosova, gjë që u prit me duartrokkitje të mëdha nga të pranishmet, dhe sigurisht se më ngjalli emocione të mëdha. Kjo e tëra ishte për mua si një ëndërr, sepse vërtetë ndihesha krenare kur me prezantonin si përfaqësuese të Evropës dhe të shtetit të Kosovës.

PAQJA: Ju në takimin me presidentin Bush keni ngritur dhe çështjen e ndarjes së Kosovës. Cili ishte qëndrimi i tij për këtë çështje?

Idrizi: Në të gjitha takimet që kam pasur me presidentin Bush, zonjën e tij Laura, sekretaren Rice, ambasadorin Wisner e të tjerë, unë kam ngritur shqetësimin tim për rrezikun e ndarjes së Kosovës, apo të shkëputjes së pjesës veriore të saj. Mirëpo, nga të gjithë këta që i përmenda kam marrë një kurajë dhe siguri dhe ata jo vetëm para meje personalisht, por para një audience të gjerë më kanë thënë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës, sepse ajo është një shtet sovran i pranuar me kufij të njohur ndërkombëtarisht. Dhe unë jam e bindur se ndarje nuk do

Çmimi prestigjioz "Gra të Guximshme" ndahet çdo vit në të njëjtën ditë, dhe ka një përzgjedhje selektive e cila bëhet nga ambasadat amerikane kryq e tërthor botës. Këtë vit kandidatë u zgjodhën 97 gra nga e gjithë bota. Me Çmimin Ndërkombëtar për 'Gra të Guximshme', këtë vit u nderuan gra nga Kosova, Afganistani, Fixhi, Iraku, Pakistani, Autoriteti Palestinez, Paraguai dhe Somalia, për rolin që kanë luajtur për transformimin e shoqërive të tyre dhe ndikimin frymëzues në komunitetin ndërkombëtar.

Gratë fituese për këtë vit ishin: Valdete Idrizi (Kosovë), Suraya Pakzad (Afganistan), Virisila Buadromo (Fixhi), Dr. Eaman Al-Gobory (Irak), Nibal Thawabteh (Palestinë), Dr. Begum Jan (Pakistan), Cynthia Bendlin (Paraguaj), dhe Farhiyo Farah Ibrahim (Somali)

të ketë, prandaj edhe nuk i kam shitur pronat e mia në pjesën veriore. Unë vetë jam e lindur në pjesën veriore dhe jam e bindur se një ditë do të kthehem të jetoj atje.

Mund t'iu them se jam kthyer nga Amerika me një forcë më të madhe, sepse më kanë thënë se diplomacia amerikane do të ketë përkushtim më të madh dhe afatgjatë ndaj zhvillimit të shtetit të Kosovës.

PAQJA: Si u prit në Kosovë fituesja e çmimit 'Femra më e guximshme'?

Idrizi: Pritja madhështore që mu organizua në aeroportin e Prishtinës, ishte

një emocion po aq i madh krahas emocioneve që kam përjetuar me rastin e ndarjes së çmimit dhe të takimeve të shumta me personalitete të rëndësishme të shtetit amerikan.

Ishte vërtetë një befasi e madhe për mua se si e kishte organizuar pritjen time shoqëria civile në Mitrovicë dhe gjej rastin që nëpërmjet revistës suaj të respektuar t'i falënderoj të gjithë ata miq, bashkëpunëtorë e dashamirë të cilët më kanë befasuar aq këndshëm me pritjen e organizuar. Unë në aeroportin e Prishtinës kam arritur në orën 3 pasdite, kurse në shtëpinë time vetëm pas 11 orësh, pra në orën 2 pas mesnate. Fillimisht pritja në aeroport, pastaj pritja që u organizua në hotelin Palas në Mitrovicë, ku artistët mitrovicas kishin përgatitur një koncert madhështor, më bënë që të ndihem dyfish krenare që i takoj këtij populli.

Në Kosovë, ka shumë femra shqiptare që kanë bërë e bëjnë edhe më shumë sesa unë dhe që e meritojnë këtë çmim

PAQJA: Çfarë përfaqëson çmimi "Gra të Guximshme" për ju personalisht dhe gruan shqiptare në Kosovë?

Idrizi: Në radhë të parë, për mua ky është një privilegj i madh. Ky çmim nuk më përket vetëm mua si person (si Valdete), por, si një grua shqiptare, e cila punon për të drejtat e grave, pavarësisht të cilës kombësie, pakice ose race janë ato. Në këtë kohë, mendoj se është më shumë rëndësi, që të dal në pah edhe puna jonë në organizatën tonë "CBM", madje, e vlerësuar kjo edhe nga qeveria amerikane dhe personalisht nga Sekretarja e Shtetit Condoleezza Rice. Në këtë mënyrë ne i shërbejmë ndërtimit të marrëdhënieve të mira komunitare në radhë të parë, pastaj edhe paqes e harmonisë ndërkombëtare. E kështu kemi mundësi t'i tregojmë botës, që Kosova di të bëhet shtet. Shtet i të gjithë qytetarëve të saj, e jo shtet e spastrimeve etnike, ashtu siç kërkonte ta bënte regjimi i Millosheviqit.

PAQJA: Kuft ia dedikoni këtë çmim?

Idrizi: Pikësisht, familjes sime të mrekullueshme. Se pa përkrahjen e tyre, kurrsesi nuk mund të arrija asnjë sukses. Ekskluzivisht ia dedikojë një pjesë të këtij çmim babait tim, i cili, ishte një



njeri shumë i madh që fatkeqësisht, ka vdekur dhe nuk arriti ta shohë Kosovën e pavarur. Ai ishte edhe një ndërmjetësues shumë i mirë, i lidhur me aksionin në Kosovë për pajtimin e gjaqeve në atë kohë, me profesorin Anton Çeta. Ia dedikoj gjithashtu edhe kolegëve dhe kolegeve, me të cilët edhe punoj çdo ditë. Ky çmim është një përgjegjësi shumë e madhe, pasi në Kosovë, ka shumë femra shqiptare edhe më të guximshme, që kanë bërë e bëjnë edhe më shumë sesa unë dhe që e meritojnë këtë çmim gjithsesi. Këtë çmim ia dedikoj mbi të gjitha Kosovës së pavarur.

Jam përcaktuar të punoj për paqen, sepse nuk dua që të kemi një regjim siç ka qenë përpara.

PAQJA: Si e kanë pritur shpalljen e pavarësisë së Kosovës femrat serbe që janë të angazhuara në organizatën tuaj?

Idrizi: Është interesant të theksoj se edhe në kohën kur në Mitrovicë serbet organizonin protesta kundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës, gra serbe nga pjesa veriore e Mitrovicës më telefononin dhe kërkonin që organizata ta vazhdojë punën e saj, pra të vazhdojmë të punojmë për zbutjen e tensioneve. Këtë unë e konsideroj si një rezultat të çmuar të punës sonë disavjeçare. Unë e konsideroj si rezultat edhe vetë bashkëngjitjen e serbeve organizatës sonë, sepse ato kanë qenë të kërcënuar nga Beogradi, unë e kam parë dhe e kam përjetuar vetë frikën e tyre. Ato janë frikësuar shumë më tepër prej vetë serbëve se sa prej shqiptarëve.

PAQJA: A keni pasur vështirësi dhe kërcënime gjatë punës suaj?

Idrizi: Sigurisht se kam pasur, madje disa herë kam qenë e sulmuar dhe e rrahur nga gratë serbe në veri. Ndërsa sa i përket shqiptarëve, them se kam pasur gjithherë mirëkuptim. Ndoshta sepse edhe unë edhe kolegët jemi njerëz që kemi qenë aktivë dhe kemi kontribuar edhe përpara. Edhe unë si Valdete, edhe familja ime kemi dhënë mjaft kontribut për këtë popull, kështu që nuk e kanë pas aq lehtë të më akuzojnë pse po angazhohem për zbutjen e tensioneve ndëretni-



Çmimi Ndërkombëtar për 'Gra të Guximshme' është i vetmi vlerësim që jep Departamenti i Shtetit për gra që kanë marrë role udhëheqëse në botë. Ky vlerësim shihet si një mundësi unike për diplomacinë transformuese për çështjet e gruas.

ke, pse po bashkëpunoj me serbët, etj.

Unë jam përcaktuar të punoj për paqen, sepse nuk dua që të kemi një regjim siç ka qenë përpara. Mendoj se mënyra e vetme për të ndërtuar një shtet demokratik, është mënyra paqësore.

PAQJA: Cilat janë planet tuaja në të ardhmen?

Idrizi: Tani duhet të punojmë më shumë se kurrë. Do të vazhdojmë të punojmë me ato projekte që kemi nisur. Prioritetet për

ne si organizatë multietnike është që t'i bindim serbët që ta ndiejnë vetën si qytetarë të Kosovës. T'i bindim ata që kjo organizatë do të vazhdojë me të njëjtin mision edhe në republikën e Kosovës, e siç e thash misioni ynë është që ta bashkojmë Mitrovicën. Po nuk u angazhuam që ta krijojmë një gjendje stabile, nuk mund të nxisim investime të huaja. Andaj është detyrë e secilit qytetar që të punojë e të japë kontributin e vet për paqe e stabilitet.

PAQJA: Në fund cili do të ishte mesazhi juaj për lexuesit e revistës Paqja?

Idrizi: Së pari, më lejoni t'iu falënderoj juve Demir dhe revistën tuaj e cila mban emrin simbolik Paqja. Më duhet të them se është kënaqësi e imja që mu dha rasti që nëpërmjet kësaj reviste të "bashkëbisedoj" me lexuesit e çmuar të revistës e cila mban emrin e një misioni për të cilin unë

dhe bashkëpunëtorët e mi jemi duke u angazhuar. Mesazhi im është që të gjithë së bashku të angazhohemi për vendosjen e një paqeje të qëndrueshme në Kosovë dhe për ndërtimin e një shteti funksional dhe demokratik, se vetëm kështu mund të ecim përpara. ■



Korrespondencë nga Shkupi

Pika-pika u bëmë pus

Ajo që ka qenë për t'u habitur nga angazhimi për aderim në NATO është fakti se partitë dhe politikanët shqiptarë, pa përjashtim, kanë qenë më të zëshëm se ata maqedonas, ndonëse logjikisht do të duhej të ndodhte e kundërta.



Avni AVDIU

Para fillimit të samitit të NATO-s në Bukuresht, u dhanë disa deklarata nga politikanë vendorë se gjoja ftesa ishte e sigurt. Po ashtu e fuqishme ishte edhe deklarata e presidentit amerikan Bush. Ishte i habitshëm ky optimizëm i madh, në momentet kur gjasat e Maqedonisë për t'u bërë anëtare e aleancës nuk ishin as teorike, për shkak të vetos së paralamëruar greke. Dhe ndodhi pikërisht ajo që çdo realist do ta anticiponte se: "dalëngadalë treni po ikte".

"Me një politikë më fleksibile dhe të matur do të kishte qenë e mundur të tejkalohet hendeku ndërmjet dy vendeve. Dhe përherë kur dallimet janë të mëdha fajtori lypset te pala tjetër, ndonëse askush nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë. Kontesti Maqedoni-Greqi të kthen në antikë në filozofinë sokratike, ku zihen dy të drejta legjitime: ajo e shtetit për ta mbrojtur rendin e stabilitetin dhe ajo e individit për ta shprehur mendimin e lirë. Meqenëse është vlerësuar se të dy palët kanë të drejtë, kjo përplasje është konsideruar tragjike. Edhe në këtë rast: Maqedonia ka të drejtë në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe, nga ana tjetër, po ashtu Greqia pandeh se ka të drejtë të ndihet e rrezikuar, së paku nga pohimet e disa qarqeve radikale maqedonase, pretendimet territoriale të tyre dhe bilbordet e fundit ku flamurit grek i ishte veshur simboli i fashizmit. Në pozitën që ka vendi nuk janë të nevojshme pozicionet ekstreme ndaj Greqisë e aq më pak ndaj aleancës (shprehur në protestat anti-NATO të disa dhjetëra komunistëve maqedonas). Nga ana amerikane vendit iu bë e qartë fare mirë që ta shfrytëzojë pozitën gjersa në pushtet është presidenti i tanishëm Bush, përkrahës i madh i inkadrimit të Maqedonisë në NATO.

"Ajo që ka qenë për t'u habitur nga angazhimi për aderim në NATO është fakti se partitë dhe politikanët shqiptarë, pa përjashtim, kanë qenë më të zëshëm se ata maqedonas, ndonëse logjikisht do të duhej të ndodhte e kundërta. Në samitin e Bukureshtit, për çudi, në delegacion ishte vetëm një shqiptar, ministri i shëndetësisë mjeku dr. Imer Selmani (ndoshta është paraparë për të ofruar ndihmën e parë në rast se alivanoset dikush nga anëtarët e delegacionit).

Problemi i emrit nuk mund të zgjidhet me referendum...

Nga ana tjetër, vendimi i VMRO-DPMNE-s që të mbahet referendum për emrin është plotësisht i papërgjegjshëm, edhe kjo për disa arsye: 1) i iket përgjegjësisë vendimmarrëse 2) tregohet mosgatishmëri për t'u përballur me problemin 3) vendimi i lihet popullit edhe pse populli në rastet e tilla kur kemi të bëjmë me çështje nacionale është i prirë më tepër të marrë vendime emocionale 4) në rastet kur ambiguiteti sillet ndërmjet identitetit dhe prosperitetit, gjasat për manipulim të palëve pro et contra, njërit e tjetrit pozicion, janë të mëdha. Dhe shtrohet pyetja më thelbësore në këtë mes: nëse do të ketë referendum, duhet të ketë edhe fushatë para atij referendumi, atëherë si do të reagohet ndaj një fushate të tillë?! Politikanët do të flasin për të votuar për apo kundër?! Pas përfundimit të referendumit, si do të ndiheshin politikanët që kanë ftuar 'kundër', nëse rezultatet e votimit janë 'për' dhe anasjelltas si do të ndiheshin politikanët që kanë ftuar 'për' nëse rezultatet e votimit do të ishin 'kundër'?

Vargu zinxhior i pyetjeve hipotetike vazhdon: Nëse eventalisht populli voton që të mos bëhen lëshime ndaj Greqisë, ndërsa qëndrimi kokëfortë i vendit do të rrezikonte ardhmërinë e të gjithëve, do ta vinte në pikëpyetje pozitën gjeostrategjike të Maqedonisë, do të na braktisnin edhe aleatët e tanishëm dhe do të shtrengo-

heshim të kërkonim zgjidhje alternative, atëherë cili do të ishte ai politikan që do të merrte guximin e të thoshte se duhet ndryshuar verdikti i popullit?! Sa do të rrezikohej ai politikan të quhej tradhtar dhe tekefundit a do të guxonte bile të dilte në skenë ndonjë politikan i tillë?! Këto pyetje hipotetike mund të jenë shumë shpejt pyetje reale, prandaj vendimi për referendum është vendimi më absurd po të shprehemi me gjuhën e Albert Kamys që do ta shpinte vendin drejt një vetëvrasje politike të panevojshme. Maqedonia ka aleatë dhe për këtë duhet të ndihet e lumtur. Andaj duhet të dijë se si t'i shfrytëzojë ata, e jo të angazhohet për t'i humbur. Në këtë sens, problemi i emrit nuk mund të zgjidhet me referendum, por me guxim të vendosur politik të strukturave vendimmarrëse. Tekefundit në sistemin demokratik pse bëhen zgjedhjet?. Nëse populli duhet pyetur për gjithçka, atëherë pse mbahen zgjedhjet e rregullta?! Sipas asaj logjike do të mjaftohej të mbaheshin anketa e sondazhe dhe të sillleshin përmes tyre vendimet e ndryshme qoftë të legjislativit ose ekzekutivit. Së këtëjmi deputetët, ministrat, kryeministri e kryetari kanë mandate të sjellin vendime politike dhe atë mandat e gëzojnë nga populli. Prandaj pse i frikësohen politikanët maqedonas vendimmarrjes?! Kjo moskonseguencë i ul ata, duke ua zbritur kredibilitetin deri në minimum. Dhe pas kësaj mund të debatohet gjerë e gjatë sa do të ketë përgjegjësi morale, kjo garniturë politike të qëndrojnë edhe më tej në krye të shtetit, kur heziton të marrë përgjegjësi përpara momenteve kaq të rëndësishme historike për vendin.

"Në këtë situatë më së miri u gjend BDI. Ishte moment i qëlluar i kësaj partie opozitare shqiptare ta gjejë veten në pozitë të përshtatshme për t'u këndellur. VMRO-DPMNE përmes rezistencës në kontekstin me Greqinë ngjalli pasionet nacionaliste dhe natyrshëm e sheh momentin e volitshëm që ngritjen e rejtingut ta shfrytëzojë me një rikonfirmim të mandatit, sipas parimit më mirë edhe

katër vite se edhe dy në pushtet. Ndryshe pas dy vitesh kjo parti s'do të kishte gjasa të gëzonte atë mbështetje që do të mund ta gëzonte tani. Pikërisht për këtë opozita maqedonase LSDM-ja ndihet e trembur nga zgjedhjet e parakohshme, sepse ajo ishte e gatshme për ndërrimin e emrit, në këmbim të integritetit në strukturat euroatlantike, pra doli nga binarët e nacionalizmit. Edhe pse kjo parti ishte më realiste për rrethanat, sipas të gjitha gjasave do të ndëshkohet nga elektorati për mosvendosmëri ndaj palës kundërshtare. Në rastet e tilla populli çmon më tepër vendosmërinë edhe kur ajo bëhet për taktizime sesa fleksibilitetin. PDSH-ja fillimisht u prononcua kundër zgjedhjeve sepse asaj i ngeli puna në gjysmë-rrugë. Ajo (sigurisht në marrëveshje paraprake) i adresoi qeverisë një ultimatum prej gjashtë pikave, ku sublimoheshin kërkesat më kryesore të komunitetit shqiptar. Pas, kinse, një rezistence në trajtë akuzash e kundër-akuzash, kryeministri Gruevski i pranoi kërkesat, gjë që e riktheu sërish PDSH në qeveri. Dhe kur tashmë komisionet ishin formuar për implementimin e atyre kërkesave, BDI doli me kërkesën për zgjedhje të parakohshme. Në lojërat politike kjo mund të quhet ndryshe 'thikë pas shpine PDSH-së'. Në të vërtetë BDI-ja gjithnjë ka menduar se ideja e gjashtë pikave ishte një lloj huazimi i idesë nga marrëveshja Gruevski-Ahmeti që ngeli në letër. Kur jemi te pikat, si ajo e majit (të vitit të shkuar) me Ahmetin, si ajo e marsit (të këtij viti) me Thaçin kanë qenë thjesht të panevojshme. Çfarë kanë pasur nevojë partitë shqiptare të merren me pika-pika kur kanë pasur 'liqenin e Ohrit'?! Pse të merremi me mini-marrëveshje kur kemi super-mega-ultra-marrëveshje të garantuara ndërkombehtarisht... etj?! Pse duken kaq meskine politikat shqiptare në Maqedoni, politikë kjo e inateve dhe hakmarrjeve reciproke mes vete?

"Kështu është puna kur secili krye në vete përpriqet të dal dikushi... kur njëri-tjetrit i shesim mend, kur duke e mundur njëri-tjetrin humbim nga pala maqedonase... Zaten kështu siç shkojnë punët nga pika-pika s'do të mundemi të bëjmë as pus...nga pika-pika do t'i kemi punët edhe më pus...e do të bëhemi pus e më pus..."

Javët e ardhshme në Maqedoni janë të paparashikueshme

"PDSH-së i ngeli puna në gjysmë-rrugë, prandaj nuk i deshi zgjedhjet dhe mezi u shpreh pro tyre. BDI-ja e ndjeu veten të rrezikuar para elektoratit të vet, sikur ato kërkesa të arrinte t'i realizonte PDSH-ja gjatë mandatit të saj qeverisë, sepse BDI me LSDM nuk kishin bërë gjë gjatë katër viteve paraprake. Prandaj pa mëdyshje ky zhvillim dramatik do t'i tensionojë edhe më tepër këto dy parti gjatë fushatave parazgjedhore. BDI-ja do ta akuzojë PDSH-n se s'bëri gjë gjatë dy viteve, kurse PDSH do ta akuzojë BDI-në se mu atëherë kur deshi të bënte hapa konkretë, nga xhelozia ia preu rrugën. Gjersa vazhdojnë të përplasen, xhelozia e BDI me inatin e PDSH, në këtë mes neutraliteti gjendet edhe një subjekt tjetër politik shqiptar BDSH-ja, që nga emërtimi ka huazuar nga dy partitë kundërshtare (ndërsa për nga praktika ende nuk është dëshmuar, prandaj sa për fillim del në skenë me ndërjegje më të pastër). Duket qartazi se kjo parti gëzon një mbështetje të fuqishme nga PDK-ja dhe kryeministri kosovar Hashim Thaçi për shkak të simpativë e preferencave të mëparshme me Bardhyl Mahmutin, ish strukturë politike e UÇK. Pra javët e ardhshme në Maqedoni janë të paparashikueshme: zgjedhje të parakohshme, presion ndërkombehtar për ndërrimin e emrit, krizë ekonomike etj. Si do të dilet nga ky qorrsoak mbetet të shihet. ■

Çka pas pavarësisë?

Naile DEMIRI

Nëse bëhet një vështrim i historisë njëqindvjeçare të aneksimit të Kosovës nga shtetet sllave, del se shqiptarët e Kosovës kanë qenë populli më i vuajtur, më i përndjekur, më i eksperimentuar dhe një popull model që ka mundur t'i përballojë shfarosjes duke e sfiduar gjenocidin që është bërë ndaj tij. Nga ky këndvështrim buron edhe fakti se ky formësim njerëzor, mund të quhet edhe sublim i kulturës humane ngase nuk u shkatërrua nga stuhitë e egra sllave. Preferencat e gabimeve tona kanë qenë evidente, por jo faktor qenësor në përshkrimin e historisë njëqind vjeçare... Gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore, përkundër faktit se ishin shpërngulur më se 250.000 shqiptarë nga trojet e tyre për në Turqi, e me mijëra të tjerë kishin gjetur vdekjen nga torturat serbe e greke brenda një kohe relativisht të shkurtër, disa bajraktarë të tokave shqiptare i mundësuan ekzistencën Serbisë duke lejuar kalimin nëpër toka shqiptare. Gjatë luftës së Dytë Botërore formohet shtresa komuniste që i bashkëngjitet komunizmit, njërës ndër fantazmat më famëkeqe që nga skllavëria. Ende sot e kësaj dite shkollat tona mbajnë emra të komunistëve. Në Kosovë, sot ende çmohen njerëzit që i kanë ndihmuar regjimit sllav, çmohen personat të cilët i ka formësuar kuzhina serbe, e shumë e shumë anomali tjera. Që tetë vite pas çlirimit të Kosovës, ende gjenden situata të mjerueshme e konflikte, të cilat vështirë se mund të tejkalohen. Përgjithësisht në tokat shqiptare nuk ka dialog në mes të qytetarit dhe qeverisë. Shumica e qeverive të formuara deri më tani kanë dëshmuar se kanë mundur të përvetësojnë përfitime personale. Andaj kjo ka mbetur maksimë, vlerë dhe moral i qeverive. Individualiteti i theksuar në vëllimin e shpirtit shoqëror, duke bërë përpjekje që çdo gjë të nisët nga fillimi, si duket ka ndikuar që të gjendemi këtu ku jemi. Marrëdhëniet qeveri-popull nuk mund të konsolidohen, të kulturohen, të përpunohen etj., pa vendosjen e dialogut të sinqertë, të njëmendtë dhe tërësisht njerëzor në mes të popullit e të qeverisë. Kjo praktikë politike në shtetet më të përparuara të botës është tejkaluar kaheerë. Në tokat shqiptare, qeveritë, njëra pas tjetrës, merren me vetveten. Tërë veprimtarinë e tyre e konceptojnë se si ta sundojnë, e jo si ta drejtojnë popullin. Konfliktet e brendshme klanore, e tani partiake kanë bërë ngufatjen e zhvillimit ekonomik, politik e shoqëror përgjithësisht të shoqërisë shqiptare. Brezi i ri është i interesuar ta dijë a ka mundësi që qeveritë tona t'i ndihmojnë qytetarët që t'i zgjidhin problemet e tyre, a ka mundësi që qeveritë tona të merren me sigurimin e jetës së qytetarit dhe a ka mundësi që në tokat shqiptare të flaket njëherë e përgjithmonë praktika e luftës qytetare. E çka pas pavarësisë: dashuri njerëzore, harmoni, punësim dhe zhvillim ekonomik në mënyrë që të jeta jetohet nga të gjithë ashtu siç është më së miri. ■

Zgjedhjet studentore në UP

Paqja Studentore lë në opozitë UPS-UP-në dhe UPSK-në

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, katër organizata studentore: PS-UP-së, USSH, AS-UP-së dhe VS-UP-së, kanë arritur marrëveshje koalicioni në mes vete, për ta udhëhequr Parlamentin Studentor të UP-së. Në bazë të marrëveshjes së arritur parashihet që kryetari i Parlamentit, sekretari dhe nënkryetarët të udhëheqin me rotacion.



Gëzim QERIMI

Në 17 fakultete të Universitetit të Prishtinës, më 3 prill janë mbajtur zgjedhjet e studentëve. 15942 studentë kanë hedhur votën e tyre për 11 organizatat pjesëmarrëse në këto zgjedhje. Ata kanë votuar për Parlamentin Studentor dhe për Këshillat studentore në 17 fakultete.

Për dallim nga zgjedhjet e kaluara, të mbajtura në vitin 2006, në këto zgjedhje fitesës për të dalë në votime i janë përgjigjur një numër më i madh i studentëve.

Vetëm për Parlamentin Studentor kanë votuar 21.5 % ose 7896 votues (4.5% më shumë se sa në vitin 2006)

Për 17 këshillat studentore të fakulteteve 21.8% ose 8046 votues (4.9% më shumë se sa në zgjedhjet studentore të vitit 2006)

E veçanta tjetër është se nga 11 organizata studentore sa kanë konkurruar, vetëm 7 prej tyre do të përfaqësohen në Parlamentin e Studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, katër organizata studentore: PS-UP-së, USSH, AS-UP-së dhe VS-UP-së, kanë arritur marrëveshje koalicioni në mes vete, për ta udhëhequr Parlamentin Studentor të UP-së. Në bazë të marrëveshjes së arritur parashihet që kryetari i Parlamentit, sekretari dhe nënkryetarët të udhëheqin me rotacion.

Nga subjektet studentore që do të marrin qeverisjen e Parlamentit Studentor për dy vitet e ardhshme, vetëm Paqja Studentore ka qenë pjesë e mandatit të

kaluar, ndërkaq tri organizatat tjera janë të reja në udhëheqje.

UPS-UP-ja dhe PS-UP-ja më të suksesshme

Dy nga organizatat më të suksesshme që kanë dalë nga këto zgjedhje janë UPS-UP-ja dhe Paqja Studentore e Universitetit të Prishtinës.

Relativisht të suksesshme kanë qenë edhe Lista Studentore Reforma e Universitetit të Prishtinës dhe Unioni i Studentëve Shqiptarë me mbi dy mijë vota.

Më poshtë po i paraqesim rezultatet e certifikuar nga KQZ-ja për të gjitha fakultetet për Parlamentin Studentor dhe për 17 Këshillat Studentore:

Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës –UPS-UP-ja 2778 vota;

Paqja Studentore e Universitetit të Prishtinës –PS-UP 2746 vota;

Lista Studentore Reforma e Universitetit të Prishtinës LSR-UP 2106 vota;

Unioni i Studentëve Shqiptarë USSH 2092 vota;

Unioni i Pavarur i Studentëve të Kosovës UPSK 1790 vota;

Alternativa Studentore e Universitetit të Prishtinës AS-UP 1564 vota;

Vizioni Studentor i Universitetit të Prishtinës VS-UP 1080 vota;

Organizata e Re Studentore e Universitetit të Prishtinës 754 vota; dhe

Shoqata për aftësim profesional të Studentëve SHAPS 166 vota.

Lushtaku: Koalicioni është zyrtar

Mandatari i koalicionit Mergim Lushtaku, kryetar i Kuvendit të Paqes Studentore, ka pohuar se organizatat studentore, të cilat sipas koalicionit, e arrijnë 50% +1 do ta udhëheqin Parlamentin. Sipas tij, organizata Paqja

Studentore ka arritur që ta sigurojë shumicën në Parlament si mandatarë për qeverisjen e studentëve.

Në bazë të marrëveshjes së arritur në mes të organizatave PS-UP-së, USSH, AS-UP-së dhe VS-UP-së parashihet që kryetari i Parlamentit, sekretari dhe nënkryetarët të jenë në rotacion mes katër organizatave studentore.

Lushtaku ka theksuar se organizata Paqja Studentore e cila ka bërë koalicion me tri organizatat të tjera, ka arritur 17.5 % të votave në të dy nivelet.

“Koalicioni ynë është paraparë në bazë të bisedave të mëhershme që i kemi bërë. Qëllimi ynë është që studentët e UP-së t’i përfaqësojmë në mënyrë të denjë”, është shprehur Lushtaku, duke shtuar se për vetë faktin se UPS-UP-ja dhe organizatat e tjera opozitare nuk kanë arritur përqindjen e duhur 50+1% të votave tregon se studentët e UP-së i kanë ndëshkuar organizatat që i kanë udhëhequr më herët. ■

Pozitë-Opozitë

Nga subjektet studentore që do të marrin qeverisjen e Parlamentit Studentor për dy vitet e ardhshme, vetëm Paqja Studentore ka qenë pjesë e mandatit të kaluar, ndërkaq tri organizatat e tjera janë të reja në udhëheqje. Ndryshe, pas 38 viteve në drejtimin e studentëve UPS-UP, së paku për dy vitet e ardhshme, së bashku me UPSK, që ishin pozitë për dy vite në Parlamentin Studentor, tashmë do të përbëjnë një opozitë të fortë së bashku me organizatën studentore “Reforma”, pasi Paqja Studentore nuk ka pranuar që të jetë partnere e qeverisjes me UPSK-në dhe LSR-në.



Njohja e kulturës së shkollës



Fitim VELIU

Njohja e kulturës së shkollës është një kompleksitet, sepse kërkon një koordinim në marrjen e vendimeve të përbashkëta ndërmjet mësuesit dhe nxënësit. Kjo për fat të keq te ne ndodh rrallë herë, pasi që mësuesit ende veprojnë si në të kaluarën duke u treguar në të shumtën e rasteve "autoritativë".

Në ciklin e arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë, ekziston koncepti kulturë e shkollës. Ky koncept ka ardhur duke u polemizuar vazhdimisht nëpër kohë, sidomos pas viteve të 90-ta. Përpjekjet për të bërë ndryshime në shkolla në aspektin metodik, profesional dhe etik gjatë këtyre viteve patën dhënë shumë pak sukses, sepse shumë nga këto reforma ishin më shumë formale jo substanciale, se sa shprehnin brendinë e tyre të vërtet për ndryshime esenciale. Po ashtu edhe influenca e tyre në procesin e mësim nxënies tek arsimtarët, të cilët do të merrnin primatin për ndryshimin e këtyre reformave, nuk po haste në rezultatin e duhur.

Parimet mbi të cilat ngrihet kultura e shkollës

Parimi i parë i cili shoqëron kulturën e shkollës është sistemi, i cili është entitet i përbërë nga shumë elemente dhe kom-

ponentë të cilët inkorporohen në mënyrë që ai të ketë efektin e tij pozitiv. Drejtoria e arsimit do të ishte shembull i sistemit; ajo është e përbërë nga grup njerëzish, grup rregullash, konventash... Po ashtu sistemi ka nënsisteme, si p.sh. programet e mësimin, grupet e nxënësve, talentet etj.

Sistemet janë të rëndësishme, sepse funksionojnë dhe bashkëveprojnë si një tërësi, si mënyrë e stimulimit të punës së mëtutjeshme. Sot kultura shkollë karakterizohet nga një pasiguri e madhe. E para, sepse vlerat e saj nuk perceptohen lehtë dhe e dyta nivelet e shkollës sonë ndryshojnë shumë njëra nga tjetra, ose nga rrethi në rreth. Së treti, normat dhe vlerat ndryshojnë nga shkolla në shkollë. Arsimtarët mësojnë rolet e tyre nga përvoja, pavarësisht nga përmbajtja e arsimit që kanë marrë, ku normat vërehen në dallime të dukshme në atë se për të gjithë mësimdhënësit, si të shkollës fillore, ashtu edhe asaj të vjeçare, mësimdhënia është një aktivitet. Dhe së katërti mësimdhënia është një aktivitet kompleks, e cila nuk mbështetet në kërkimet shkencore, ku njohuritë bazë që lidhen me mësimin janë të dobëta, ndërsa arti i dhënies së mësimin nuk mund të matet.

Kultura shkollë zhvillohet me kalimin e kohës. Parimet mbi të cilat do të ngrihet kjo kulturë do të ishin: 1. arritja e nxënësve në testime; 2. nxitja dhe frenimi në orë mësimi; 3. entet kritike. Një problem serioz që po i paraqitet sot kulturës shkollë është mbizotërimi i psikologjisë arsimore në kualifikimin e mësuesve dhe arsimtarëve në dëm të kulturës, normave

dhe ndërveprimeve. Këto gjëra vihen re në sociologji dhe antropologji, të cilave u mungojnë programet e përgatitjes së arsimtarëve.

Formimi në aspektin kulturor të shkollës duhet të jetë i shumanshëm

Shkollat kanë tendencën që të zhvillojnë kulturën e tyre në mënyrë të pavarur nga shkollat e tjera, pra normat dhe vlerat mund të lindin nga brenda. Nga kjo vjen edhe komenti joprofesional që u bëhet të gjithë arsimtarëve "harrojeni gjithë teorinë universitare, tani jeni në botën e vërtetë". Ky koment pasqyron qëndrimin anti-intelektual dhe mund të ketë efekt deri në shkatërrimin e arsimit dhe së fundi një kulturë e përgjithshme shkollë teknike është e dobët, edhe pse kemi teste vlerësimi, kompjuter, teleskop, të cilat që të gjitha e ngrenë lart kulturën e shkollës.

Megjithatë, kultura e përgjithshme e shkollës nuk është e sofistikuar në kuptimin e teknologjisë së lartë. Shkolla sot përshkruhet si ndërtesë, luftë, kopsht lulesh, ndërsa veprimet tona marrin formë varësisht nga perceptimi që kemi për kulturën. Andaj formimi në aspektin kulturor të shkollës duhet të jetë i shumanshëm në relacionin nxënës-arsimtar-personel shkollë-drejtori. Kjo do t'i favorizonte elementet deri në bashkëpjesëmarrje vendimesh të përbashkëta për të mirën e shkollës. Në të kundërtën njohja e kulturës së shkollës në mënyrë parciale do të linte boshllëk në krijimin e kulturës së përgjithshme shkollë. ■

Ekspertet e FMN-së paralajmërojnë ditë të këqija për ekonominë botërore

Ekonomia globale në krizë!

Në Watford të Londrës është mbajtur samiti dyditor i zhvillimit ekonomik, i cilësuar si një rast historik për të diskutuar lidhur me ndryshimet globale ekonomike, luftimin e varfërisë, kërcënimin e sigurisë dhe njohjen e ndryshimeve ekonomike të globalizimit.



Sead UJKANI

Në dy dekadat e fundit, përkatësisht në pesëmbëdhjetë vjetshin e kaluar, ekonomia botërore është karakterizuar në tërësi nga ndryshime të mëdha. Globalizimi, në përgjithësi, ka imponuar rregulla të reja të zhvillimit të ekonomive kombëtare. Si i tillë, ky proces me gjithë përparësitë e tij në drejtim të sigurimit të të mirave financiare dhe hapjes ndaj integriteteve globale për shtetet përkatëse, ka si rrjedhojë edhe jostabilitetin i cili shkaktohet nga ndryshimet e shumta në tregun global, me theks të veçantë krizat që e kanë përshkuar tregun financiar botëror vitet e fundit.

Me qëllim të diskutimit të problemeve aktuale të ekonomisë globale dhe promovimit të vazhdueshëm të procesit të globalizimit që do të siguron-te prosperitetet në vendet e zhvilluara dhe atyre në zhvillim, në javën e parë të këtij muaji, në Watford të Londrës, u mbajt samiti dyditor i zhvillimit ekonomik.

Pjesëmarrës në këtë samit ishin ekspertë të njohur të ekonomisë botërore, liderë politikë të shteteve të ndryshme si dhe personalitete të shumta të jetës shoqërore nga mbarë bota, ndër të cilët Kryeministri britanik Gordon Brown (i cili ishte nikoqir i këtij samiti), ai Italian Romano Prodi, ish-presidenti amerikan Bill Clinton, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare përfshirë Kombet e Bashkuara, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bashkimin Evropian dhe Bankën Afrikane për Zhvillim.

Ideja fillestare e mbajtjes së këtij samiti ishte rritja e bashkëpunimit në mes politikbërësve kryesorë në botë me qëllim të sigurimit të një vendtakimi për ndryshimin e politikave dhe praktikave konkrete.

Nevojitet përpjekje e re për ta ndaluar varfërinë

Në hapje të këtij samiti, kryeministri britanik Gordon Brown theksoi se samiti ishte duke u mbajtur në një kohë kur njerëzit rreth botës janë të koncentruar jo vetëm rreth pasigurisë globalo-ekonomike, por në një kohë kur është identifikuar fakti që zgjidhjet për prob-

i FMN-së Straus-Kahni i cili ka ngritur shqetësimin se shumica e rreziqeve në ekonominë e botës tashmë janë bërë realitet. “Parashikimet që do t’i japim në ditët e ardhshme nuk janë duke u përmirësuar”, ka thënë Straus-Kahn, duke shtuar se lidhur me këtë, në raportin e fundit të publikuar këto ditë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar është evidentuar se humbjet mbarë botërore, që nisën nga kriza e kredive të patundshmërive, mund të arrijnë deri në 945 miliardë dollarë në ekonominë globale. FMN-ja këtë vit pret rritje globale të ngadalësuar prej 3.7 për qind. Parashikimi i FMN-së për këto humbje nënkupton 142 dollarë për çdo banor të botës. FMN-ja thekson, gjithashtu, se vlerësimi i humbjeve nuk është perfekt dhe humbjet mund të jenë edhe më të mëdha.

Ndërsa ish-presidenti amerikan Bill Clinton, në këtë samit, është angazhuar për një transparencë më të qartë, më të drejtë dhe urgjente.

Në samit gjithashtu është diskutuar edhe për ndryshimet klimatike, zhvillimin ndërkombëtar dhe reformimin e institucioneve ndërkombëtare, mirëpo në përgjithësi samiti është fokusuar në problemet e vazhdueshme të ekonomisë botërore.

Nevoja për vendosjen e rregullave të reja për sigurimin e transparencës në institucionet financiare ishte një marrëveshje e përgjithshme në mes liderëve.

Në përfundim liderët pjesëmarrës në këtë samit kanë lëshuar një komunikatë me anë të së cilës është nxitur Fondi Monetar Ndërkombëtar që të kontribuojë në zhvillimin e një sistemi efektiv të paralajmërimit të hershëm, si ruajtje ndaj rreziqeve financiare në ekonominë globale. ■



lemet ndërkombëtare kërkojnë një bashkëpunim të ri. “Ky është një rast historik për t’u bërë së bashku për të diskutuar ndryshimet globale ekonomike, luftimin e varfërisë, kërcënimin e sigurisë sonë dhe njohjen e ndryshimeve ekonomike të globalizimit. Nevojitet një përpjekje e re për ta ndaluar varfërinë”, ka theksuar Brown. Ai i ka quajtur krizat aktuale ekonomike globale ndryshimin më të madh të këtij lloji në shekujt e kaluar. “Ne jemi duke u përballur me krizat më të mëdha të epokës së re, me atë që është duke ndodhur në tregjet financiare”, ka thënë Brown.

Liderët kanë dëgjuar një fjalim të erret ekonomik nga Drejtori menaxhues

Rruga Durrës-K

rruga e sh

Rruga është e planifikuar me katër korsi me një shpejtësi të planifikuar që shkurton shumë kohën që duhej përshkruar në rrugën e mëparshme me një strukturë deri në 80 metra në lartësi që e bën një prej projekteve më



Besim R. CENGU

Bechtel & Enka JV po ndërton segmentin rrugor më të vështirë të autostradës Durrës-Kukës me një gjatësi prej 60,85 km me katër korsi, përfshirë 5.5 km tunel, nën një kontratë të firmosur qysh në shtatorin e vitit 2006 me qeverinë shqiptare. Autostrada do të ketë katër korsi dhe aktualisht është më e madhja – madje projekti më i madh në Shqipëri, sipas zyrtarëve qeveritarë dhe specialistëve. Tuneli do të jetë vepra më e madhe e këtij lloji në Ballkan.

Rruga do të jetë pjesë e një autostrade prej 170 km për të përmirësuar lidhjen me Kosovën, por edhe me Ballkanin e brendshëm. Kjo do të rezultojë në një rrugë më të shkurtër midis portit të Adriatikut në Durrës pranë Tiranës, dhe Morinës në kufi me Kosovën. Kjo rrugë me rëndësi historike do të bëjë të mundur shkëmbimin e mallrave dhe njerëzve në drejtim të Detit dhe anasjellas. Ndryshe rruga Durrës-Kukës-Prishtinë është quajtur edhe rruga e bashkimit kombëtar. Dhe në fakt ashtu është.

Është kryer 30 për qind e punës

Kohëzgjatja e Projektit sipas marrëveshjes që qeverisë shqiptare me firmat kontraktuese do të jetë katër vjeçare

(2006 – 2009), ndërsa vetëm pjesa që ka marrë përsipër Bechtel & Enka JV me gjatësi 60,85 km ka dy tunele me gjatësi 5,53 km secili. Deri në mesin e muajit prill 2008 janë hapur rreth 3.5 km tunel në të dy anët, ose rreth afro 30 % e gjithë punës. Duke parë volumin e kryer të punëve aktuale dhe ecurinë e avancimit në tunel (rreth dhjetë metra në ditë), me siguri në pranverën e vitit 2009 tuneli do të jetë i përfunduar, që do të thotë që pjesa më e vështirë e rrugës do të përfundojë brenda afateve të përcaktuara. Sipas njërit prej grupit supervisor të tunelit, inxhinierit Ramazan Bajraktari, punimet po kryhen mbi bazën e standardeve ndërkombëtare dhe cilësia është mjaft e lartë, kjo falë përvajtës së specialistëve, por edhe kontrollit rigoroz të punimeve zë për zë dhe në përputhje me kërkesat që ka një vepër madhore. Ndërsa drejtuesi i kompanisë kroate i supervizionit të këtij segmenti IGH, Ilaçiq, na sqaron se “kontrolli i punimeve nga ana jonë është shumë rigoroz” që garanton punë me cilësi dhe mbi bazën e parametrave bashkëkohorë.

Rruga është e planifikuar me katër korsi me një shpejtësi të planifikuar të lëvizjes së mjeteve nga 80 deri në 100 km në orë, shpejtësi e cila shkurton shumë kohën që duhej përshkruar në rrugën e mëparshme. Segmenti do të ketë 27 ura, afro 4,5 km rrugë do të jetë mbi ura dhe struktura deri në 80 metra në lartësi që e bën një prej projekteve më të vështira për t'u realizuar.

Rruga e re 45 km më e shkurtër se rruga ekzistuese drejt Kosovës

Autostrada Durrës-Morinë do të jetë gati 45 km më e shkurtër se rruga ekzistuese drejt Kosovës dhe koha e udhëtimit do të reduktohet me dy orë nga gjashtë orë të tanishme. Dy korsitë ekzistuese që gjarpërojnë rrugën kufizojnë shpejtësinë mesatare me më pak se 40 km për orë. Shpejtësia e parashikuar për rrugën e re, siç thamë më sipër është 80-100 km/orë. Rruga ekzistuese, me “zvarritje” korsish e terren rrugor tepër të pjerrët i pengon ngarkesat e mallrave të kamionëve duke i bërë ata të lëvizin ngadalë.

Rruga e re është shumë e rëndësishme për Shqipërinë sepse shumë turistë që vizitojnë vendin janë nga Kosova ose Maqedonia. Qeveria pret një rrugë më të shkurtër për të nxitur



Deri më tani janë hapur rreth 3.5 afro 30 % e gjithë punës.

Kukës-Prishtinë

Shqiptarëve

ar të lëvizjes së mjeteve nga 80 deri në 100 km në orë, shpejtësi e cila
. Segmenti do të ketë 27 ura, afro 4,5 km rrugë do të jetë mbi ura dhe
të vështira për t'u realizuar.

ekonominë dhe për përmirësimin e hyrjes drejt Durrësit, që është 35 km larg nga Tirana, duke sjellë të ardhura dhe turistë të mërguar drejt zonave veriore e lindore të Shqipërisë. Mbi të gjitha, kjo arterie kyçe do të bëjë të mundur qarkullimin e mallrave prej detit Adriatik në Kosovë e më tej dhe anasjelltas, akt i cili do të zhvillojë me ritme tepër të shpejta ekonominë e këtyre vendeve. Deri sot përgjatë rrugës së vjetër vetëm 7 % e qarkullimit të mallrave nga Shqipëria kanë lëvizur në drejtim të Kosovës dhe anasjelltas, për shkak të rrugës së keqe, ndërsa me ndërtimin e autostradës ky segment do të shndërrohet në një prej rrugëve më të rëndësishme në Ballkan.

Nga tre segmentet që ka marrë përsipër Bechtel & Enka JV, do të ndërtojë këtë pjesë të autostradës në tre seksione: Rrëshen deri në Reps (19.5 km), Reps

deri në Thirrë (26.5 km), Thirrë deri në Kalimash (14.85 km). Sipas kontratës së nënshkruar mes qeverisë shqiptare dhe Bechtel & Enka, projekti bazohet mbi një çmim njësi të caktuar dhe do të përfundojë në Korrik 2009. Drejtuesi i Bechtelit, Krist Dikson, garanton përfundimin në afatin e përcaktuar të rrugës. Për segmenti Rrëshen-Kalimash, që është më i vështiri dhe më i shtrenjti, është organizuar një tender i hapur ndërkombëtar. Kontratat "përbëjnë një vlerë prej 400-500 milion eurosh për një aks prej afro 115 km, që do të zhvillohet në pjesën më të madhe të tij si një autostradë me 4 korsi, e standardeve 2005 të Bashkimit Evropian dhe në pjesën tjetër sipas standardeve CNR4, të njohura tashmë si standardi bashkëkohor evropian dhe konkretisht italian, për të lejuar kështu një komunikim transporti mallrash e pasagjerësh në të dy drejtimet, për një sasi kohore jo më të madhe se dy orë dhe jo më të madhe se tre orë për transportin e mallrave. Sipas ministrit të transporteve të qeverisë shqiptare, "këto specifika përmbushin plotësisht fizibilitetin e aksit Durrës-Kukës-Morinë, si një aks i rëndësishëm jo thjesht kombëtar, por rajonal dhe strategjik për të gjithë rajonin".

Punimet kanë pasur ecuri më të mirë se parashikimet

Ndërkohë që punimet në rrugën e re, Durrës-Kukës nga kompania "Bechtel

& Enka" kanë pasur ecuri më të mirë se parashikimet, duke marrë kështu një pjesë të fondeve që nuk kanë mundur të realizohen në pjesët e tjera të kësaj rruge. Konkretisht, pjesëve të rrugës, që janë marrë përsipër prej firmave, Kastrati, Geci, Granit etj, u ka kaluar afati i përfundimit të tyre që në muajin shkurt të këtij viti, sipas të cilëve duhet të kishin përfunduar. Mirëpo deri tani nuk është arritur as 50 % e punimeve. Sipas drejtuesve të këtyre firmave pengesat janë jo vetëm ndryshimi i projektit, si në rastin e segmentit të autostradës që kalonte në afërsi të qytetit të Kukësit, por edhe të mungesës së fondeve akorduar prej qeverisë.

Pas shumë debatesh dhe akuzash për abuzime, qeveria ka koston për rrugën Durrës-Kukës. Kostoja totale nuk do të jetë më shumë se 620 milionë euro, ka deklaruar ministri i Transportit, Sokol Olldashi. Nga kjo shumë, 520 milionë euro kushton ndërtimi i aksit Rrëshen-Kalimash, ku është i përfshirë edhe tuneli, dhe 100 milion euro të tjera nevojiten për pjesën tjetër të aksit. Kështu, një kilometër i këtij segmenti kushton më shumë se 9 milion euro. Për realizimin e këtij aksi, të përcaktuar si prioritet nga qeveria "Berisha", ka pasur të dhëna të ndryshme deri më tani, por fillimi i punës në disa segmente dhe përmbyllja e studimit të fizibilitetit për disa të tjerë e ka bërë koston konfuze dhe të paqartë. Aksi që lidh portin e Durrësit deri në Morinë

km tunel në të dy anët, ose rreth

është 170 kilometra, ku 111 prej tyre do të jenë rrugë të reja, të ndërtuara sipas standardeve që realizohen autostradat (katër kalimshe). Investimi i shekullit në infrastrukturën rrugore shqiptare po kalon mjaft peripeci, duke përfshirë edhe një proces hetimor nga prokuroria dhe një tjetër hetim paralel që po zhvillohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Për të mbështetur me financime këtë projekt, qeveria ka marrë një kredi me kushte tregtare prej 270 milion eurosh nëpërmjet një ankandi. Ndërkohë që 20 milion euro të tjera janë firmosur me Bankën Islamike, po për këtë rrugë. Nga ana tjetër, tepriat buxhetore nga mosrealizimi i investimeve në vijimësi do të përdoren për financimin e këtij aksi. Aktualisht po bëhen punime në aksin Milot-Rubik-Rrëshen, të realizuara nga Ministria e Mbrojtjes, si dhe ndodhet në proces aksi Kalimash-Morinë. Ndërkohë, konsorciumi amerikano-turk, "Bechtel-Enka", po punon për ndërtimin e segmentit më të vështirë.

Rruga Durrës-Kukës do t'i hajë shtetit shqiptar një miliard euro

Ndërtimi i rrugës së re Durrës-Prishtinë po kalon me debate të ashpra që kanë përfshirë edhe prokurorinë në një proces hetimi, për shkak të kostove të larta që mbart projekti. Opozita ka përqendruar këtë vit kritikën ndaj qeverisë më së shumti në mënyrën e tenderimit dhe financimin të rrugës, duke bërë akuza të ashpra për korrupsion. Ndërkohë që prokuroria në hetim të kësaj çështjeje ka kërkuar heqjen e imunitetit të ministrit të Jashtëm, Lulzim Basha, ish-ministër Transporti në periudhën kur u krye tenderi. Deri më tani ka pasur të dhëna të ndryshme për shumën që kushton ndërtimi i kësaj rruge. Ekspertet e qeverisë "Nano" deklaroronin se ajo kushtonte 250-300 milion dollarë, por si një rrugë me vetëm dy kalime dhe një tunel me vetëm 2 korsi. Më pas, në vitin 2006, Ministria e Transportit publikoi një studim, sipas të cilit rruga

Durrës-Kukës do të kushtonte rreth 450 milion euro. Ndërsa sipas përcaktimeve më të fundit të ekspertëve të Ministrisë së Transporteve, kostoja e rrugës do të përfshijë një vlerë të përafërt me 620 milion euro. Financimet për përfundimin e këtij aksi po sigurohen nga buxheti i shtetit, ndërkohë që si përfundim tërësor i saj paraqitet qershori i vitit 2009.

Qeveria pranon se për rrugën Durrës-Kukës nuk ka ende një projekt të plotë dhe se punimet në autostradën që do të lidhë Shqipërinë me Kosovën dhe më thellë, po bëhen në bazë të projekteve të pjesshme. Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve në Komisionin Kuvendor të Ekonomisë, Drejtori i Përgjithshëm i Rrugëve, pranoi edhe faktin se për segmentin më të kushtueshëm të kësaj rruge, atë të Kalimash-Rrëshen, qeveria nuk ka ende një faturë financiare se sa do të kushtojë. "Për të qenë konsekuente me ju dua të them se mungesa e një projekti të plotë nuk na lejon të nxjerrim një përfundim të saktë mbi koston totale të projektit", iu përgjigj ai komisionit parlamentar të ekonomisë. Në fillim, qeveria deklaroi se për këtë segment mendohet të shpenzohen rreth 460 milionë euro, por kjo shifër duket se do të jetë dukshëm

Rruga është e planifikuar me katër korsi me një shpejtësi të planifikuar të lëvizjes së mjeteve nga 80 deri në 100 km në orë, shpejtësi e cila shkurton shumë kohën që duhej përshkruar në rrugën e mëparshme. Segmenti do të ketë 27 ura, afro 4,5 km rrugë do të jetë mbi ura dhe struktura deri në 80 metra në lartësi që e bën një prej projekteve më të vështira për t'u realizuar.

i shtetit është deklaruar për mediat se për rrugën Durrës-Kukës janë zhvilluar disa kontrole të imëta, në të cilët janë vërejtur shkelje dhe abuzime të rënda. Në rast se do të zbatohet projekti, realizimi i të cilit tashmë ka filluar, për ndërtimin e segmentit rrugor të Verilindjes, Durrës-Milot-Rrëshen-Kalimash-Kukës-Morinë, kostoja rezulton të jetë shumë më e lartë se sa parashikimi fillestar i qeverisë shqiptare. Burime nga kompanitë e huaja private, që janë drejt përfundimit të projektit për segmentin më të shtrenjtë të rrugës, atë midis Rrëshenit dhe Kalimashit, në të cilin parashikohet



Punëtorë të konsorciumit amerikano-turk, "Bechtel-Enka", që po punojnë në hapjen e tunelit...

më e madhe. Por ndërkohë, mësohet se punimet për rrugën Durrës-Kukës, po hasin në vështirësi inxhinierie dhe se janë me vonesë, nga sa ishin parashikuar në kontratë. Deri tani, qeveria ka paguar rreth 95 milionë euro për këtë rrugë, ndërsa pritet të paguajë edhe 60 milionë euro të tjera, deri në dhjetor të këtij viti. Ndërkohë, nga Kontrolli i Lartë

të ndërtohet edhe tuneli më i gjatë në Ballkan, prej 5,5 kilometrash, thonë se fondi prej 400 milionë eurosh, që ishte deklaruar më parë publikisht, është shumë larg kërkesave të ndërtimit të kësaj rruge. Madje, është, praktikisht, sa gjysma e fondit, që nevojitet realisht. Zëra specialistësh deklarojnë se rruga Durrës-Kukës do t'i hajë shtetit shqiptar një miliard euro pasi në shumë zëra punimesh edhe për shkak të terrenit të vështirë shpenzimet janë të paparashikuara.

Gjithsesi rruga Durrës-Kukës-Prishtinë po ndërtohet dhe ky eveniment tregon edhe rrugën e pandalshme të zhvillimit të gjithë shqiptarëve me ritme të shpejta. Gjithashtu kjo rrugë është quajtur me të drejtë edhe rruga e bashkimit shqiptar. Ndërtimi i kësaj rruge është njëkohësisht edhe realizimi i ëndrrës tonë të madhe. ■

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Ka vazhduar njohja...

Demir RESHITI

Suedia, Holanda, Sllovenia, Islanda, Finlanda, Kanada, Kroacia, Hungaria, Bullgaria, Koreja e Jugut dhe Norvegjia, janë 11 shtetet që gjatë muajit mars e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Edhe gjatë këtij muaji Kosova ka qenë në qendër të vëmendjes së institucioneve ndërkombëtare.

Vlen të veçohet autorizimi i presidentit të SHBA-së, George Bush për furnizimin e Kosovës me armatim, i cili është përcjellë me reagime të rrepta nga Beogradi dhe Moskë zyrtare. Kjo e fundit madje ka iniciuar mbajtjen e një mbledhjeje të jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe ka kërkuar negociatën e reja për statusin e Kosovës.

Për gjendjen në Kosovë është diskutuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në Nju Jork. Kosova ka qenë temë diskutimi edhe në takimin e shefave të diplomacisë së vendeve të BE-së që është mbajtur në Bruksel... Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit mars 2008.

(1 mars) Kacin: Njohja kryesore do të jetë nga Serbia

Lubjanë - "Njohja më e lartë dhe më e rëndësishme do të jetë njohja e Serbisë për statusin e Kosovës", ka thënë



Jelko Kacin

deputeti i Parlamentit Evropian dhe njëherësh raportues për Serbinë, Jelko Kacin në një tekst autorial në të përditshmen sllovene Delo.

(3 mars) Rusia kundërshton grupin drejtues për Kosovën

Moskë - Ministria e Jashtme Ruse e ka kundërshtuar krijimin e Grupit Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën, duke thënë se ky hap shkel vendimet e Kombeve të Bashkuara. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Mikhail Kamini, ka thënë se grupi i përbërë nga 15 vende mund të çojë në "pasoja të paparashikueshme" për Kosovën.



Jaap De Hoop Scheffer

(4 mars) Suedia dhe Holanda e njohën pavarësinë e Kosovës

Stokholm, Amsterdam - Suedia e ka njohur shtetin e pavarur të Kosovës. Kryeministri Fredrik Reinfeldt ka deklaruar se pavarësia e Kosovës do të jetë "e monitoruar ndërkombëtarisht dhe me sovranitet të kufizuar".

Qeveria holandeze bëri të ditur se nuk është nxituar ta marrë këtë veprim më herët pasi është siguruar se Prishtina zyrtare do të mbrojë të drejtat e njeriut, dhe në veçanti ato të minoriteteve.

(5 mars) Sllovenia dhe Islanda e njohën Kosovën

Lubjanë - Sllovenia e ka njohur shtetin e pavarur të Kosovës, duke u bërë kështu vendi i parë i ish-Jugosllavisë, që e njeh pavarësinë e Kosovës.

Edhe Islanda e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë një letër nga ministri i Punëve të Jashtme të Islandës, Ingibjorg Solrun Gisladottir, përmes të cilës konfirmohet njohja e Republikës së Kosovës - shteti i pavarur dhe sovran.

(6 mars) Scheffer: Situata në Kosovë është inkurajuese

Bruksel - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jaap De Hoop Scheffer ka thënë në takimin e ministrave të aleancës se "megjithëse gjendja në Kosovë është e brishtë", inkurajon fakti që pas shpalljes së pavarësisë "nuk ka dhunë ndëretnike, nuk ka largim masovik të refugjatëve, dhe nuk ka as sulme të organizuara në objektet e trashëgimisë historike".

(7 mars) Finlanda e njohu shtetin e Kosovës

Helsinki - Finlanda e njohu sot shtetin e pavarur të Kosovës, pas hapave të ngjashëm që bënë vendet e tjera skandinave.

Presidentja finlandeze Tarja Halonen e ka miratuar vendimin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën, pasi një gjë e tillë iu rekomandua nga qeveria e kryeministrit, Matti Vanhanen.

(8 mars) Kermabon: EULEX do të jetë në tërë Kosovën

Beograd - Shefi i misionit EULEX në Kosovë, Yves De Kermabon ka thënë për mediat e Beogradit se ky mision do të jetë i pranishëm në tërë Kosovën, dhe ka shtuar se është i papranueshëm krijimi i strukturave paralele policore në mjediset e banuara me serbë.

(9 mars) Bildt: Kosova mund të bëhet anëtare e BE-së



Carl Bildt

Stokholm - Ministri i jashtëm i Suedisë, Carl Bildt, ka thënë se Kosova mund të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, në rast se nuk anëtarësohet në

Kombet e Bashkuara. “Nuk ka lidhje formale ndërmjet këtyre dy gjërave”, ka thënë Bildt duke shtuar se tash është e rëndësishme që Kosova të konkurrojë për anëtarësim në ato organizata ndërkombëtare ku kjo është e mundshme, siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

(10 mars) BE diskuton për Kosovën

Bruksel-Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të BE-së janë takuar në Bruksel për të diskutuar situatën në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë dhe vendimit për dërgimin e misionit evropian. Një zyrtar i lartë nga presidenca sllovene e BE-së ka deklaruar se “Evropa po përcjell me kujdes situatën në Kosovë, përderisa atje po përgatit misionin e vet”.

(11 mars) Ban Ki Moon: Kosova është rast i veçantë

Moskë - Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki Moon ka thënë për mediat ruse se rezoluta 1244 është ende në fuqi dhe se UNMIK-u vepron në bazë të saj. “Duke mos dashur të komentoj pavarësinë e Kosovës, dua të them se ajo paraqet një rast të veçantë”, ka deklaruar Ban Ki Moon.

KS i OKB diskuton për situatën në Kosovë



Ban Ki Moon

Nju Jork - Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka diskutuar për situatën në Kosovë. Ambasadori rus Vitaliy Churkin, i cili është kryesues i Këshillit të Sigurimit për muajin mars, ka thënë se e ka propozuar këtë mbledhje, pasi konsideron se “gjërat po shkojnë shumë keq për disa çështje” që kur Kosova ka shpallur pavarësinë.

Ndërsa ambasadori amerikan në OKB, Zalmay Khalilzad, ka thënë se komuniteti ndërkombëtar e respekton Serbinë, por


Beogradi duhet të adoptohet me realitetin se pavarësia e Kosovës ka ndodhur.

(13 mars) Scheffer: KFOR-i garanton siguri dhe stabilitet

Varshavë - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jaap De Hoop Scheffer ka thënë se 16 mijë pjesëtarët e KFOR-it në Kosovë ndodhen atje për të mbrojtur shumicën shqiptare dhe pakicën serbe, si dhe për të garantuar klimën e sigurisë dhe të stabilitetit. Ai i ka bërë këto komente në Varshavë.

(16 mars) Mas: BE-ja nuk është e ndarë rreth Kosovës

Novi Sad - Ambasadori i Gjermanisë në Serbi, Volfram Mas deklaroi se Evropa nuk është e ndarë lidhur me pavarësinë e Kosovës dhe se njohja e saj është çështje e “vendimit të vendeve



Japonia


individuale anëtare, e jo e Bashkimit Evropian”. “Shumica e madhe e shteteve të BE-së e kanë njohur Kosovën. Dikujt thjesht i duhet pak më tepër kohë. Vendimtare është se vendet e BE-së, pa përjashtim, janë pajtuar që me anë të misionit EULEX të marrin përgjegjësinë në Kosovë”, i ka thënë ambasadori Mas, gazetës Dnevnik të Novi Sadit.

(17 mars) Rusia kërkon bisedime të reja për Kosovën

Moskë- Rusia ka bërë thirrje për bisedime të reja ndërkombëtare mbi statusin e Kosovës, duke thënë se trazirat e fundit ishin pasojë e shpalljes së njëanshme të pavarësisë. “Është e qartë se situata mund të normalizohet vetëm duke kthyer procesin e Kosovës në kornizën e ligjit ndërkombëtar, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja palët, e bazuar në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit”, thuhet në deklaratën e Ministrisë së Jashtme në Moskë.

(18 mars) Japonia njohu pavarësinë e Kosovës

Tokio - Japonia e ka njohur shtetin e pavarur të Kosovës. “Shpresojmë se Kosova do të kontribuojë në stabilitetin afatgjatë rajonal”, ka thënë shefi i diplomacisë japoneze, Masahiko Komura.



George W. Bush

Ki Moon: Serbia të ndikojë për ndaljen e dhunës

Nju Jork, Moskë - Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Moon, ka dënuar dhunën e minoritetit serb ndaj policëve të UNMIK-ut dhe forcave të NATO-s në Kosovë. Në deklaratë, Ban Ki Moon i bën thirrje Qeverisë serbe të përdorë ndikimin e saj të serbët e Kosovës, që të ndalin dhunën dhe të lejojnë veprimin e Kombeve të Bashkuara dhe NATO-s.

Ndërprerjen e dhunës e ka kërkuar edhe Sekretarja amerikane e shtetit, Condoleezza Rice. “Mendoj se jemi dakord se të gjitha palët duhet të përmbahen nga dhuna dhe nga çdo provokim. Ne po ua dërgojmë këtë mesazh të gjitha palëve në mënyrë të duhur”, ka thënë Rice pas takimit me zyrtarët e lartë rusë në Moskë.

Kanadaja e njohu Kosovën

Otavë - Kanadaja e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Këtë e ka bërë të ditur shefi i diplomacisë së këtij vendi, Maxime Bernier.

“Sot, ne iu bashkëngjitëm komunitetit ndërkombëtar dhe e njohëm Kosovën si shtet të ri”, i ka thënë Barnier transmetuesit publik kanadez CBS.

Kanadaja është e fundit nga grupi i shtatë vendeve më të industrializuara të botës G7, të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës.

(19 mars) Kroacia dhe Hungaria njohën pavarësinë e Kosovës

Zagreb, Budapest - Qeveria kroate e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Presiden-

ti i Kroacisë, Stjepan Mesiq, i ka dërguar një letër presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiut, në të cilën, vendimin e qeverisë kroate për ta njohur pavarësinë e Kosovës, ai e cilëson si themel për zhvillimin e marrëdhënieve ndërshtetërore midis dy vendeve, në frymë miqësie, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të ndërsjellë.



Sergei Lavrov

mi dhe mirëkuptimi të ndërsjellë.

Pavarësinë e ka njohur edhe qeveria hungareze. Vendimin e ka bërë të ditur sekretarja hungareze e shtetit për marrëdhënie me jashtë, Marta Feksz.

"Hungaria e ka njohur Kosovën e pavarur dhe qeveria ka kërkuar nga Ministria e Jashtme të përgatisë dokumentet e nevojshme, në mënyrë që presidenti të mund të vendosë marrëdhënie diplomatike me shtetin e ri të pavarur", u ka thënë Feksz gazetarëve në Budapest.

(20 mars) Bush: Armët për Kosovën, promovim i paqes botërore

Uashington - Presidenti amerikan George Bush ka autorizuar furnizimin e Kosovës me armatim, ka njoftuar Shtëpia e Bardhë. Në një memorandum dërguar Departamentit Amerikan të Shtetit, presidenti Bush ka thënë se "në këtë mënyrë, furnizimi me artikuj mbrojtës dhe shërbime mbrojtëse për Kosovën do ta forcojë sigurinë e Shteteve të Bashkuara dhe do të promovojë paqe botërore".

Shtëpia e Bardhë njoftoi se hapi i presidentit Bush do t'i forcojë raportet e sigurisë së Shteteve të Bashkuara me Kosovën, do ta promovojë sigurinë dhe stabilitetin në gjithë Ballkanin dhe do ta përmirësojë kapacitetin e Kosovës për të marrë pjesë në aktivitete paqeruajtëse, do të ndihmojë në luftimin e terroristëve dhe t'i menaxhojë situatat emergjente humanitare.

Bullgaria e njohu Kosovën

Sofje - Bullgaria e ka njohur shtetin e Kosovës, ka njoftuar kryeministri bull-

gar Sergei Stanishev, duke konfirmuar vendimin e qeverisë bullgare.

"Qeveria ka vendosur të njohë Kosovën, e cila për momentin është nën mbikëqyrjen ndërkombëtare", ka thënë Stanishev pas mbledhjes së kabinetit.

Bullgaria është shteti i 33-të që ka njohur shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

(21 mars) Lavrov kritikon vendimin amerikan për Kosovën

Moskë - Ministri i Jashtëm i Rusisë Sergei Lavrov e ka kritikuar ashpër vendimin e Shteteve të Bashkuara për të miratuar ndihmë ushtarake për Kosovën. Lavrov ka thënë se vendimi shkel rezolutën e Kombeve të Bashkuara, e cila i ndalon rreptësisht dërgesat e armëve në këtë rajon, përveç për forcat e Kombeve të Bashkuara.



Rexhep Taip Erdogan

(24 mars) Koshtunica: NATO krijoi Kosovën shtet të vetin

Beograd - Kryeministri i Serbisë, Vojislav Koshtunica ka thënë se vendi i tij është bombarduar që në Kosovë të krijohet "shteti i NATO-s". "Tashmë është më se e qartë se shkatërrimi mizor i Serbisë në bombardimet e NATO-s ka pasur vetëm një qëllim, që provinca e Kosovës të kthehet në shtetin e parë të NATO-s në botë", ka deklaruar Koshtunica me rastin e nëntë vjetorit të fillimit të sulmeve ajrore të NATO-së.

(26 mars) Erdogan: Pavarësia sjell stabilitet në Ballkan

Tiranë - "Ballkani ka nevojë për qetësi dhe stabilitet dhe Turqia vlerëson se pavarësia e Kosovës ishte një vendim i nevojshëm", ka thënë kryeministri turk, Rexhep Taip Erdogan. Ai ka shtuar se pavarësia do të jetë shkak që rajonit të Ballkanit do t'i vijnë rezultate shumë të mira. Erdogan ka deklaruar se Turqia së shpejti do të hapë ambasadën e saj në Prishtinë. Këto komente kryeministri turk i bëri gjatë vizitës në Tiranë.

(28 mars) Koreja e Jugut dhe Norvegjia njohën shtetin e Kosovës

Seul, Oslo - Koreja e Jugut e ka njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës. "Qeveria e njeh Kosovën si shtet sovran", ka thënë zëdhënësi i ministrisë së Jashtme, Moon Tae-Young. "Ne shpresojmë që pavarësia e Kosovës do të çojë drejt zhvillimit të saj demokratik dhe rimëkëmbjes ekonomike, si dhe do t'i kontribuojë paqes dhe stabilitetit në rajon", ka thënë ai.

Edhe Norvegjia e ka njohur shtetin e pavarur të Kosovës. Vendimi është miratuar në mbledhjen e Këshillit Shtetëror të kryesuar nga Mbreti Harald.

Deklarata e njohjes thotë se Kosova e pavarur ligjërisht është zotuar të mbrojë të drejtat e pakicave.

(29 mars) Moratinos: KB të kenë rol kryesor në Kosovë

Madrid - Shefi i diplomacisë së Spanjës Migel Anhel Moratinos ka deklaruar se Kombet e Bashkuara duhet të kenë rol kryesor në Kosovë.

"Qeveria në Madrid nuk do të japë dritë të gjelbër për pjesëmarrjen e përfaqësuesve spanjollë në misionin e BE-së në Kosovë, përderisa UNMIK-u nuk do t'ia bartë kompetencat këtij misioni", ka njoftuar Moratinos pas takimit të ministrave të Bashkimit Evropian.



Karel Shvarcberg

(31 mars) Shvarcberg: Një ditë Çekia duhet ta njohë Kosovën

Pragë - Ministri i jashtëm i Çekisë, Karel Shvarcberg, në një intervistë për të përditshmen çeke, "Lidove Novini", ka deklaruar se njohja e pavarësisë së Kosovës mund të presë, por një ditë, Çekia duhet ta bëjë këtë, nëse dëshiron t'i angazhojë ushtarët e saj në misionin e Bashkimit Evropian. "Në Kosovë kemi 500 ushtarë dhe policë dhe dëshirojmë të jemi pjesë e misionit evropian, që do të marrë përgjegjësi në Kosovë. Për t'u përfshirë në këtë mision, një ditë duhet ta njohim Kosovën", ka thënë Shvarcberg. ■

Një ditë pune në Komandën e Trajnimit dhe Doktrinës të TMK-së



Vendi ku vihen themelet e ushtrisë bashkëkohore të Kosovës

Në strukturën e përgjithshme të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) bën pjesë edhe Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës (KTD). Misioni i KTD-së është organizimi dhe drejtimi i përgatitjes, arsimit dhe kualifikimit të oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve, kurse si vizion ka zhvillimin e nivelit të përgatitjes së TMK-së, aftësimin në lëmi të përgjithshme.

KTD-ja ndahet në pesë njësi kryesore: Akademia e Mbrojtjes "Hamëz Jashari", Qendra Kolektive e Trajnimit (e cila ndodhet në Ferizaj), Qendra Simulative, Qendra e Studimeve Universitare dhe Qendra e Trajnimeve Themelore (që ndodhet në Gjakovë).

Në vijim do të paraqesim një ditë pune në TMK, në Komandën e Trajnimit dhe Doktrinës (KTD):



Ushtarë të TMK-së duke mësuar e studiuar gjuhën angleze. Mësimi realizohet me literaturën e Universitetit të Oxford-it, nëpërmjet programeve të ndryshme kompjuterike, televizorit, etj. Në këtë klasë mësohen të gjashtë nivelet e gjuhës angleze.



Këtu bëhet simulimi sikur ekipi i eporëve planifikues të jetë në terren, ku ngrihen çadrat dhe bëhet strategjia e ndërhyrjes dhe përgatitjet për ekzekutim.



Çerdhja e shqiptonjave, siç e quajnë ndryshe dhomën e situatave në njësinë e Qendrës Simulative, është hapësirë ku simulohen situatat dhe problemet e ndryshme para se të realizohen jashtë në terren të hapur. Udhëheqësi i simulimit (komandanti) përcjell tërë simulimin nëpërmjet dy ekraneve që shihen në fotografi.

Në këtë hartë të rërës bëhet simulimi dhe strategjia për ndërhyrje...





Bashkëpunimi TMK-KFOR

Ushtarë të KFOR-it të cilët njoftohen për së afërmi me problemin që do të studiohet dhe simulohet nga Zona e III-të Mbrojtëse e TMK-së.


te osovës



Ushtarë të njësisë mbështetëse logjistike që është përgjegjëse për marrjen e informacionit prej terrenit, ku bëjnë pjesë brigada e xhenios, e ndërlihdjes, inspektorati dhe garda.



Dhoma e simulimeve. Këtu bëhen llogaritjet dhe planifikimet e shtrirjes së ushtrimit. Bëhet kontrollimi dhe llogaritja e koordinatave gjeografike në mënyrë digjitale në harta nëpërmjet kompjuterëve... Eprorja u shpjegon ushtarëve si bëhet llogaritja dhe gjetja e koordinatave në harta digjitale.



Në njësinë e Akademisë së Mbrojtjes "Hamëz Jashari" bëhet trajnimi dhe përgatitja teorike e stafit të lartë të oficerëve. Prej lëndëve që mësohen në Akademi janë edhe: Topografi, Funkcionet e stafit, Vetëmenaxhimi, Menaxhimi i projektit, Rezultatet nëpërmjet udhëheqësve, Funkcionet e Shtabit, Organizimi personal, etj. Në këtë klasë mbahet lënda e Menaxhimit të projektit, në të cilën merr pjesë stafi i lartë i oficerëve të TMK-së.



Në QSU janë tri gjenerata me gjithsej 38 kadetë (16 në vitin e parë, 11 në të dytin dhe 11 në të tretin). Në mesin e tyre ka edhe kadete si dhe pjesëtarë të minoriteteve.

Një prej pesë njësive (qendrave) të KTD-së është edhe Qendra e Studimeve Universitare (QSU), ku kadetët e rinj, të cilët vijnë nga jeta civile, studiojnë për 4 vjet në këtë qendër. Pjesën e ligjëratave teorike e kryejnë nëpër universitete private siç janë: Universiteti Amerikan në Kosovë (AUK), Universiteti Dardania, Universiteti i Biznesit dhe Teknologjisë (UBT), etj. Pjesën fizike, praktike dhe ushtarake këta kadetë që studiojnë akademinë ushtarake, e kryejnë në KTD.

Përgatiti:

Osman D. GASHI

Feja dhe kohezioni shoqëror

Përkufizimi i fesë është në esencë diçka që mban anën shpirtërore të individit, por, në të njëjtën kohë, nuk është aspak çudi që feja mund të shkaktojë si konfliktet sociale, ashtu edhe kohezionin.



Emine A. VEZAJ

Me termin fe nënkuptojmë parimet themelore të një besimi të caktuar, botëkuptimet shpirtërore, lëndore dhe njerëzore që i japin kahëzim jetës së tij, mendimet e ndryshme, qëndrimet sektariane, filozofirat e drejta apo të gabuara etj. Sipas Kur'anit, feja është burimi themelor më rrënjësor i njohurive të njeriut. As në kohën tonë, e as në historinë njerëzore në përgjithësi, (duke pasur parasysh edhe të gjitha lëvizjet e vjetra ateiste, si dhe ato materialiste bashkëkohore), nuk mund të gjejmë asnjë rast të kulturës jashtë-fetare ose jofetare. Së këndejmi, njeriu edhe nëse i beson Zotit, edhe nëse është ateist, prapë se prapë ka apo mbështet disa mendime, bindje, ide apo qëndrime të këtylla apo të atilla rreth kozmosit, jetës, shoqërisë dhe njeriut, dhe të gjitha këto në përkufizimet e fesë, janë 'elemente me karakter religjioz' të cilat i ngërthen feja.

Përkufizimi i fesë është në esencë diçka që mban anën shpirtërore të individit, por, në të njëjtën kohë, nuk është aspak çudi që feja mund të shkaktojë si konfliktet sociale, ashtu edhe kohezionin. Gjithashtu disa do të çuditëshin nëse do të parashtrohej pyetja: a mund të jetë feja një forcë që 'mund' të gjenerojë konflikte dhe kohezion?

Feja "mund" të gjenerojë konflikt

Nga reportazhet televizive dhe gazetareske përfitohet përshtypja se

lufta në Irlandën e Veriut është luftë e pastër fetare, pra përleshje e dy kampeve antagoniste – katolikë dhe protestantë, të vënë përballë njëri tjetrit në një dhunë të pakuptimtë e të tmerrshme. Ndërmjet viteve 1970-1998 lufta sektare mori jetën e 3000 deri 4000 njerëzve (një në 500 banorë), më tepër se gjysma e të cilëve ishin civilë të paarmatosur. Rreth 40.000 qytetarë (një në 50), morën lëndime serioze. Lagjet dhe lokalet afariste u bombarduan dhe u ndezën, ndërsa gjenerata të tëra të fëmijëve u rritën duke mos ditur mënyrën tjetër të jetës, pos betejave të vazhdueshme të rrugës.

Në kontest të kësaj teme edhe studiuesi Samuel Huntington në librin e tij tashmë të famshëm 'Përplasja e Qytetërimeve' ndan mendimin e njëjtë për një konflikt fetar, mbase edhe nga ajo që sipas tij feja gjeneron konflikt. Në mënyrë të ngjashme, Huntingtoni e paraqet Islamit si qytetërimin, i cili është përgjegjësi kryesor për përleshjen përgjatë vijave të mëdha të shpëputjes historike, nga njëra anë, dhe si partner të koalicionit sfidues kundër Perëndimit, nga ana tjetër.



Teoritë e këtylla, në rastin më të mirë shpjegojnë atë domethënie se: 'feja mund të gjenerojë konflikte' madje, në këtë rast duhet përmendur se edhe lufta e Serbisë kundër mulimanëve të Bosnjës dhe Ko-

sovës, mbështetej në arsyetimin se me luftën që bëjnë ata, 'plotësojnë një mision historik, duke e mbrojtur Evropën nga fundamentalizmi Islamik'. Pra, qëllimi i luftës që bënte ishte mbrojtja e Evropës nga Islami.

Kohezioni dhe shoqëria

Tema e kohezionit është një temë qendrore pasi ngërthen në vete një mori të dhënash rreth shoqërisë në përgjithësi. Por në anën tjetër, shoqëria nuk është e mbyllur vetëm në një grup njerëzish, shoqëria është më shumë se një grumbull njerëzish që ndajnë së bashku një kohë dhe hapësirë të caktuar. Ndonëse ajo mund të jetë e përbërë prej disa individëve, ajo s'mund të reduktohet në bindjet, vlerat dhe sjelljet individuale. Tani shtrohet pyetja se: çështje ajo që e përbën fenë, kohezionin dhe shoqërinë?

Feja, përbën një faktor të rëndësishëm të integritetit shoqëror, ajo është çështje personale e individit, por esencialisht janë simbolet fetare ato që përfaqësojnë unitetin e grupit social, kurse ritualet fetare janë ato që e mira-

tojnë atë unitet, duke i lejuar individit që, simbolikisht, të marrë pjesë në unitetin më të gjerë që ato përfaqësojnë, p.sh. ritualet e besimit islam me rastin e festës së Bajramit të Kurbanit, jo vetëm që përkujtojnë Pejgamberin e Zotit, Ibrahimin a.s., por paraqesin edhe një unifikim dhe solidarizim me shoqërinë në përgjithësi, thënë ndryshe mishi i kurbanit simbolizon solidaritetin me

të afërmit, miqtë, fqinjët etj. Me anë të kësaj forme unifikuese dhe shoqërore, rëndësi paraqet fakti se afërsia e besimtarëve në raste të tilla i motivon besimtarët të jenë më të përkushtuar

ndaj shoqërisë. Feja i nxit besimtarët që krahas interesit personal, të punojnë edhe për interesin grupor dhe për mirëqenien e gjithmbarshme. Pra, feja në përgjithësi mban një kohezion të fuqishëm me shoqërinë në tërësi. Si e tillë, feja si në raste festash, por edhe në raste gëzimi dhe hidhërimi, e ndihmon grupin që ta ri-kapë baraspeshën dhe moralin shoqëror pas vdekjes së një anëtarit. Shembuj të tillë çmohen ende edhe në ditët e sotme, ku me rastin e vdekjes së një miku apo të afërmi, janë shoqëria dhe rrethi ata që solidarizohen me mikun për ditë të tëra, duke i qëndruar afër në ditët e rënda mortore.

Teoria e kohezionit është mënyra e vetme që do të jetë e qëndrueshme për mbrojtjen e fesë në shoqëri, sepse përmes mënyrave të ndryshme ajo arrin ta ruajë fenë nga sfidat me të cilat ajo mund të rrezikohet. Shembujt e fesë që kontribuojnë në kohezionin e shoqërisë në përgjithësi përfshijnë edhe ruajtjen e kombit përmes rrugëve të fesë. Teza se forma fetare ndikon në unitetin e ruajtjes së kombit, është tezë që mbështetet nga të gjitha besimet religjioze. Ajo mund të luajë rol të çmuar në zgjidhjen e konflikteve. Sensibilizimi i fesë është shumë i dukshëm, sidomos atëherë kur mendojmë se kombi po kërcënohet nga armiku. Rast të tillë do të mund të përmendim sintagmën tashmë shumë të përfolur, 'Feja e shqiptarit është shqiptaria', ku autori kishte për qëllim sensibilizimin e masës së gjerë, kur është në pyetje atdheu. Pra, është e qartë se feja dhe kohezioni janë shumë të çmueshëm në një shoqëri të hapur. Feja mund të japë gjithëherë një vizion kombëtar, mund të japë kualitete fetare rreth formimit të një identiteti të përkryer në formimin e një kombi.

Përfundimisht mund të konstatojmë se feja është burim edhe i kohezionit edhe i konfliktit social. Feja i kontribuon kohezionit, ashtu siç e kam paraqitur në unifikimin e shoqërisë. Në ndonjë festë të caktuar, ajo mund të gjenerojë dhunë, siç kam përmendur rastin e Irlandës së Veriut, si dhe luftën e fundit në Bosnjë dhe Kosovë. Pra, këto ishin vetëm disa detaje të vogla rreth asaj se kur feja mund të promovojë apo gjenerojë konflikte, si dhe kur vendos një kohezion në shoqëri. ■

Zhveshja e femrave, modë apo imoralitet



Arber ZEKA

Familja shqiptare ka filluar ta humbë kuptimin e saj që ka pasur ndër shekuj. Çdo ditë e më tepër po shtohen krimet në familje, dhe jo rrallë ka raste të abuzimit të femrave.

Raportet e publikuara në media dëshmojnë fakte rrëqethëse. Nga këto raporte del se, si pasojë e varfërisë dhe krimit të organizuar, më shumë se 30 mijë gra e vajza shqiptare të punojnë si prostituta, 15 mijë prej tyre janë në Itali, mbi pesë mijë në Greqi, ndërsa 10 mijë të tjera, në vendet e ndryshme të Evropës Perëndimore. 80 % e grave dhe vajzave që prostitutojnë janë nën diktatin e individëve të inkriminuar më parë me vrasjet, trafikimin e drogës dhe armëve. Këtyre grupeve, në këtë rast, nuk iu prijnë grekët, italianët apo të tjerët, po janë shqiptarët ata që po e udhëheqin biznes çnjerëzor.

Kur flasim për gjininë femërore, së pari duhet të kemi parasysh, së femra është nëna e shoqërisë, është shtylla dhe edukatorja e shoqërisë. I tërë ky deformim i kulturës dhe etikës sonë, po vjen si rezultat i asaj së nëna shqiptare po e humb rolin e një mësueseje të mirë, që e kishte më parë.

Dikush nuk mund të pajtohet me këtë konstatim, por jemi vetë dëshmitarë të asaj që shpesh po dëgjojmë: raste të shkurorëzimeve për shkak të imoralitetit...

Të rralla janë ato familje që po i rezistojnë këtij problemi. Ndoshta, ka prej atyre që nuk duan ta konsiderojnë këtë si problem, por pasojat po i bartim e do t'i mbartim të gjithë si shoqëri, nëse nuk angazhohemi në edukimin e mirëfilltë të femrës sonë.

Për fat të keq sot shumica e femrave po e përcjellin trendin e shtëpive të "modës" dhe po "zhvishen" në emër të modernes.

Ku është në këtë rast morali shqiptar, i ruajtur ndër shekuj, kur prindi si prind shikon vajzën e tij të lakuriqësuar, duke zbuluar edhe pjesët më intime të mundshme, si gjoksin, barkun, etj? Ku është

familja, që nuk reagon kur shikon pjesëtarin e vet, duke e reklamuar lakuriqësinë para të tjerëve, duke u nxitur eposhin këtyre të fundit?!

Lakuriqësia është një nga të këqijat më të mëdha që çon në prostitucion, e dihet se marrëdhëniet intime jashtëmartesore nuk mund të quhen të drejta dhe edukative për një shoqëri të pastër moralisht.

Prostitucioni bie ndesh me interesin e sistemit të botës për ruajtjen e pasardhësve, me mbrojtjen e organeve, me vëmendjen ndaj ndezjes së armiqësisë dhe urrejtjes mes njerëzve, duke krijuar një zinxhir të këqijash që nënkupton prishjen e botës. Zhveshja jo vetëm që ndikon në shkatërrimin e femrës, por ajo është shkak i shkatërrimit të rinisë në përgjithësi.

Natyrshmëria e njeriut gjithmonë anon nga veshja dhe nga mbulimi. Kurse zhveshja është nga natyrshmëria e kafshëve dhe nuk anon asnjëherë nga natyrshmëria e shëndoshë njerëzore.

Ndër pasojat që shkakton zhveshja do t'i përmendim disa:

- Përhapja e amoralitetit dhe prishja e shoqërisë;
- Shkatërrimi i gjinisë mashkullore dhe asaj femërore dhe humbja e nderit dhe turpit;
- Shndërrimi i gruas në plaçkë të lirë dhe të pavlerë.
- Çrregullimet familjare dhe humbja e besimit ndërmjet anëtarëve të familjes;
- Shpërndarja e sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme, etj. ■

Raportet e publikuara në media dëshmojnë fakte rrëqethëse. Nga këto raporte del se, si pasojë e varfërisë dhe krimit të organizuar, më shumë se 30 mijë gra e vajza shqiptare të punojnë si prostituta, 15 mijë prej tyre janë në Itali, mbi pesë mijë në Greqi, ndërsa 10 mijë të tjera, në vendet e ndryshme të Evropës Perëndimore. 80 % e grave dhe vajzave që prostitutojnë janë nën diktatin e individëve të inkriminuar më parë me vrasjet, trafikimin e drogës dhe armëve.

Viti i ngritjes

Muhammedi s.a.v.s. asnjëherë nuk ka qenë i dhunshëm, e as që ka projektuar ndonjë projekt të dhunshëm. Të gjitha luftërat ose betejat e tij ishin ose mbrojtëse, ose të detyruara... Muhammedi s.a.v.s. e mbajti sekret vendimin e tij për të marshuar drejt Mekkes, sepse dëshira e tij ishte që të mos derdhej gjaku.



**Muhamed JUSUFI
-KAJOLLI**

Viti i tetë sipas hixhretit, ose viti 629/30 gregorian, numërohet si viti i sukseseve në ushtri dhe i aritjeve të mëdha në thirrje [davit] të muslimanëve. Në këtë vit u zhvilluan disa beteja, por ndër më kryesoret njihet ajo e Mu'ettes, çlirimi i Mekkes dhe nënshtrimi i disa qyteteve të mëdha, të cilat qenë një frymëzim për mbarë njerëzit e Gadishullit Arabik. Ekonomia filloi të rritet ndërmjet muslimanëve, pasi këtë vit fiset e Gadishullit filluan ta kuptojnë më qartë mesazhin islam.

Si pikë kthesë për pranimin e Islamit nga ana e beduinëve shërbeu trimëria dhe guximi i muslimanëve, në betejën e Mu'ettes. Atyre u mjaftoi të dëgjonin se ushtria e muslimanëve i doli karshi ushtrisë bizantine dhe u kthye shëndoshë e mirë. Atyre iu interesonte nëse muslimanët e fituan apo e humbën atë betejë, iu interesonte guximi, e jo rezultati. Në literaturën islame gjejmë komente të ndryshme, por ajo që ju ka bërë përshlyetje të madhe arabëve është dinakëria ose taktika ushtarake e përdorur nga Halid Ibn Velidi, kundër një superfuqie. Kjo betejë kishte ndikuar pozitivisht për muslimanët edhe ndër arabët e pushtuar nga bizantinët ose arabët e krishterë. Si duket, këta ishin lodhur nga padrejtësitë e perandorisë, ndërsa në anën tjetër kishin dëgjuar fjalë shumë të mira për drejtësinë islame. Muhammedi s.a.v.s. pasi ishte informuar mirë mbi qëndrimin e arabëve të veriut, se krerët e tyre i kishin detyruar arabët të mbajnë anën e Herakliut kundër Muhammedit s.a.v.s., ai dërgoi menjëherë një ushtri në krye me Amr ibn As.

Qëllimi i dërgimit të kësaj ushtrie ishte që të ndikonte pozitivisht dhe që të tërhiqte simpatizantët e Islamit dhe kështu të merrnin pikat strategjike për të ardh-

men, nëse do të ndesheshin me ushtrinë e Herakliut. Natyrisht, kur Amër ibn Asi, u afrua kufirit të arabëve të veriut, përpara i doli një ushtri e madhe, gjë që e shtyri atë të kërkojë përforcime. Muhammedi s.a.v.s. iu përgjigj kërkesës së tij duke i dërguar elitën myslimane: Ebu Bekrin, Omerin dhe disa nga ensarët. Si udhëheqës të tyre kishte caktuar Ubejde ibn Xherrah. Është me rëndësi të theksoj këtu se Ubejde ishte këshilluar nga Muhammedi s.a.v.s. të mos ngatërrohej me Amrin. Vërtet, kur Ubejdi kishte kërkuar nga Amri që ta merrte komandën, Amri kishte refuzuar duke i thënë se unë jam i zgjedhur për komandant, ndërsa ti je në cilësinë e përforcuesit. Këtë debat po e theksoj tani sepse kjo zënkë e vogël do të tregojë më vonë karakterin e vërtetë të Amrit.

Sa për informim, Amr ibn Asi kishte një zgjuarsiri të madhe, ishte me kulturë të lartë dhe njëkohësisht ishte edhe kushëri me Muhammedin s.a.v.s. Meqenëse fisi Kurejsh ishte i madh, brezi i katërt, që ishte Amri konsiderohej shumë afër me lozën e Muhammedit s.a.v.s. Ebu Bekri ishte kushëri, gjithashtu, i brezit të shtatë. Sidoqoftë, pas këtij përforcimi ushtria muslimane arriti t'i zmbarsë luftëtarët e fiseve arabe rebele. Kjo ekspeditë u quajt Dhatu Selasil, për shkak se kur muslimanët zbritën nga malet, arritën tek pusët e Selasilit. Tani, kufiri i shtetit islam me Bizantin ishin Pusët e Selasilit. Që prej atëherë muslimanët do të korrin vazhdimisht fitore kundër Bizantit, ndërsa këta të fundit vazhdimisht do të ishin në tërheqje.

Çlirimi i Mekkes

Muhammedi s.a.v.s. asnjëherë nuk ka qenë i dhunshëm, e as që ka projektuar ndonjë projekt të dhunshëm. Të gjitha luftërat ose betejat e tij ose mbrojtëse ose të detyruara. Këtë na e vërteton më së miri marrëveshja e Hudejbijes. Kjo marrëveshje është akoma e freskët në mendjet tona kur para dy vitesh muslimanët edhe pse ishin në gjendje lufte me mekkasit, ishin nisur të pa armatosur për të

bërë haxhin. Ata nuk arritën të shkojnë në Mekke, për arsye se u ndaluan nga autoritetet e këtij qyteti. Prandaj pasoi edhe kjo marrëveshje, e cila në shikim të parë ishte në disfavor të muslimanëve. Për hir të paqes Muhammedi s.a.v.s. kishte bërë lëshime të mëdha. Njëra prej pikave të kësaj marrëveshje thoshte: fiset që duan të lidhin aleancë me mekasit janë të lirë ta bëjnë një gjë të tillë, por duhet ta deklarojnë aleancën. Kjo vlente edhe për ato fise që donin të lidhin aleancë me muslimanët. Të bazuar në këtë paragraf të kësaj marrëveshje, fisi Huza'a ishte në aleancë me muslimanët, ndërsa fisi Benu Bekër me mekassit.

Pas dy vjet paqeje pikërisht ky paragraf u bë shkaktar i thyerjes së marrëveshjes. Ndofta kjo marrëveshje nuk do të anulohet nëse mekkasit nuk do ta kishin ndihmuar fisin që ishte në aleancë me ta. Për këtë arsye Muhammedi s.a.v.s. as që e priti Ebu Sufjanin në rezidencën e vet, kur ai kishte shkuar në Medinë për të vazhduar marrëveshjen. Ebu Sufjani ishte kushëri i tretë, dhe babai i njërit prej grave të Muhammedit s.a.v.s. Edhe pse kishte këtë lidhje të ngushtë familjare, marrëveshja nuk u ripërtëri.

Muhammedi s.a.v.s. e mbajti sekret vendimin e tij për të marshuar drejt Mekkes, sepse dëshira e tij ishte që të mos derdhej gjaku. Ditën që po nisej për në Mekke ishin përhapur thashetheme të ndryshme, por ushtarët nuk e dinin se ku po shkonin. Nga Medina dolën rreth dhjetë mijë ushtarë. Askush më parë nuk kishte parë një ushtri kaq të madhe në Gadishullin Arabik. Muhammedi s.a.v.s. arriti të bëhet forca më e madhe dhe e vetmja që do t'i bashkonte të gjitha fiset arabe.

Mekkasit nuk kishin dijeni fare për arritjen e ushtrisë muslimane, ndërsa ajo tani kishte ngritur tendat për të pushuar në një vend, gjysmë dite udhëtimi afër Mekkes. Muhammedi s.a.v.s. kishte dhënë urdhër që secili të ndizte flakadanët e tyre. Ebu Sufjani atë natë kishte dalë me dy të tjerë të shikonte atmosferën përreth Mekkes, sepse ai ishte ndarë me Muham-

medi s.a.v.s. keq, dhe, në çdo moment priste një sulm të mundshëm të muslimanëve. Atë natë u befasuan, kur para syve të tyre shikuan një numër të madh flakadanësh. Ata kuptuan se muslimanët kishin arritur para dyerve të Mekkes dhe numri tyre ishte i papërballueshëm. Ebu Sufjani e takoi axhën e Muhammedit s.a.v.s. dhe ky i fundit kërkoi prej tij që të ndërmjetësonte sërish tek Muhammedi s.a.v.s., ndërsa ai i propozoi që këto fjalë t'ia thoshte vetë. Atë natë Ebu Sufjani nuk u prit nga Muhammeti s.a.v.s., ndërsa të nesërmen deklaroi Islamin e tij.

Për hir të Islamit të tij, Muhammedi s.a.v.s. tha: ai që mbetet në shtëpi është i falur, gjithashtu janë të falur të gjithë ata që qëndrojnë në Qabe dhe në shtëpinë e Ebu Sufjanit. Kështu ushtria muslimane hyri në Mekkë pa rezistencë nga vendasit e tij, me përjashtim të disa "trimave" injorantë. Në Mekkë Muhammedi s.a.v.s. qëndroi nëntëmbëdhjetë ditë, aq sa iu nevojitën për të pastruar Qaben nga idhujt që gjendeshin brenda, dhe pastrimi tjetër që duhej të kryhej ishte në mendjet e tyre. Ai mbajti ligjërata të shumta rreth Islamit, gjë që ndikoi pozitivisht në mendjet e tyre. Pasi qe bindur se situata ishte qetësuar, ai mori rrugën për t'i çliaruar edhe qytetet e mbetura. Nga dhjetë mijë ushtarë sa numëronte kjo ushtri, tani ky numër u shtua edhe me dy mijë.

Beteja në Hunejn

Hyrja e muslimanëve në Mekkë i befasoi të gjitha fiset arabe, por shumë prej tyre vazhduan me teket dhe injorancën e tyre. Ata, duke qenë se mësuan për forcën dhe numrin e madh të ushtrisë muslimane, filluan të grumbullohen nën komandën e Malik bin Avf el Nasiriut. Ushtria nën komandën e Malikut ishte afruar afër Mekkes në vendin e quajtur Hunejn, i cili është larg Mekkes afro gjashtëmbëdhjetë kilometra. Askush më parë në Gadhishull nuk kishte bërë një veprim sikur Maliki. Ai krahas ushtrisë, me vete kishte familjet dhe të gjithë pasurinë e fiseve. Si duket synonte shpërnguljen e madhe të tërë fiseve nëse nuk do të fitonte.

Muhammedi s.a.v.s. kishte dëgjuar për lëvizjet e fiseve përreth Mekkes dhe kishte dalë me ushtrinë e vet drejt Hunejnit, aty ku ishte përqendruar ushtria aleate. Derisa muslimanët po mendonin se kjo betejë do të jetë e lehtë, ata befas u sulmuan me shigjeta në një ngushticë,

gjë që u shkaktoi humbje dhe panik të paparë ndonjëherë. Dëgjoreshin zëra nga ushtarët e Malikut se magjitë e Muhammedit s.a.v.s. u shuan, dhe fitorja e tyre është e sigurt. Fillimi i betejës ishte shumë i mundimshëm, breshëritë e shigjetave vazhdonin të binin, gjë që shkaktoi humbjen e kontrollit dhe si pasojë ushtria u shpërnda. Makthi filloi t'ju kalojë vetëm atëherë kur dëgjuan zërin e Muhammedit s.a.v.s. për të dalë nga ajo ngushticë. Meqë ishte formuar një kaos dhe zhurmë e tepruar, zëri i Muhammedit s.a.v.s. nuk dëgjohej larg. Por kësaj thirrje po i ndihmonte edhe Abasi i cili po bërtiste: drejt Muhammedit s.a.v.s. Pasi doli nga ngushtica, ushtria muslimane u rreshtua dhe tani e kishte më të lehtë. Përfundimi i betejës ishte në favor të muslimanëve të cilët zunë rob më shumë se gjashtëmijë luftëtarë, mbi njëzet e katërmijë deve, njëzet mijë dele dhe katër mijë okë argjend. Një pjesë e madhe e ushtrisë ikën me të katra duke u shpërndarë në tri drejtime. Njëri grup shkoi drejt Eutas, aty ku synonte Maliku, grupi tjetër drejt Nahlit dhe grupi i tretë dhe më i madhi drejt Taifit.

Muhammedi s.a.v.s. caktoi nga një komandant për t'i ndjekur ushtarët e drejtuar drejt këtyre drejtime, ndërsa vetë u përqendrua në sigurimin e plaçkës së luftës të cilën e strehoi dhe në fund u drejtua drejt grupit më të madh të armikut për në Taif.

Rrethimi i Taifit

Ushtria muslimane që ishte në ndjekje të ikanakëve të drejtuar në Eutas dhe Nahl korrën shumë shpejt fitoret e tyre. Në betejën e Eutas, ra shehid komandanti Ebu Amir el Eshariu. Ndërsa, në anën tjetër, Muhammedi s.a.v.s. për taifasit zgjodhi rrugën e rrethimit. Qëllimi e tij ishte që t'ju jepte një shans, dhe mbase do të merreshin vesh. Ai nuk donte që të derdhej gjak prandaj kërkoi prej tyre që të dorëzoheshin. Muslimanëve iu erdhi një informacion se në Taif ishte grumbulluar ushqim i madh, dhe se ata kishin

mundësi të qëndronin të mbyllur në qytetet për një vit të tërë. Derisa ushtria muslimane qëndronte përreth Taifit, rolin kryesor e luanin shigjetarët dhe katapultuesit. Historianët nuk janë të një mendimi rreth ditëve të qëndrimit të ushtrisë muslimane përreth Taifit, por si duket ata nuk kanë qëndruar më shumë se dyzet ditë.

Meqenëse Muhammedi s.a.v.s. kishte edhe shumë punë për të bërë, ai u këshillua me ekspertët e tij se si t'ia bënin me taifasit. Njëri prej sahabëve i tha: Dhëlpren po e mbajte në shënjestër është e jotja, por, nëse e lë të lirë është e pa dëmshme. Kështu ai vendosi që ushtria të tërhiqet. Ishte vlerësuar se pothuajse të gjitha fiset arabe po e pranonin Islamin si fenë e tyre, dhe se taifasit do të dorëzoheshin një ditë, mbasi ndiheshin të frikësuar.

Populli i Taifit më vonë pranoi të dorëzohet, por me disa kushte të cilat Muhammedi s.a.v.s. nuk i pranoi. Kërkesat e tyre ishin amorale, ndërsa Islami ngrihej mbi shtylla të larta morale, kështu që ai nuk aprovoi asnjë prej tyre. Në fund, muslimanët pranuan që idhullin e tyre të mos ta rrënonin ata vetë, por dikush tjetër nga muslimanët.

Pas përfundimit të rrethimit të Taifit, Muhammedi s.a.v.s. e shpërndau plaçkën e luftës, por kësaj radhe shumë prej muslimanëve të hershëm u dëshpëruan sepse Muhammedi s.a.v.s. iu dha përparësi muslimanëve të rinj të Mekkes. U përhap lajmi se Muhammedi s.a.v.s. po i favorizonte mekkasit e vet, sepse kishte si qëllim që tani e tutje të qëndronte në Mekkë. Ky shqetësim u shua kur ensarët u bindën se Muhammedi s.a.v.s. nuk do të qëndronte në Mekkë, por ai do të kthehet në Medinë, dhe atje do të qëndronte deri në fund të jetës së tij. ■



Debati i hapur nga botuesi i revistës "Paqja"

Të fillojmë të shkruajmë hapur

Për revistën Paqja në lidhje me debatin e hapur nga Kryeredaktori

Ju përshëndes me Esselamu Alejkum!

Së pari ju falënderojmë juve si Redaksi e Revistës "Paqja".

Në numrin e muajit shkurt të revistës suaj me ra në sy një debat i hapur nga kryeredaktori i revistës Muhamed Kajolli.

Tema ishte e fokusuar në aspektin teologjik dhe kishte të bënte me hoxhallarët dhe ndajat e tyre në oda.

Unë desha të marr pjesë vetëm në një pjesë të debatit që kishte të bënte me derogimin e ajeteve kur'anore nga ana e haditheve të Muhammedit alejhi selam.

Autori i debatit e kishte refuzuar kategorikisht një gjë të tillë. Një refuzim i tillë, sipas rregullave islame, është jo real.

Sipas rregullave që dijetarët islamë kanë vënë në kushtet e derogimit (nes'hit) ai ndahet në katër mënyra:

1. Kur'ani derogohet me Kuran.
2. Kur'ani e derogon Sunnetin
3. Sunneti e derogon Kur'anin
4. Sunneti derogon Sunnetin.

Shumica e dijetarëve muslimanë janë të të njëjtit mendim se këto mënyra ekzistojnë.

Ne do të ndalemi shkurtimisht në pikën e tretë.

Esharinjtë, Maturidinjtë, Mutezilitët, Imam Maliku dhe ithtarët e Ebu Hanifes janë të mendimit se Kur'ani mund të derogohet me hadith mutewatir, duke u mbështetur në atë se Muhammedi alejhiselam nuk flet sipas dëshirës së tij, por vetëm sipas asaj që i shpallet.

Sipas xhumhurit (shumicës së dijetarëve islamë) Kur'ani nuk derogohet me hadithe ahad, ndërsa sipas dijetarit Ibën Hazm Endelusit, Kur'ani Famëllartë mund të derogohet edhe me hadith ahad.

Si derogim të Kur'anit me Sunnet dijetarët muslimanë përmendin ajetin

2:180: "Kur ndonjërit prej jush i është afuar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejtë. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer". Ky ajet i Kur'anit të Madhërisëm derogohet me hadithin e Muhammedit alejhiselam, ku s.a.w.s. thotë: "Nuk ka testament për trashëguesin".

Nga kjo vijmë në përfundimin se lejohet derogimi i Kur'anit me sunnet mutevatir dhe anasjelltas, ngase sunneti mutevatir në aspektin e të vërtetuarit është i formës së prerë sikurse edhe Kur'ani i Madhërisëm.

Në fund të kësaj ju këshillojmë që mos t'i japim vetës shans që të shprehim vetëm atë që na merr mendja dhe se nuk ekziston tjetër mendim, për arsye se ne gabojmë rëndë në injorimin e mendimeve të tjera, duke pasur parasysh se dijetarët kanë shumë mendime në lidhje me çështjet e Islamit, nga ku veçuan edhe mendimet që cekëm më lart, të cilat padyshim janë nga mundi dhe dija e dijetarëve. Hoxhallarët janë njerëzit më të zgjedhur në vendin ku ata i shërbejnë dinit të All-llahut të Madhërisëm dhe padyshim se edhe ata gabojnë dhe nuk besojmë se ka të atillë që shfuqizojnë ajetet e Kur'anit, por kjo rrjedh nga dija që ata kanë për Kur'anin dhe Sunnetin, si dhe nga dituritë që kanë marrë nga dijetarët islamë.

Ju përshëndesim me Esselamu Alejkum!

Behar Sh. Beqiri

Imam dhe Student në Fakultetin e Studimeve Islame si dhe në Fakultetin Filologjik, dega Letërsi Shqipe

Përgjigja e botuesit...

Inderuari dhe shumë i respektuari z. Behar,
Paqja dhe Mëshira e All-llahut qoftë mbi ty

Sunneti nuk është autonom, ai nuk vërteton obligimet ose ndalesat, sepse detyra e tij është t'i specifikojë dhe t'i shpjegojë dispozitat e përgjithshme të Kur'anit

Para se të filloj t'ju përgjigjem, fillimisht ju përgëzoj dhe ju çmoj që keni marrë guxim të shkruani. Kjo për mua do të thotë shumë, ndërsa fakti që ende jeni student më gëzon edhe më shumë. Presim ditë të shkëlqyera nga ju.

Gjithashtu, u detyrohem lexuesve të rregullt të kësaj reviste t'u them se pas një bisede me disa nga kolegët e mi rreth fjalës shfuqizim, abrogim ose derogim të ajeteve kur'anore ramë në ujdi që, në gjuhën shqipe të mos thuhet shfuqizim, abrogim ose derogim, por të thuhet pezullim i ajeteve. Sepse, në fakt, ajetet nuk shfuqizohen tërësisht, përderisa ato vazhdojnë të jenë në Kur'an dhe të jenë funksionale në vende të ndryshme të botës.

Inderuari Behar,

Fillimisht ju them se unë nuk jam kryeredaktor i revistës, por vetëm drejtor i kësaj të përmuajshme. Ndërsa për sa i përket grupit të dijetarëve që ju anoni them se në përgjigjen tuaj do të duhej të sillnit edhe ata dijetarë që argumentojnë se hadithet nuk kanë legjitimitet të pezullojnë ajetet në asnjë mënyrë.

All-llahu i Lartëmadhëruar ia zbriti Muhammedit s.a.v.s. Kur'anin për njëzet e dy vjet, e pesë muaj, e njëzet e dy ditë, dhe para se të ndërronte jetë, atij ia përsëriti Kur'anin dy herë. Muhammedi a.s. i mësoi me një kujdes të veçantë as'habët e tij që ta vendosnin secilin ajet në vendin përkatës. Pra, iu thoshte që këtë ajet ta vendosnin në këtë rresht, të kësaj sureje. Kjo do të thotë se Muhammedi s.a.v.s. ishte i detyruar të vepronte sipas mësimave Hyjnore, dhe, njëkohësisht, kjo nënkupton se All-llahu në asnjë mënyrë nuk ka lejuar që në Kur'anin Fisnik të ndërhyjë dora e njeriut.

Në kontekst të kësaj, All-llahu i Lartëmadhëruar na tregon se cilat ishin kompe-

për çështjet që na preokupojnë

tencat e Muhamedit s.a.v.s.: ...t'ua mësojë Kur'anin, urtësinë dhe t'i këshillojë..." . Nëse besimtarët dhe njerëzimi mbarë do t'i përmbaheshin këtij udhëzimi të All-llahut, nuk do të kishin mundësi të devijonin e të humbnin.

Për ta vërtetuar këtë që thamë më sipër, All-llahu xh.sh. e këshillonte ose e qortonte Muhammedin s.a.v.s. në raste kur ai vepronte ose sillej me hamendjen e tij. Këto veprime të Muhammedit s.a.v.s. janë të sqaruara mirë, por, në këtë rast, themi se ai megjithatë u qortua butësisht nga All-llahu xh.sh. për veprimet e tij autonome. Si shembull do ju sjell rastin me të verbrin, në suren Abese. Pastaj, shikoni edhe disa ajete të tjera që fillojnë me "O ti i dërguar (Resul), ose "O ti informues (Nebij)..."

Inderuari Behar,

Nuk dua të keqkuptohem në opinionin e gjerë, por unë them me keqardhje se Islami nga disa muslimanë elitare të tanishëm dhe të mëhershëm është keqkuptuar ose keqinterpretuar. Si pasojë e këtij shpjegimi, sot jemi këta që jemi. Fatkeqësisht shkaktar i këtij keqinterpretimi ishin pikërisht "hadithet" e trilluara. Si thua, a nuk duket pak e vrazhdë që një qenie njerëzore siç ishte Muhammedi s.a.v.s. të ndërhyjë në veprën e All-llahut të Lartëmadhërisë, kur Ai iu kishte mundësuar të dërguarve të Tij të bëjnë mrekullira, por të gjitha atë bëheshin me lejen e Tij? Bile, All-llahu xh.sh. i kishte dhënë Isaut a.s. mrekullinë e ngjalljes së të vdekurve, por gjithmonë me lejen e Tij.

Në shumë xhami sot hoxhallarët i përkujtojnë dijetarët të cilët kur vizitonin Evropën, thoshin: në Perëndim ka Islam, por nuk ka muslimanë, ndërsa në shtetet islame ka muslimanë, por nuk ka Islam. A nuk na e vret veshin kjo thënie? Të gjithë e pranojnë se në shtetet islame ka muslimanë por jo Islam, e kjo vjen pikërisht nga mos qasja jonë e drejt-përdrejtë me Kur'anin. Duket sikur po mungon vullneti i një ndërhyrje të thellë në eliminimin e haditheve të dobëta...

Mua, gjithashtu, më habit fakti se si juristët e atëhershëm janë bazuar shumë

në "hadithin" e Muadhrit, ku Muhammedi s.a.v.s. e paska "këshilluar" Muadhritin se me se do ta drejtonte popullin e Jemenit, e ai ishte përgjigjur: me Kur'an. Kinse Muhammedi s.a.v.s. i paska thënë: po nëse nuk e gjen në Kur'an? Ai ka thënë me sunnet... e deri në fund të hadithit. Sikur ta kishte thënë një fjalë të tillë Muhammedi s.a.v.s. 'nëse nuk e gjen në Kur'an' atëherë kemi të bëjmë me një skandal të madh dhe me siguri që do të qortohej menjëherë, dhe madje rëndë nga All-llahu i Lartëmadhëruar, por ju siguroj se këtë nuk e ka thënë, sepse ai nuk fliste me hamendje, por me Vahj [Shpallje Hyjnore]. Fatkeqësisht, ky "hadith" është marrë për bazë ndër shumë juristë...

Nuk ka dyshim se të gjitha përgjigjet që njeriu dëshiron të dijë rreth universit do t'i gjejë në Kur'an, prandaj nuk ka nevojë dhe nuk i lejohet hadithit të pezullojë ajetet, sepse kjo tregon se ajetet nuk janë Hyjnore.

Një hadith i Muhamedit s.a.v.s. thotë: "Të jeni të sigurt se ajo që është thënë në Kur'an është hallall. Kkemi thënë se është hallall, gjithashtu edhe haramin e kemi lajmëruar si haram, me përjashtim të atyre që flasin për mua dhe gënjejnë në emrin tim, të tillët gënjejnë në emër të All-llahut dhe të të dërguarit të Tij"

Inderuari student,

Të jesh më se i sigurt se asnjëherë Muhammedi s.a.v.s. nuk mund të ketë mendim të kundërt ndaj Kur'anit, sepse kur është pyetur Aisha r.a. se kush ishte Muhamemdi, ajo tha: shikoni Kur'anin.

Nuk ka dyshim se të gjithë ne jemi vepër e All-llahut. Gjithashtu, edhe Muhammedi s.a.v.s. ishte i tillë. E si mundet të ketë disharmoni midis Kur'anit Fisnik dhe Muhamedit s.a.v.s., të zgjedhurit të Tij?

Fatkeqësisht, disa dijetarë janë zhgënjyer duke marrë për argument hadithet e trilluara, pastaj nga skepticizmi i tyre dhe nga frika se mos po bëjnë mëkat kanë sjellë rregulla dhe dispozita jo të sakta. Ajo që është edhe më shqetësuese është se tani kemi shumë dijetarë që e kanë këtë frikë. Kjo lë

të kuptohet se ata nuk janë të sigurt, prandaj i anashkalojnë dyshimet e tyre, duke i kaluar ato në heshtje. Ajo që e solli pranë vdekjes Ummetin e Muhammedit s.a.v.s. ishte vendimi i dijetarëve të hershëm kur thanë: nuk ka ixhtihad, dera e tij është mbyllur. Ky vendim ishte marrë vetëm atëherë kur ishin pranuar katër shkollat juridike. Kush ishin ata, dhe me çfarë guximi ia ndaluan gjen-eratave të tjera të merren me hulumtime!? Sigurisht që me guximin e injorancës. Këso vendime dhe shumë raste të tjera keqinterpretuan hadithet ose i trilluan ato, sepse Kur'anin nuk kanë mundësi ta ndryshojnë, ai ka garanci Hyjnore. Ndërsa sa i përket shembullit ose gjysmëhadithit që ju keni sjellë rreth testamentit është: "Thotë Talhat ibn Musrifi: e pyeta djalin e babait të vëllait tim: A la testament i Dërguarit All-llahut s.a.v.s.? Tha: jo. I thash: Si, kur i është caktuar testamenti, ose janë obliguar me të, ndërsa ai nuk la testament!? Tha: Testamenti tij është Libri i All-llahut"

Imam Shatibiu, në librin e tij el Muvafikat, thotë: sunneti nuk është autonom, ai nuk vërteton obligimet ose ndalesat, sepse detyra e tij është t'i specifikojë, t'i shpjegojë dispozitat e përgjithshme të Kur'anit (f.v.) mënyra se si të falemi, si t'i kryejmë obligimet e haxhit, si të sillemi në paqe e si të sillemi në luftë etj...kom. i imi). Pra detyra e tij është të komentojë ajetet e përgjithësuar dhe dispozitat absolute, e jo të ndërhyjë në to.

Dhe krejt në fund, ju kisha këshilluar që ta lexoni fetvanë e datës 01.02.1990 rreth kësaj teme, e cila ka preokupuar dijetarët e Ez'herit. Ndërsa forma e paraqitur nga ju, ose vijës që i 'përkisni', se Kur'ani derogohet me Kur'an, pastaj Kurani derogon sunnetin, sunneti derogon Kur'anin dhe sunneti derogon sunnetin, është formë e studimit aristotelian. Disa dijetarë ishin ndikuar thellë që vendimet e tyre juridike t'i argumentonin me këtë metodologji analitike të logjikës së Aristotelit. ■

Muhamed Jusufi-Kajolli

Gratë në Parlamentin shqiptar gjatë historisë

Me miratimin e Kodit të Ri të Familjes, i cili sjell ndryshime thelbësore në bilancin gjinor, legjislacioni shqiptar e ka sanksionuar barazinë gjinore sipas standardeve të përparuara demokratike. Mirëpo, pjesëmarrja e gruas në proceset e vendimmarrjes dhe në politikë në veçanti, mbetet në nivel shumë të ulët në krahasim me vendet e tjera të Evropës Lindore e Qendrore.



Sabile KEÇMEZI-BASHA

Vitet e fundit, në Shqipëri ka pasur një përparim të konsiderueshëm në përpunimin e legjislacionit kombëtar, në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të grave si të drejta njerëzore themelore dhe në nxitjen e barazisë midis grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike e shoqërore. Sipas të dhënave që kemi, balancimet gjinore në Shqipëri tashmë konsiderohen të rëndësishme në shumë pikëpamje. Me miratimin e Kodit të Ri të Familjes, i cili sjell ndryshime thelbësore në bilancin gjinor, legjislacioni shqiptar e ka sanksionuar barazinë gjinore sipas standardeve të përparuara demokratike. Mirëpo, pjesëmarrja e gruas në proceset e vendimmarrjes dhe në politikë në veçanti, mbetet në nivel shumë të ulët në krahasim me vendet e tjera të Evropës Lindore e Qendrore.

Niveli i pjesëmarrjes së gruas në politikë është i kuptueshëm nga cilësia e zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor i vendit, nga trashëgimia dhe mentaliteti ekzistues, nga mënyra e edukimit dhe pritshmëritë që ka shoqëria për vajzat dhe djemtë dhe nga veçoritë që ka periudha e tranzicionit në Shqipëri.

Historikisht, nëse analizojmë të dhënat për pjesëmarrjen e gruas në politikë, do të vijmë te të dhënat shumë interesante që nga viti 1920.

Më 1920, në Parlamentin Shqiptar kishte 37 deputetë, dhe që të gjithë ishin

meshkuj. Po kjo gjendje vazhdoi deri më 1945, kur numri i deputetëve u shtua në 82 deputetë. Prej tyre 76 ishin meshkuj, ndërsa 6 ishin gra, ose ndryshe gratë merrnin pjesë me 7.3 %.

Gratë parlamentare pjesëmarrjen më të lartë në parlament e arritën në vitin 1974, kur numri i tyre u rrit në 83 veta ose 33.2 %, nga 250 deputetë gjithsej sa kishte parlamenti. Ndërsa, pas viteve të rënies së komunizmit, më 1991, parlamenti shqiptar kishte gjithsej 250 deputetë dhe vetëm 51 ishin gra, ose 20.4%. Më 2001, numri i deputetëve ishte 141, dhe gratë merrnin pjesë me 9 veta ose me 6.4%.

Në vitet e socializmit, gratë përjetuan një emancipim të rëndësishëm

Duke i analizuar të dhënat bie në sy se përqindja e grave në parlamentin e vitit 2002 është e krahasueshme me atë të vitit 1945. Megjithatë, niveli më i lartë

Gjatë dekadave të udhëheqjes së Partisë Komuniste gratë, së paku sa i përket arsimimit dhe punësimit, përjetuan një emancipim të rëndësishëm. Por me kalimin në tranzicion, ato i paguan shtrenjtë ndryshimet. Në pushtetin vendor, niveli i pjesëmarrjes së grave ishte tepër i ulët. Në zgjedhjet e fundit vendore (tetor 2003) nga 76 kandidatë (gra dhe burra) për kryetar bashkie fituan vetëm 3 gra, pra vetëm 4% e kandidatëve. Ndërsa për postin kryetar komune, nga 308 kandidatë fituan vetëm 6 gra, pra vetëm 2% e kandidatëve.

Sipas të dhënave që ofron "Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare", thuhej se "Në Parlament, në zgjedhjet e fundit, Shqipëria e uli aq shumë përfaqësimin e grave në organet vendimmarrëse (vetëm shtatë gra në Parlament ishin deputete) sa zuri vendin e fundit në tabelën e kualifikimit evropian që mat këtë standard. Në qeveri ka një prani më të dukshme, me dy ministre. Një numër i madh grash drejton drejtori e sektorë të rëndësishëm të jetës. Në fushën e drejtësisë numri i avokateve, gjyqtareve, notereve e juristeve të të gjitha kategorive është shumë i lartë, pothuajse i barabartë me atë të të burrave, kurse në shëndetësi e arsim është edhe më i lartë se i burrave.

Kjo vlen vetëm në nivelin horizontal, por në nivelin vertikal, megjithatë dominon bota mashkullore se vendet kyçe, udhëheqëse dhe vendimmarrëse iu takojnë burrave.

Zhvillimi i sektorit joqeveritar dhe ai i organizatave të

grave në Shqipëri ka ndihmuar dukshëm në përgatitjen e grave lidere të ardhshme, që kishin kapacitete për menaxhim, dhe këto aftësi vinin në shprehje nëpërmes realizimit të projekteve të ndryshme të nivelit kombëtar. ■

Përbërja e Parlamentit shqiptar në baza gjinore nga viti 1920-2005

Viti	meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj %	Femra %
1920	37	0	37	100	0
1921	78	0	78	100	0
1925	75	0	75	100	0
1928	57	0	57	100	0
1945	76	6	82	92.7	7.3
1950	104	17	121	86	14
1958	171	17	188	91	9
1970	192	72	264	72.7	27.3
1974	167	83	250	66.8	33.2
1982	174	76	250	69.6	30.4
1990	169	81	250	67.6	32.4
1991	199	51	250	79.6	20.4
1997	144	11	155	92.9	7.1
2001	132	9	141	93.6	6.4
2005	130	10	140	92.85	7.14

i pjesëmarrjes së grave në parlament del në vitet e periudhës së socializmit 1970-1990, kur dihej se gjatë kësaj periudhe emancipimi i gruas dhe pjesëmarrja e gjerë e saj në të gjitha fushat e jetës ishte një nga përparësitë e regjimit.

Kur shpresa për të ardhmen, shuan dhembjen e së kaluarës!

Riad Abdullahu (7) i kishte vetëm tri vjet kur snajperistët serbë ia kishin vrrarë babanë, Fatmirin, në protestat e 17 marsit të vitit 2004, mbi lumin Ibër në qytetin e Mitrovicës. Ndonëse ishte vetëm tre vjeçar, ai e kujton babanë e tij që çdoherë kur vinte nga puna i sillte një çokolatë...



Naim SADIKU

MITROVICË, PRILL

Kanë kaluar katër vite nga protestat e “marsit tragjik”, në të cilat kanë humbur jetën 19 persona dhe janë plagosur qindra të tjerë. Në mesin e të vrrarëve ishte edhe Fatmir Abdullahu nga Mitrovica. Katër vjet pas, djali i tij i vetëm Riadi, ende shpreson se babai i tij do të kthehet një ditë, që t’i sjellë atij ushqimin e preferuar – çokollatat.

Riad Abdullahu (7) i kishte vetëm tri vjet kur snajperistët serbë ia kishin vrrarë babanë Fatmirin, në protestat e 17 marsit të vitit 2004, mbi lumin Ibër në qytetin e Mitrovicës. Ndonëse ishte vetëm tre vjeçar, ai e kujton babanë e tij që çdoherë kur vinte nga puna i sillte një çokolatë... Edhe pse tash e sa kohë jeton vetëm me të ëmën, Nazlijen, ai assesi nuk pajtohet me realitetin, por thotë se baba i tij ka shkuar në Suedi për të punuar!...

E përqafoi shumë djalin, sikur të dinte se ai nuk do të kthehej më...

Bashkëshortja e Fatmirit, Nazlija (40), kujton ditën e 17 marsit, të cilën e quan si tragjedi të madhe që goditi familjen e saj. Ajo thotë se zemra e saj është e mbushur me dhembje e pikëllim, pasi që ka mbetur e vetëm me djalin Riadin. “Atë ditë, Fatmiri para se të nisej për të shkuar në punë, më përqafoi, ashtu bëri edhe me Riadin, i cili ishte ende duke fjetur... Iu afrua e puthi dhe e përqafoi duke e shtrënguar fort dhe i tha se baba të do shumë, sikur ta dinte se nuk do të kthehej më... Edhe pse lufta ishte krye pesë vjet ma herët, u desht që Kosova sërish t’i sakrifikojë bijtë e saj vetëm e vetëm që të jetësohet ëndrra e shqiptarëve, e në

mesin e tyre ishte edhe burri im”, rrëfen Nazlija me sy të përplotur.

Duke e mbajtur në prehër Riadin, ajo tregon kohën e vështirë që ka kaluar si nënë, pas vdekjes së bashkëshortit. Ajo brengoset se si do të arrijë t’ia sigurojë birit të saj një ardhmëri më të ndritur dhe më të sigurt. “E kom pas shumë vështirë me vazhdu me jetu veç me një djalë. Nuk kam as shtëpi e as banesë time, thjeshtë nuk kam ku me siguru së pari kulmin mbi kokë. Pastaj, as nuk punojë, se edhe mosha po e bon të veten, dhe po kam frikë se djalit tim nuk do të mundem t’ia përmbushi bile



Riadi me nënën e tij Nazlijen, vendosin lule te varri i Fatmirit

kërkesat elementare të jetës”, shprehet e dëshpëruar Nazlija, e cila shpreson se jeta do t’ia lehtësojë të ardhmen. Ajo thotë se çdo gjë do të sakrifikojë vetëm e vetëm që Riadi të ndjehet mirë dhe të mos e mendojë e kaluara. Dëshira e vetme që atë do ta bënte ta ndjehej më mirë, siç shprehet ajo, do të ishte që Riadi të rritet si të gjithë bashkëmoshatarët e tij.

Jeta me 65 euro ndihmë sociale

Nazlija me të birin Riadin, momentalisht është duke jetuar në një banesë në qytetin e Vushtrrisë, e cila është pronë e

Fatmir Abdullahu është vrrarë nga snajperistët serbë në protestat e marsit të vitit 2004, të zhvilluara në qytetin e Mitrovicës pas mbytyjes së tre fëmijëve shqiptarë në lumin Ibër. Përveç Fatmirit, në trazirat e marsit në Mitrovicë, qenë vrrarë edhe tre mitrovicas dhe qenë plagosur dhjetëra të tjerë.

UNMIK-u si organ kompetent për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë, nuk kishte arritur t’i ndalojë as protestuesit shqiptar, e as serbët e pjesës veriore të Mitrovicës, të cilët nga largësia shtinin me armë zjarri në drejtim të protestuesve shqiptarë.

një kushëriri të saj. Ajo nuk ka të ardhura të tjera përveç ndihmës sociale në shumë prej 65 eurosh, me të cilat i përballon kërkesat mujore për ushqim. Përveç kësaj, ajo thotë se disa herë ka marrë ndihma (kryesisht ushqimore) nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. “Këto organizata më kanë dhënë kryesisht miell, vaj, makarona dhe gjëra të ndryshme ushqimore. Kurse një organizatë zvicerane një herë më ka ndihmuar me 100 euro”, shprehet ajo.

Në përvjetorin e rënies, më 17 mars, kur u shënua katër vjetori i këtyre protestave, Nazlija së bashku me djalin e saj Riadin kishin vendosur lule mbi varrin ku prehen eshtrat e bashkëshortit të saj, Fatmirit. Atë, krahas dhembjes dhe shpresës për të ardhmen, e mundon fakti se kryesit e këtyre veprave kriminale ende shëtitin të lirë, ndërsa drejtësia ende nuk është vënë në vendin e saj. As pas katër vitesh, asnjë i dyshuar për vrasjet që kanë ndodhur në trazirat e marsit të 2004-s nuk kanë dalë para drejtësisë. “Vetëm një gjë më bënë të ndihem mirë, pasi që amaneti i burrit tim si martir i këtij kombi është realizuar me arritjen e pavarësisë së Kosovës”, thotë ajo, duke shtuar se sa do të dëshironte të ishte pjesë e asaj feste të madhe, që sipas saj, ai e kishte pritur dhe ëndërruar me vite të tëra. ■

Interpretimi i tekstit

Fryma e lirisë jetësore

Liria jepet e përfytyruar dhe e kërkuar. Kërkimi i saj bëhet synim kryesor. Ky tip ligjërimi në tekstin dramatik zhvillohet duke u argumentuar më një vetëdije të plotë.



Flamur MALOKU

Teksti 'Liria po vjen' i Milazim Krasniqit për nga statusi i zhanrit është tragjikomedi e ndarë në katër pamje, me një shumësi aktorësh, ku personazhet në tekst shënjojnë karaktere të veçanta në veprim dhe në tërë hapësirën e strukturës së tekstit dramatik. Karakteret e personazheve, ndërtohen në një vijë të lakuar të njohjes përmes relacionit të ngushtë – dialogut, i cili thekson fatalitetin e protagonistit, Bardhytit. Burgosja e Bardhytit për tetë vite, brenda idesë së tekstit është e qartë, e shtruar dhe e argumentuar, duke u shënjuar edhe nga vetë dialogu i personazheve, të cilët tani rastin e Bardhytit e marrin si diçka shumë të veçantë. Pathyeshmëria shpirtërore e protagonistit shtron shumë dilema tek gardiani, psikologu dhe shefi, që tani vazhdimisht mundohen të zbulojnë shkaqet e atij karakteri. Analiza e këtij karakteri prej tyre e dërgon tekstin

drejt nivelit psikologjik, nëpërmjet analizave të kombinuara mjekësore-police, që i bëhen protagonistit. Ballafaqimi i protagonistit me rivalët e tij, e përkufizon edhe vetë pozicionimin e tij, i cili shpaloet në fushën e idealit atdhetar. Një gjë e këtillë vërehet edhe në refrenin e protagonistit, 'Liria po vjen', duke shtruar njëkohësisht edhe shumë ide. Kjo liri ka kuptimin e asaj që kërkohet vazhdimisht në jetën e përditshme jetësore, duke qenë njëherësh edhe ideal për çdo njeri-popull, një gjë e tillë theksohet edhe në dialogun e Bardhytit me gardianin:

BARDHYLI: Liria nuk është gjendje materiale dhe objektive, shoku Gardian.

GARDIANI: Sa po më çudit!

BARDHYLI: Liria është ideal!

GARDIANI: Ideal?

BARDHYLI: Përjetim personal.

Shpjegimi i lirisë karakterizohet nëpërmjet fjalëve të protagonistit që tani është më se i bindur për atë që flet. Fryma e lirisë jepet e përfytyruar dhe e kërkuar. Kërkimi i saj bëhet synim kryesor. Ky tip ligjërimi zhvillohet duke u argumentuar më vetëdije të plotë edhe

pse veprimet e personazheve krijojnë nganjëherë anën komike, por çdo herë më një pretendim vetëdijesues. Dëshira për lirinë, kur ajo mungon, është e madhe e sidomos kur ajo është e penguar nga tjetri. Pengimi i lirisë nga tjetri në idenë e tekstit përkufizohet si vdekje për një popull. Kjo bëhet esenciale gjatë thurjes së tekstit. Në këtë rast, gjatë dialogut edhe personazhet vetë-përkufizohen. Dëshira e flakët e personazhit, Bardhytit, për liri është domosdoshmëri jetësore dhe sakrificë për lirinë e një kombi. Edhe fjalët që ky i jep gjatë shpjegimit tregojnë vendosmërinë e tij ndaj atdheut, ndaj idesë së kodit nacional

SHEFI: Na intereson të dimë arsyet pse vazhdimisht po e përsërit atë refren të mbrapshtë, "Liria po vjen". Për cilën liri e ke fjalën?

BARDHYLI: E dini ju mirë për cilën liri e kam fjalën. Për lirinë e popullit tim.

SHEFI: Mirë, mirë. Ama tetë vjet e njëjta gjë. Si nuk të mërzhitet?

BARDHYLI: Unë i përkas asaj race, e cila nuk mërzhitet nga pritja. Ne luftëtarët e lirisë dimë të presim me vite e me shekuj dhe nuk lodhemi nga pritja, as nuk na dobësohet besimi.

Dashuria për lirinë ngrihet brenda personazhit si detyrë e dyfishuar shpirtërore dhe e paluhatshme karshi atdheut në varësi të ballafaqimit me sfidën. Ky tani edhe identifikohet më të. Në mënyrë paradoksale, qëndresa dhe përthyeshmëria e protagonistit rezultojnë me lirim dhe parakohshëm nga burgu, por me qëllime të mbrapshta. Lirimi i Bardhytit bëhet më shumë për shkak të analizave që këtij i bëhen nga psikologu dhe shefi, sepse këta e dinë mirë pozicionin e tij. Por lind një pretekst. Ky pretekst merret si shkak çmendje, e cila nuk perceptohet, por më shumë është intrigë e këtyre, sepse këta e dinë se çka do të thotë lirim i parakohshëm, dhe pikërisht duke e lidhur me ditën e pavarësisë së



shtetit të tyre. E tërë kjo do të bëhet kushtëzim për fatin e vazhdueshëm të Bardhytit. Tani fati i tij jepet për të sintetizuar idenë e përcaktimit si element të pashmangshëm në kuptimin e pësimit individual. Është e qartë se pësimi vjen nga shkaku i refuzimit të njerëzve – ambientit, pra ambienti e refuzon dhe e quan tradhtar, spiun, sepse ky është liruar para kohe:

I DYTI: Shihe se me ç'pasion i është përkushtuar lirisë!


I PARI: Shtiret, o vëlla, shtiret. Kështu e kanë detyrë të gjithë spiunët.

I DYTI: Unë do ta përshëndesja!

I PARI: Unë nuk dua as ta shoh me sy! Nëse e përshëndet atë, llogarit se me mua më nuk je mik! Tradhtarët janë të neveritshëm!

IDYTI: Nuk e di... Më vjen keq, por nuk po ta prish.

Pra është kjo paraqitje e një situatë ku tanimë ambienti e refuzon duke e quajtur si tradhtar. Refuzimi mundohet të argumentohet mbi një pikë të vetme, siç u cek më lart. Bardhyli tani nuk e ka më epitetin e njeriut të vuajtur për idenë e madhe nacionale. Tërë këtë braktisje e vëren edhe ky vetë dhe kjo e bën njëherësh edhe më agresiv. Të shkosh deri në vetëflijm për atdheun dhe të përbuzesh nga vetë njerëzit e atdheut është fatalitet për vet kombin, e jo vetëm për atë që ka shkuar deri në flijim. Janë këto ide që i ofron teksti në strukturën e tij semiotike. Kështu, dilemat e refuzimit theksohen e kushtëzohen nga fati tragjik i protagonistit. Realiteti bëhet edhe më i vështirë dhe krejt ndryshe nga ai që ishte menduar nga ky vet. Lufta individuale përballë realitetit shtrihet në diskurs drejtpërdrejt, si esencë dhe si eksplikim ideor. Artikulimi në rrafshin individual, vjen ngadalë edhe përmes gjuhës figurative; edhe zëri i paraqitur shënjon dhe prek gjendje shpirtërore në kuptimin simbolik. Bardhyli tani ballafaqohet edhe me njerëz që e sfidonin edhe më shumë atë, vetëm që të shihnin nëse liria e tij individuale, që i ishte dhënë prej tyre, po funksiononte në realitetet apo



jo. Kjo shihet tek takimi me psikologun e dikurshëm të burgut:

PSIKOLOGU: Kush nuk ka nderim për ju, është injorant. Ajo që keni bërë ju për çështjen kombëtare është me vlera historike!

BARDHYLI: Kam bërë vetëm detyrën. Por, me të vërtetë më habisin bashkëkombësit e mi. Më tmerrojnë. Nuk kanë kurrfarë nderimi për sakrificat e mia jetësore. Kam humbur rininë në burgje, kam mbetur pa familje, kam mbetur i varfër dhe nuk jam gjunjëzuar para okupatorit,

ndërsa këta më kanë shpallur tradhtar dhe nuk më nderojnë aspak.

Në këtë nivel theksohet gjendja e refuzimit në trajtën e pamundësisë së komunikimit me rrethin – ambientin. vetëm tani ky e kupton refuzimin. Kështu, shtresimi tragjik vjen dhe artikullohet si përhershëm individual në pamundësinë e ndryshimit. Mos ndryshimi dhe përpjekja e vazhdueshme për ndryshim bëhet fatalitet-pësimi. Shqiptimi i idesë për ndryshim, vetëm sa e bën edhe më të vështirë jetën e tij, duke shkuar deri në pësim. Edhe vdekja tragjike e Bardhytit vihet në parodi.

Këtu diskursi ngrihet në ide dhe në pozicionim të personazheve. Rrafshi i pozicionimit të tyre përballë statusit të heroit thekson idetë dhe karakteret e tyre. E tërë kjo realizohet me gjuhë simbolike, duke nënshtresuar shenja të veçanta dhe të përgjithshme mbi idenë e kodit nacional dhe mbi heroin e flijuar për të, që tani njerëzit e quajnë tradhtar. Ndërsa reagimi i protagonistit gjatë varrimit, dhe prishja e lojës skenike, njëkohësisht edhe hyrja e lojës në lojë, ndërtohet në formë theksimi dhe karakterizimi të veçantë dramatik, duke theksuar gjuhën sa simbolike, aq edhe metaforike. Kështu, Milazim Krasniqi në artin dramatik artikulon dramën shënjuese të konceptuar në ide dhe në strukturë. ■



Poezi

Vrapin nuk e njeh



Vesel ISLAMI

Ti

Ti je (ajo)
që shpresën gjatë
e gjatë ma ushqeve
e në fund ma preve
Ti je (ajo)
që më dhe goditjen
më të egër të jetës
nuk më ke goditur në shpirt
e as në zemër, jo
Ti që me bëre të qesh
tani nuk mund të më bësh të çaj
kurrë nuk mund të më ngërthësh
në vaj
e ti mos harro
se plagën po e shëroj
në ujërat kam notuar
në to: jam zhytur
jam ulur e ngritur
jam larë e shpërlarë
për goditjen tënde
në jetë.

Mos harro

Kurrë mos harro
kush ishe dje
të gjithë e dinë
sot kush je
për nesër as vetë se din
kush je
ngado që shkon
çfarëdo që bën
kurrë mos harro
në sytë e të tjerëve je.

Hija ime

Ngado që shkoj
ajo po më ndjek
e unë nuk e ndjej
ngado që sillem
ajo më vjen prapa
e nuk e vërej
gjithmonë më përcjell
çdo herë pas më vjen
ngado që iki
gjithçka bëj
të vetëm nuk më len.
kur dua t'i flas
s'më shikon në sy
thua që nuk e kam afër
thua që nuk ndodhet aty
i afrohem ngadalë
ajo ikën nga unë
dua vetëm ta përshëndes
e s'mund ta zë askund.

Hapi e vrapi

Dy hapa
para vetes bëra
më tutje s'munda dot
provova hapin e tretë
ishte gjë e kotë
një zë mu gjegj në vesh
nuk kuptova gjë
mos provo ta luash hapin
se vrapin nuk e njeh
mos nguro nxito
që ta mësosh hapin
po se dite atë
s'mund ta bësh dot vrapin.

J. Soboli 2007

Bota e librit

Vetëm vdekja është e bardhë

Sali Bashota: "Only Death is White"/ "Vetëm vdekja është e bardhë", vëllim në gjuhën angleze, përktheu Avni Spahiu, Editura "Rozafa", Prishtinë, 2005.

Marius CHELARU

RUMANI

Më 20 tetor 2006 mendoja, duke e prezantuar "Antologjinë e poezisë shqipe në gjuhën rumune" në Universitetin e Tetovës, se një nga çështjet e ardhmërisë për vendet e botës (jo vetëm ato të vogla) do të ishte mënyra se si menaxhohet fati i gjuhëve të tyre, të kompleksit të akumulimit që e definon civilizimin. Një çështje tjetër është i lidhur me faktin se mobiliteti i personave, por edhe i kthesës së historisë (po qe se i referohemi pikërisht kësaj pjese të botës fqinje me Rumaninë), kanë ndikuar që tejmatanë kufinjve të atdheut të ekzistojnë komunitete/grupe më shumë apo më pak të panumërta, individësh që shkruajnë në gjuhën e vendit të origjinës. Është rasti i Besarabisë (Republika e Moldovës), Bukovinës Veriore, Banatës Perëndimore (ndërmjet Vërshoarës dhe Pançevës) etj., për Rumaninë, apo Kosova për Shqipërinë. Duke analizuar shkrimet në gjuhën shqipe, është interesant për analizë nga pikëshikime të ndryshme stilistike, tematike etj., veprat e shkruara në vende të ndryshme: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni apo në zona tjera ku shkruhet dhe jetojnë poetë shqiptarë (Italia – me një komunitet të fuqishëm arbëreshësh, të motshëm prej qindra vitesh, do ta përmendim Kate(rina) Xukaron, italisht: Caterina Zuccaro, apo shqiptarët e ardhur nga valët e emigrimit më të ri – Mardena Kelmendi, Vitore Stefa Leka etj., në Suedi, Rizah Sheqiri etj., në Gjermani: Arif Molliqi etj.)

Kosova është e mirëpërqendruar në hartën e poezisë/letërsisë së gjuhës shqipe, përmes krijimeve cilësore të kreatorëve të shquar. Një poet i njohur nga Kosova është edhe Sali Bashota, për të cilin kemi theksuar se duke deshifruar ndjeshmërinë e tij lirike, përkatësisht vlerat e shkrimeve të tij, konstatojmë

se është njëri ndër poetët më të rëndësishëm shqiptarë të Ballkanit.

Sali Bashota u lind në Cerovik të Klinës (31 Gusht 1959). Në kuadrin e Fakultetit Filologjik të Prishtinës, kreu Degën Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, ku magjistroi dhe doktoroi. Aktualisht është profesor universitar dhe drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Ka qenë kryeredaktor i revistës letrare Jeta e Re (2000-2003), ish/kryetar i Departamentit të Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filologjisë pranë Universitetit të Prishtinës. Është theme-



lues dhe drejtues i Shtëpisë Botuese Rozafa në Prishtinë. Përveç poezive, merret edhe me ese dhe kritikë letrare. Është autor i një monografie mbi shkrimtarin e shquar shqiptar, Mitrush Kuteli, që ka jetuar dhe shkruar edhe në Rumanë. Është laureat i disa shpërblimeve letrare: Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi, Pena e Artë e revistës Fjala. Vepra të botuara: Album i grisur (1986), Zogu me profil vjeshte (1989), Plagomë (1994), Shqipshkrimi kritik (1997), Kuteli prozator, poet, kritik (1999), Dalje nga trishtimi (1999), Domethënia e ideve letrare, 2001, Ndiz dritën magjike (2002),

një vëllim në gjuhën gjermane (Schalte Das Magische Licht Ein, 2004), Ekzili i shpirtit / Exilul sufletului, përkthime në gjuhën rumune me tekste të zgjedhura nga Baki Ymeri, botim bilingv (shqip-rumanisht), që e pa dritën e botimit në Bukuresht (2004), me përkrahjen e Bashkësisë Kulturore të Shqiptarëve të Rumanisë, ndërsa një vit më vonë edhe ky vëllim në gjuhën angleze, Only Death is White, botuar në editurën Rozafa, në Prishtinë (2005).

Siç kemi thënë, është mirë që poetët e Kosovës (zonë e shtypur nga spektri i disa luftërave që zgjasin qindra vjet, të cilën demonët e luftës duket se nuk duan t'i përgjumin, duke zgjuar e trazuar konflikte, të cilat thuajse askush nuk mund t'i shkalërojë), falë Baki Ymerit dalin në gjuhën rumune dhe në Rumanë, ngase arti është një ambasador i mirë.

Sa i përket artit poetik të Sali Bashotës, po qe se i kundrojmë në pasqyrë të dy vëllimet, mund të themi se Ekzili i shpirtit është i shkruar me një çelës më të ngjyrshëm për nga nuancat e dhembjes, shqetësimit dhe kujtimeve të dhembshme. Vetëm vdekja është e bardhë mund të karakterizohet kësaj: varg i shkurtër, njëfarë lakonizmi që s'ka mundësinë për të bërë fjalë për mungesën e metaforës, përkundrazi, që konturon tablo ngjyrash të melankolisë, nostalgjisë dhe shqetësimit, kujtime që rrjedhin e derdhen përmes gishtërinjve të shpirtit në çastet e të tanishmes, duke i skalitur hapat e poetit.

Në Ekzilin e shpirtit atmosfera e poemave është më së shumti e dominuar nga një shqetësim i pafund, i paskajshëm, i pambarimtë, tjetërherë nga dëshira apo nga shpresa. Fjalët kyçe përmes të cilave do të mund ta definonim poezinë e Bashotës do të ishin: shpirt (që mund të jetë i shkrirë, i përgjakur, i shpërngulur, madje edhe atëherë kur mungon, etj.), vdekur-gjallë, vyshkur-lulëzuar, vetmi- pritje, dashuri etj. Shpirti (nga disa poema, siç kuptojmë, mund të jetë

edhe poezia) është, na e merr mendja, një nga pikat e mbështetjes për artin poetik të Sali Bashotës. Bile/madje hapi tejmatanë kufirit të fundit të jetës, arkivoli është „Nga ngjyra e shpirtit të vrarë” (**Baladë për vetveten**).

Vetëm vdekja është e bardhë është e ngjyrosur në nuanca më personale, në të cilat, duke gjykuar në pasqyrë, fjalët kyçe mund të jenë: vetmi (që „qan/ mbi trotuaret e shkreta” – Perëndim dielli në vjeshtë), trishtim, mallkim, dhembje (në fund, „krejt dhembjet do të ringjallen një ditë/ në sheshin më të bukur të trishtimit” – Dhembje), harresë, vdekje – që e shoqërojnë ëndrrën, dashuria, puthja (që mund të jetë „e mallkuar atje/ në qytetin e damkosur” – Frymëmarrje), shëmbëlltyra, sytë, buzët, „peneli” duke qenë „përdorur” në veten e parë. Po qe se do të zgjedhnim një një vjershë përcaktuese për vëllim, do të ndodheshim përballë një ndër-marrjeje të vështirë. Ndoshta do ta zgjedhnim Visin e gurëzuar/ të shkretë, në të cilin edhe „mëkatet digjen/ duke të shakmisur”, dhe ku do të „mund të vdisnim të gjithë/ të lumtur në një Parajsë”, në të cilën „vetëm ëndrrat bëhen të bukura”. Apo, ndoshta, Pasqyra: „në çdo ditë e ... dhembjen/ në një pasqyrë të thyer/ duke u bërë ... i harruar/ në ditën e nëntë të vetmisë”.

Edhe në Vetëm vdekja është e bardhë, porsi në Ekzilin e shpirtit, poeti i bishtëron petkut të konkretes, do të mund të thoshim me këmbëngulje në rastin e vëllimit të dytë (përrjashtim: referime konkrete në disa personazhe nga e shkuara e Shqipërisë apo botës: Dardania, Shën Naumi, Kosova, Drini, Vjosa, Mojsi Golemi nga koha e Skënderbeut, Latif Berisha – poeti i vrarë, etj.), dhe në radhë të parë përmes mënyrës në të cilën bota, faktet, mendimet, më shumë se disa konture, të cilat i koloron me penelin e metaforës.

Te Ekzili i shpirtit motivet e ndërlidhura me luftërat e kohëve të fundit që e patën përgjakur ish/Jugosllavinë, e sidomos Kosovën, janë të bujshme. Në Vetëm vdekja është e bardhë mund t'i vërejmë vetëm disa herë, siç bie fjala në rastin e poezisë Forma tjetër e vdekjes, një peizazh i një qyteti të hatashëm të cilin ngjyrat e dhembjes janë shpërndarë gjithandej për një kohë të gjatë.

Në të dy këto vëllime, në këto kohë ngurrimesh shpirtërore të përmbushura me vetmi, dashuria për poetin vjen e do të vijë dikur, si një premtim i fshehur ndërmjet zbukurimit të ditëve që do të pasojnë me një befasi për të dashurën: „Një vjershë për vjeshtën do të shkruhet atëherë/ Ndërmjet shkrumit tim dhe buzëve tua” (A s'të kam thënë E dashur, nga vëllimi Ekzili i shpirtit). Sipas Sali Bashotës, në vëllimin Vetëm vdekja është e bardhë, „shpirti zhvishet i tëri/ në një tjetër dashuri”. Bukuria, porsi dashuria, tejduken madje edhe kur kanë petka (qofshin edhe të përkohshme) të shoshitura, apo të shakmisura nga dhembja, nga vetmia, janë dy portat e shpresës, të rrugës së shpirtit ndaj ngjyrave të limonit. Porsi poetë tjerë të gjuhës shqipe në Kosovë (dhe jo vetëm), Sali Bashota jeton në një botë në të cilën bindja duket shpeshherë se flaket nga dhembja, nga lotët, nga vetmia, në konfrontim me një realitet të zymtë... ■

(Përktheu nga rumanishtja: B. Y)

Lexim teksti

Shenjat interte



Muhamed ÇITAKU

Rexhep Qosja në romanin “Një dashuri dhe shtatë fajë” rikontekstualizon shenja kohore dhe vendore nga konteksti i Kosovës së viteve 1981-1989. Këto shenja përderisa barten edhe janë intertekstuale. Gjersa rivendosen njohin tekstin edhe vihen në sistem të ri shkrimor e letrar. Kjo shkrimor e letrar është rikontekstualizim që i largon ato dyfish; njëherë se kalojnë në shkrim, e herën tjetër se kalojnë në letërsi - fiksjon. Tash shenjat konkrete universalizohen. Në fiksjon bëhen figura. Pra diç tej vlerës së parë jetësore, te artistikja. Tash loja me to e krijon dhe mban gjithë tekstin. Një rikontekstualizim me vlerë edhe për jetën (universalizimi i saj) edhe për artin (loja-estetika).

Shenjat kontekstuale barten me forma e mjete të ndryshme; si ankth, si lojë, si tragjik, etj. Kjo po shenjon edhe diç: përzgjedhjen e shenjave. Përzgjedhja përjashton esencialisht dokumentin historik. Këtu jo se s' kemi dokumente, po ato janë dekore formale e jo esenca. Dokumenti përjashton lojën, e ato janë lojë. Pra edhe përzgjedhje shenjash edhe lojë e tyre. Herën e parë për afrim e herën e dytë konvertim i tyre në artistikë. Kështu romani është shumë letrar edhe atëherë kur krijon përshtypjet të jetë shumë joletrar. Tash përshtypja “dokumentare” bëhet mjet artistik. E me përshtypjen jemi te lexuesi. E romani duke luajtur me materialin intertekstual luan edhe me lexuesin. Tash shenjat intertekstuale që krijojnë e thyjnë përshtypje vënë në lojë diapazonin e pritjes së lexuesit.

Përveç kohës dhe vendit të caktuar (Kosova, '81-'89), në roman rikontekstualizohen edhe vepra të ndryshme të shkruara e gojore, letrare e shkencore. Ky komunikim me vepra krijon një diapazon të gjerë sinkretizimi zhanror. Tash barten si arkitekst në roman gjitha zhanret letrare e joletrare. Arkiteksti tash si intertekst. Ai hap komunikim të shumëfishtë si në nivel idesh edhe në nivel strukture. Në nivel të ideve rikontekstualizohet gjithë historia e botës edhe e rrafshit kulturor, edhe politik, edhe filozofik, etj. Në nivel strukture komunikon me tërë format e shkrimeve artistike e shkencore. Tash interteksti si problem më i thellë tej formales, kah struktura. Këtu hyn komunikimi me dokumentin, historinë, prozën poetike, poezinë, dramën, fjalorin, kujtimet,



ekstuale

memoaret, biografinë, filozofinë e deri te mbishkrimet e varreve (epitafet). Madje shpesh natyra e diskursit duke tërhequr pas edhe strukturën zhanrore, p.sh., material abstrakt - filozofinë, argumenti objektiv - dokumentin, informacioni subjektiv - autobiografinë, etj. E gjithë kjo në nivelin e komunikimit sintagmatik. Por Qosja vë komunikim edhe paradigmatic. Në këtë rend komunikimi bartën format e rrymave letrare prej antikës deri te ato më bashkëkohore. Prandaj romanin herë e shohim më klasik, herë më sentimental, iluminist, realist, simbolik, modernist, etj. Dhe bashkë me to interteksti ndërron fytyrën në nivel strukture si arkitektet e në nivel idesh si citat i deklaruar, si citat i padeklaruar, si imitim, etj. Ky ndërkomunikim i madh romanin e bën njëkohësisht shumë personal edhe shumë të huaj. Interteksti është prezent çdo kund - për këtë i huaj - po ai intertekst hyn në një mjeshtri strukturimi shumë të veçantë - për këtë është personal.

Shenjat e personazheve, imazheve dhe syzheve


Interteksti nuk kushtëzon material ideor/zhanror me të cilin duhet ko-



munikuar. Ai bartet nëpër të gjitha temat e zhanret. Kjo edhe për personazhet. Ato kanë një finesë shumë konkrete (interteksti nga realiteti) por shpejt ngrihen në përgjithësim. Edhe tash prania e rrymave të ndryshme i bën herë klasikë, herë sentimentalë, simbolikë, me himnizim, me parodizim, etj. Qosja tash bart arketipat e personazheve të rrymat letrare. Arketipat si shenja të strukturës së brendshme të tyre. Personazhet komunikojnë intertekstualisht edhe me Biblën, me Kur'anin, me traditën, etj. Kjo reflekton herë në sjelljet e tyre, herë në biseda, ligjërime, emërtime, llagape, sharje, etj. Tash ata bartin frazeologjinë nga rrafshet e lartshënuara. Pra frazeologji, interteksti më i madh se fjala. Prej arketipave të frazeologjia, prej strukturës të forma. Kështu në nivele të ndryshme kemi komunikime të ndryshme intertekstuale. Ndërsa në nivel receptimi ky gërshetim kërkon lexues model, së paku për aq sa i thyen arketipat në të mirë të një tipi të ri.

Personazhet e tilla të mbindërtuara shprishin edhe kufij zhanror gjersa romani i gërsheton prozën, dramën, poemën, edhe kufijtë kohor e vendor, intelektual e (ç)mendurak. Tash karakteristika të tipizimeve të personazheve nga zhanret e ndryshme rikontekstualizohen si intertekst. Në anën tjetër gjersa rivendosen shenja nga realiteti, histori të këtij procesi bëhen edhe njerëzit real. Tash si personazhe të shkrimit. Me të Qosja si thyes i distancës konvencionale art - realitet.

Qosja të njëjtën gjë e bën edhe me imazhet e përshkuara duke i rikontekstualizuar si intertekst pamjet reale, simbolike, mitike, fantastike, etj. Shpesh fillon si romantikët me pamje të natyrës, por shpejt thyen shkrimin ku bimët e kafshët shenjojnë njerëz. Pra, prej distancës



njeri - bimë/ kafshë drejt identifikimit.

Tash një gërshetim shtresash nga dy nivelet, edhe nga realiteti edhe nga rrymat letrare. Në rendin denotues nga realiteti e në atë konotues nga rrymat letrare. Ndërron objekti ndërron komunikimi, ndërron edhe pozicioni ku vendoset. Këtu bartën si intertekste edhe syzhet nga Kur'ani, Bibla, letërsia popullore, miti, etj. Veçse jo si të plota. Këtu syzheu vjen për ta plotësuar një rend të mëparshëm, ta japë një ide, ta vazhdojë a përmbyllë atë. Pra rikontekstualizimi i syzheut prek edhe idetë, edhe nivelet e tjera të tekstit.

Pra, në këtë roman, mjeshhtëria e përdorimit intertekstual shprish monotoninë e shkrimit dhe krijon dinamikë të hatashme. Ritmi krijohet me ndërrim komunikimi, me zëvendësim, shpërndërrim, thyerje etj. Kështu interteksti në këtë roman është një ind përçues në gjithë shkrimin me përdëgjime të ndryshme ideore e strukturore. Kështu loja është e shumëfishtë varësisht se me cilin bosht vertikal a horizontal, paradigmatic a sintagmatik komunikon shenja. Gjersa komunikon me rrjete të ndryshme tekstesh që hyjnë si intertekst, secila e prish rendin e krijuar më parë. Kjo krijon ndërtime e çrregullime kodesh të ndryshme. Për këtë edhe sistemimet e veprave të tilla në rangun zhanror, tematik, strukturor, etj. janë të pamundshme. E dihet se këto thyerje i bëjnë vetëm shkrimtarët e mëdhenj. ■

Prozë poetike

Muri

Berat DAKAJ

Jo zotëri! Asnjë hap më nuk ecën para. Ama hiq më asnjë, asnjë pëllëmbë, bash asnjë. Hiq ama. Është ndalur para tij dhe po e godet me kokë mu në mes. Fytyra i është skuqur e po i djersin. Duhet ta ndihmojmë. Ai s'po ndalet, ore zotëri! Shumë i fuqishëm është, por edhe shumë i shtyrë në moshë.

Sa herë që po dëgjon kushtrimin tonë, ai edhe me më shumë forcë po i bie në skaj, por ai nuk po bie, nuk po bie zotëri, hiq nuk po lëkundet nga aty.

Ore, zotëri, ai po qëndron krenar në këmbë, vazhdimisht po ia skuq gurët e vegjël të atij muri. Zotëri, dëgjuat?!

Oh, more zotëri, ai që sa herë po e godet me grushte, me gishtërinj, po e kafshon me dhëmbët e prishur, me kokë po e godet, me kokë po them, murit me shumë forcë me kokë po i bie, por muri s'po bie se s'po bie përtokë. S'hiqet nga aty ai mur. Asnjë guri atij muri të gjakosur s'po i bie zotëri. Hiq asnjë, ama as ai më i vogli në skaj të kokës së tij. Vazhdimisht po e godet atë më të voglin, me më sa më shumë forcë; herë në mes, herë në skaj, por nuk bie se nuk bie ai mur, zotëri!

Ooo, zotëri, ai tash po e godet pa ndal tërë atë mur. I duhet ndihma jonë. Ja, tash po e shoh se si po bie. Po i humb forca, nuk i jep më asnjë goditje atij muri.

Zotëri, muri ka marrë inat ndaj tij, po e përzë. Po e godet në gjoks, po ia thyen këmbët, e hodhi përtokë të gjakosur atë të shkretë. Ia theu këmbët zotëri. Ai përtokë me ndihmë të duarve të pathyera po vjen drejt nesh së bashku me mur.

O, zotëri, ta ndihmojmë edhe ne!

Ja, shih se si muri po na gëlltit atë, ka marrë vrapin edhe drejt nesh, edhe neve ka për të na ngrënë deri në mëngjes.

Zotëri! Muri po sulmon edhe urën, po e rrënon. Ore, zotëri, sa keq na rrënoi urën.

Edhe ai i yni na mbeti andej murit zotëri, edhe gjësende të tjera na mbeten andej... Të gjitha janë tonat zotëri.

Ore, ti zotëri, duhet ta shtyjme murin andej, se muri po na hanë çdo ditë nga pak. Po na gëlltit si Ciklop.

Zotëri bre, t'i thërrasim rapsodët të këndojnë këngë për urën dhe ata që na mbeten andej muri!

Zotëri, ta sulmojmë atë muri ose të ikim nga këndeja me këngë kushtimore dhe vaj në buzë.

Ore, Zotëri, pa na thuaj vetëm një fjalë!

Një fjalë na thuaj.

Thuana një fjalë,

Zotëri!

Digjemi nga dëshira për njëri-tjetrin...

Mevlude ZEJNULLAHU

E ulur buzë detit në plazhin e Durrësit, më freskonte një erë e lehtë që së bashku me rërën e imët ngrihej në lartësi dhe përfundonte në tokë ose fundosej në detin e pafund.

Shikimi im depërtonte përtej lartësisë dhe para syve të mi shfaqeshin fletë nga historia jonë kombëtare...

Derisa kujtoja këto copëza të historisë kombëtare dhe shikoja me mall këtë tokë që e doja shumë, pranë meje kaloi një shitës gazetash. Pasi e luta që të ndalet dhe t'i shikoj gazetata që ai shiste, nuk di as vet si më erdhi t'ia bëjë pyetjen "a kishit dashur që Shqipëria dhe Kosova të bashkoheshin dhe të njiheshin në mbarë botën si një shtet i vetëm". U step në vend, e vështrova me kureshtje, vëreja se ishte një burrë i moshuar, me flokë të thinjura, me rrudha që ja kishin mbuluar fytyrën, po ashtu vëreja që fytyra e tij e përvëlur nga dielli lahej në djersë, por ende nuk arrita ta kuptoj pse u step ashtu kur ia parashtrova pyetjen.

Më ofendon – më tha, dhe sytë e tij u mbushën me lot. Si mendon, a kisha dashur?! Jo ne të gjallët, por edhe të vdekurit, edhe varret dëshirojnë, ëndërrojnë edhe presin që të bashkohemi ashtu siç na takon. Jemi vëllezër dhe digjemi nga dëshira për njëri-tjetrin.

Në heshtje u pendova për mënyrën se si ja parashtrova pyetjen këtij plaku flokëthinjur që e dinte shumë mirë historinë kombëtare dhe që kishte dekada jete që priste kur të bashkoheshin ato që dikur janë ndarë padrejtësisht...

Kosova na ka mbetur në një udhëkryq të vështirë...

Ishte ulur tanimë pranë meje dhe pa kurrfarë përtese më fliste për historinë, heronjtë dhe për politikën aktuale në dy vendet. Kur përmendi Kosovën, sytë e tij loutuan përsëri. Kosova na ka mbetur në një udhëkryq të vështirë – murruriti duke thëlluar shikimin në valët e detit që goditnin një anije të vjetër. Po frikësohem se shpesh

gjatë historisë jemi tradhtuar – tha plaku duke u larguar me grumbullin e gazetave në dorë.

Duke menduar fjalët e plakut mbeta e ulur në pistën e gjatë buzë detit dhe po vështroja një pamje të mahnitshme.

Kaltërsia e këtyre brigjeve shkëmbore më rrëmbeu me dallgët e saj të shumta duke më zhytur në një thellësi mendimesh dhe para syve te mi shpalosi një bisedë që e kisha pasur derisa udhëtoja për në Shqipëri.

"Ne kemi luftuar gjatë gjithë jetës kundër okupatorit serbë, të jemi të lirë në tokën dhe shtëpitë tona. Kosova pas fitimit të pavarësisë së shumëpritur, duhet që ta kërkojë përfundimisht bashkimin me Shqipërinë", më thoshte Granit Gashi, jurist nga Prishtina.

Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat gjendemi, çështja se Kosova duhet të bashkohet me Shqipërinë, nuk është në "rendin" e ditës, jo që ka shqiptarë që nuk e duan bashkimin, por ekziston frika nga ata të cilët na sundojnë.

Kosovës tani i duhet të rimëkëmbët, të shikojë përpara, të punojë për të ardhmen, por në zemër ta mbajë dhe në heshtje të punojë për bashkimin me mëmë Shqipërinë...

Nga deti u dëgjua zëri i ëmbël i valëve, të cilat dukeshin sikur kërcenin e këndonin serenata mbi sipërfaqen e brishtë të tij. Nata me errësirën e saj kishte filluar të binte e zbukuruar nga yje të shumtë.

Duke kujtuar historinë kombëtare, bisedën me plakun, rrugën për në Shqipëri, dhe nuk e di si mu kujtua në këtë moment edhe një shprehje e Sami Frashërit, në Abetaren e Stambollit më 1879: "Gjith' ata njerëz, që gjendenë me një vend e flasinë një gjuhë edhe që kanë një palë zakone e një fare të rrojturi, thuhënë një komb". Mblodha me kujdes fletët që kisha para vetës dhe me shikimin e hedhur në fund te detit fillova të eci e përcjellë nga hëna kureshtarë. ■

Truri si burim i pashterur

Trurin duhet ta shfrytëzojmë konform ligjeve të Zotit dhe prirjeve tona imanente, duke e rritur gradualisht nivelin e inteligjencës



Mirsad KUTELI

Tashmë është e njohur mirëfilli se mbase edhe ideja më e vogël derivon nga mendja. Andaj, po ta kundrojmë trurin si një burim i pashterur njerëzor, mund të kuptojmë më së miri gjendjen tonë shpirtërore, se çdo gjë lind nga brendia jonë. Mirëpo, shikuar nga një prizëm tjetër, të gjitha gjërat janë ndërtuar mbi bazën e reciprocitetit dhe në këtë mënyrë ato janë të varura nga njëra-tjetra. Kështu, në rastin tonë, edhe idetë tona subjektive mund ta gjejnë inspirimin nga bota objektive, e cila e ushtron impaktin e saj në forma të ndryshme. Megjithatë, nuk mund të thuhet se një proces i tillë ndodh rastësisht. Të gjitha këto veprime janë të paracaktuara të ndodhin, si shembulli i mekanizmit të orës, që me veprimin tonë të forcës së jashtme e detyrojmë që të rrotullohet nëpër vijat të cilat tashmë i ka të kufizuara. E tërë esenca për suksesin e individit konsiston tek menaxhimi i këtij burimi të pashterur.

Studiues të ndryshëm botërorë thonë se ne e shfrytëzojmë shumë pak trurin, që potencon një aluzion se ne realisht kemi një potencial shumë të madh, por fatkeqësisht nuk e shfrytëzojmë tërësisht. Mirëpo, vetë jeta na nxit instinktivisht të mësojmë gjërat që na interesojnë më së shumti dhe zakonisht gjëra që akceptohen më së lehti. Prandaj, çdo njeriu i mungon diçka. Kjo ndodh për dy arsye: e para, për shkak se asnjë njeri nuk është i përsosur, dhe e dyta për shkak se jeta na fal shumë gjëra, por ne zakonisht nuk dimë çka të marrim: ato që i duam, apo ato që na duhen; ja pse ekziston konfuzioni jetësor. Megjithatë, ne jemi të lirë që t'i shfrytëzojmë kapacitetet tona mendore.

Zoti ia krijoi trurin njeriut për të

menduar, e jo për ta keqpërdorur. Ndaj, lajtmotivi i krejt kësaj do të ishte tek mënyra se si i përdorim kapacitetet tona psikike. Historia njerëzore ka njohur shumë personalitete me ndikim të fuqishëm që kanë bërë kthesa të mëdha, por duhet shqyrtuar se cilat kanë qenë pasojat e atij ndikimi.

Sot, jemi dëshmitarë se shoqëria jonë, me një moshë mesatare tepër të re është shumë e etur për dije. Mirëpo, para së gjithash fokusi ynë duhet të jetë tek burimi i dijes, pra, se çfarë dije të marrim dhe si ta shfrytëzojmë atë. Këtë e them, pikërisht për shkak se në këtë kohë jemi të rrethuar dhe të bombarduar nga bota e informacionit, me një nivel kaq të lartë të teknologjisë. Andaj, duhet të jemi shumë selektivë si në marrjen, ashtu edhe në transmetimin e informacionit. Një gjë është e qartë, nëse këto bëhen konform ligjeve të Zotit, çdo gjë do të shkojë në rrugën e vet dhe nuk do të ketë konsekuenca negative.



Për të mos pësuar pasoja të tilla, së pari duhet që edukimi të zgjidhet konform prirjeve imanente, dhe individit duhet të profesionalizohet për një profil të caktuar, në mënyrë që të evitohet shpërndarja e personalitetit.

Me frikë nuk shkohet nga e ardhmja e lumtur

Profilizimi, sot, është një dëshirë e të rinjve që të bëhen ekspertë në lëmi të caktuara. Mënyra më e mirë për të realizuar një dëshirë është që, së pari,

të krijohet një paqe brenda për brenda, të evitohet ambiguiteti, në mënyrë që të kthjellohet mendimi, të forcohet dëshira, vullneti dhe guximi.

Po të nisemi nga një shembull i rëndomtë që pothuajse secilin e ka përthekuar gjatë kohës së jetës së tij. Ne kemi dëshira, por edhe ambicie të ndryshme. Që nga momenti kur na lind një ambicie për të arritur një sukses, pikërisht atëherë lind edhe frika për realizimin e saj. Mirëpo, njeriu koshtient duhet ta shfrytëzojë fuqinë e lartpërmendur që përmban brenda vetes së tij. Me frikë nuk shkohet nga e ardhmja e lumtur. Frika e stagnon njeriun, e bën impotent, e rraskapit, si dhe i ngjall ndjenja negative, të cilat gjithnjë ia errësojnë shikimin, ia turbullojnë mendjen dhe ia helmojnë zemrën.

Duhet ditur se edhe me rastin e paraqitjes eventuale të frikës, kemi të bëjmë me një iluzion mendor, që mund të shlyhet shumë shpejt. Ajo duhet të konsiderohet si një perde e hollë e cila i pengon rrezet e diellit që të depërtojnë tek ne. Në këtë rast, nuk duhet të hezitohet: ta largojmë atë perde sa më parë që ta hapim horizontin e gjerë për të vështruar perspektivën tonë. Ne duhet që trurin tonë ta dirigjojmë dhe ta komandojmë në mënyrë që ta vëmë në funksion tonë, e kurrësi të mos lejojmë që të vihemi në funksion të trurit të pakontrolluar, i cili do të merrte informata të llojllojshme dhe çorientuese. Duke pasur parasysh edhe faktin se njeriu është i lidhur dhe i varur reciprokisht me botën që e rrethon, si nga individët ashtu edhe nga natyra, duhet një kooperim më i madh në mes nesh. Mirëpo, në shoqërinë tonë tashmë po dominon ajo që quhet interes i ndërsjellë, e që në fakt ka dëmtuar në esencë shoqërinë e mirëfilltë që ka ekzistuar dikur.

Si konkluzion i gjithë kësaj, ne duhet që trurin ta shfrytëzojmë konform ligjeve të Zotit dhe prirjeve tona imanente, duke e rritur gradualisht nivelin e inteligjencës së personalitetit, në mënyrë që jo vetëm ne dhe familjet tona, por e tërë shoqëria dhe shteti të kenë dobi prej nesh. ■

Tuberkulozi i mushkërive (TBC)

Sipas raportit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, çdo orë në rajonin e Evropës diagnostikohen 49 njerëz me tuberkuloz dhe shtatë të tjerë vdesin prej tij. Sipas kësaj organizate, dy vite më parë kishte rreth 9.2 milionë të sëmurë nga tuberkulozi dhe 1.7 milion të vdekur nga kjo sëmundje në mbarë botën.



Artan BEJTA & Iliriana ALLOQI

Tuberkulozi është sëmundje ngjitëse që daton shumë herët dhe është përshkruar për herë të parë që në shekullin e III para erës sonë nga një mjek kinez.

Pavarësisht nga fakti që kanë kaluar kaq shumë vite nga zbulimi i kësaj sëmundjeje (tuberkulozit), ajo vazhdon të jetë prezent edhe në kohën tonë, duke qenë madje një problem shumë i madh i shëndetësisë publike, si në vendin tonë, ashtu edhe në shumë vende të tjera të botës.

Megjithëse shkaktari i tuberkulozit mund të japë dëmtime në shumë inde dhe organe të organizmit, ai ka një paraqitje më të madhe në mushkëri.

Kush e shkakton tuberkulozin e mushkërive?

TBC-ja shkaktohet nga një baktere

me emrin mykobakterium tuberculosis ose siç njihet në literaturë shpesh edhe bacili i Kohut, që zakonisht infekton mushkëritë, por, gjithashtu, pa përjashtim mund të prekë edhe pjesë të tjera të trupit.

Ky mikrob shumëzohet shumë ngadalë dhe që nga hyrja e tij në organizëm e deri te shfaqja e sëmundjes mund të kalojë një periudhë kohore prej 11-12 javësh, prandaj sëmundja e tuberkulozit nuk shfaqet menjëherë mbas infektimit, por pasi të ketë kaluar një periudhë kohore. Më tepër është e atakuar mosha produktive (15-40 vjet) mirëpo kjo nuk do të thotë që nuk i prek moshat e tjera, ato më të reja ose më të vjetra se kjo moshë.

Cilat janë shenjat klinike që një njeri vuan nga tuberkulozi i mushkërive?

Tuberkulozi i mushkërive është një sëmundje që në fillim ka pothuajse shenja të përgjithshme (jo specifike) dhe shpesh të shkon mendja në ndonjë gjendje gripi apo sëmundje tjetër, pasi

KUJDES! Tuberkulozi i patrajtuar mund të jetë një sëmundje fatale (vdekjeprurëse). Por tuberkulozi është pothuajse gjithmonë sëmundje e shërueshme. Pra, në qoftë se ju mendoni se jeni në rrezik, ose keni ndonjë shkak për t'u merakosur, flisni me doktorin ose qendrën shëndetësore lokale. Mjekimi i tuberkulozit është falas.

ka një simptomatologji të përgjithshme. Shenjat e kësaj sëmundjeje janë: temperaturë të lartë dhe persistente më tepër se një javë, djersitje të mëdha gjatë natës, humbje peshe, një ndjenjë e përgjithshme e lodhjes dhe e të qenit i sëmurë, kollë e vazhdueshme që shkon vetëm duke u keqësuar dhe që shpesh mund të jetë e shoqëruar me sputum të përzier me pika gjaku.


Si përhapet tuberkulozi i mushkërive?

Sëmundja e tuberkulozit të mushkërive është sëmundje ngjitëse e cila përhapet nga të sëmurit me tuberkuloz të mushkërive (të cilët nuk janë duke u mjekuar me terapi) përmes kontaktit direkt me këta të sëmurë përmes ajrit, kur i sëmuri nga tuberkulozi kollitet apo teshtin dhe nga goja nxjerr spërklë në të cilat është i pranishëm bacili i tuberkulozit. Qëndrimi i gjatë në kontakt me të sëmurin nga tuberkulozi i mushkërive jep shanse të mëdha për t'u sëmurë nga kjo sëmundje, pasi që gjatë asaj kohe të qëndrimit, pacienti shpesh kollitet e teshtit dhe në këtë mënyrë kontaminimi i ajrit me bacilin e tuberkulozit është i madh.

Kush janë më të rrezikuarit për t'u infektuar nga tuberkulozi i mushkërive?

Edhe pse çdo njeri mund të sëmuret

Numri i rasteve me tuberkuloz të mushkërive gjatë vitit 2006 nëpër qendrat të Kosovës - sipas Klinikës së Pulomologjisë - Prishtinë



■ Prishtina ■ Prizreni □ Mitrovica □ Peja
■ Gjakova □ Ferizaj ■ Gjilani



Sipas Ass. Dr. Rukije Mehmetit, në vitin 2006 ishin të regjistruara 1122 raste me tuberkuloz. Ndërsa në 2007, në Kosovë hiç më pak se 930, prej të cilave 653 janë me tuberkuloz të mushkërive, kurse 277 rastet e tjera janë të sëmurë me tuberkuloz të pjesëve të ndryshme të organizmit. Nga të sëmurit, 432 janë femra, kurse 498 meshkuj, kurse 534 raste janë të moshës 0-44 vjet, ndërsa 396 janë mbi 45 vjeçare. Sipas raportit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, çdo orë në rajonin e Evropës diagnostikohen 49 njerëz me tuberkuloz dhe shtatë të tjerë vdesin prej tij. Sipas kësaj organizate, dy vite më parë kishte rreth 9.2 milionë të sëmurë nga tuberkulozi dhe 1.7 milion të vdekur nga kjo sëmundje në mbarë botën.

nga kjo sëmundje, disa grupe njerëzish kanë më shumë rrezik se të tjerët. Këtu përfshihen ata njerëz që:

- kanë jetuar në të njëjtën shtëpi ose që kanë qenë në kontakt të afërt dhe për një periudhë të gjatë me dikë që është i sëmurë nga tuberkulozi;

- jetojnë në kushte jo të mira shëndetësore ose në kushte të mbipopulluara, duke përfshirë të pastrehët ose ata që flenë në kushte të vështira;

- kanë jetuar, punuar ose qëndruar për një kohë të gjatë në një vend me një përqindje të lartë të sëmurë nga tuberkulozi;

- mund të jenë ekspozuar ndaj bacilit të tuberkulozit gjatë rinisë së tyre kur sëmundja ishte më e përhapur në këtë vend;

- janë fëmijët e prindërve që janë me origjinë nga vende me përqindje të lartë të tuberkulozit;

- nuk janë në gjendje të luftojnë infeksionet (me imunitet të kufizuar) për shkak të sëmundjeve (p. sh. infeksioni HIV) ose për shkak të mjekimeve të ndryshme;

- janë të varur ndaj drogave dhe alkoolit;

- nuk hanë aq sa duhet për të qëndruar të shëndetshëm.

Tuberkulozi mund të shërohet plotësisht

Tuberkulozi në ditët e sotme është një sëmundje që me barna shumë të lehta për përdorim shërohet pa lënë pasoja tek pacienti. Mjekimi i të sëmurit bëhet me dhënien e antibiotikëve për një periudhë të gjatë kohore prej gjashtë muajsh.


Menjëherë pasi i sëmuri fillon mjekimin nga tuberkulozi, ai fillon të ndjehet mirë pas 2-4 javësh, mirëpo mjekimi duhet të vazhdojë të paktën gjashtë muaj. Kjo periudhë e gjatë mjekimi me antibiotikë është shumë e rëndësishme që i sëmuri të mjekohet nga tuberkulozi. Nëse pacienti i ndërpret barnat (antibiotikët) para periudhës kohore të duhur (gjashtë mujore) atëherë është shumë rrezik që sëmundja e tuberkulozit të përsëritet në një formë më rezistuese ndaj barnave të zakonshme dhe do të jetë më tepër e vështirë për t'u mjekuar.

Është shumë e rëndësishme të cekët se nëse tuberkulozi nuk mjekohet në mënyrë të duhur mund të çojë në vdekje!













A mund të parandalohet tuberkulozi?

Për shumë vite është përdorur një vaksinë (vaksina BCG) si preventivë për të ndihmuar në mbrojtjen kundër tuberkulozit. Kjo vaksinë jepet në doza të caktuara dhe në moshë të caktuar, mirëpo ajo që është e rëndësishme është se vaksina e tuberkulozit nuk jep mbrojtje të plotë, sidomos nëse personi është në kontakt të gjatë me të sëmurin me tuberkuloz.

Mënyrë tjetër e parandalimit të tuberkulozit është edhe diagnostikimi i hershëm i të sëmurëve nga kjo sëmundje dhe në këtë mënyrë duhet të fillojë mjekimi sa më i shpejtë i tyre, e po ashtu të sigurohemi se ata kanë përdorur mjekimin e plotë të nevojshëm për mjekimin e tuberkulozit. ■



Fjalëkryqi

Autor: ENDRITI	GJITHAMERIKANE ANË MBARË AMERIKANE	METODË STUDIMIT	ISHI FUTBOLLISTI YËNË FAVZI	BESIM, FE (mysl.)	TAKSA QË I PAGUHET SHTETIT	EMNAKU I EMRIT ELSA	TITANI, SULFURI		GRUP I YNË MUZIKOR	ALUMINI	FEMRA E ZQJEDHUR NË NJË KONKURS BUKURIE	ZANORE	FUTBOLLISTI NË FOTO	KËNGËTARJA BRITANIKE BUNTON
VLERA E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT (peshq.)								VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE						
SHKENCËTARI SHQIPTAR SKENDER								DIPLOMATI EVROPIAN REHIN AKTORJA TURMAN				NJËSI E REZISTENCËS ELEKTRIKE TENISTJA KURNKOVA		
PËSHPËRITUR FJALË MAGJIKE										BARI I TRATË AKTORJA E VJETËR HOLLIVUDIANE MORENO				
KËNGËTARJA KANADEZE MORISËT								AKTORI YËNË ADRIAN FUTBOLLISTI CEK JANKULOVSKI (Milan)						KËNGËTARJA JONË LIBDOHOVA
NOTË MUZIKORE			MIRË DE, NË RREGULL	KËNGËTARJA SHQIPTARE ANILA REGRUT NË PERANDORINË OSMANE							LETRARI ALIU INDUM, BOR			
THERRJA E MYEZNIT						ANGOLA LËNDË E FORTË PLASTIKE		ANTA (peshq.) ZOT, PËRËNDI				DOKTOR (shk.) AKTORJA E FAMSHME ELEKTRA		
ISH FUTBOL- LISTI GJER- MAN UVE (shq.)					FRYMA MËSYMJE				ANKËSË GURRË BURIM (sh-shq.)					
ZANORE	AKTORJA E FAMSHME ITALIANE ROSELLINI TË FIKËT									PJESA E SHTËPISE E PALSUR ME DUSH OSE ME VASKE BANDR I- ARABISE				
DEM, TER			SHKRETTËTRA NË TË CILËN EGHTE Qëtar ATAKAMITI (Minerali) KËNGËTARJA JONË MARUKU								"ROTTERDAM" KËNGËTARJA FARA			MINDER I ULËT
GJERMAN I VJETËR								BANËSË E GRAVE TË SULTANIT KOHË						BASHKËT- INDËLLORE "SOMALIA"
LUM I GJATË NË AFRIKË						AKTORJA AMERIKANE BASIGNER ELEMENT KIMIK (shq.)			FLOZOF NË GRIEQINË ANTSKE (shq.) HENDËK I THELLË E I GJERË (sh-shq.)					
VIOLINISTJA SHQIPTARE GEGJA					BASHKË, ME AKTORI AMERIKAN DEJMON					DY NOCIONE QË KANË NDËRRJET TYRE LICHJE TË DYANSHME KALESA				
	KOK-GOKSERI SHQIPTAR MAKSUTAJ PRJËS I HUNËVE						SHKOP I BILARDSOS ATLETI MONTGOMERI							
JETËSHKOR- ET														NAIM ABAZI
VEND QË PO SYNON PAVARSINË NGA KINA														MAFIOZI KAPONE TRAJNERI GJERMAN REHAGEL
ZANORE	AKTORJA E VJETËR SUEDEZE MARGRET NYÇ, NYJE					PJESA E LIMANT KË GËNDROJINË ANIJET FINLANDA, SUEDIA								
EMËR YNË MASHKULLI														LUM NË SPANJË FOSFORI
AKTORJA BRITANIKE FRIEL					VIDEO - KLIP MUZIKOR									

